



UNIVERSITETI I EVROPES JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

SHKENCAT SHOQËRORE BASHKËKOHORE
СОВРЕМЕНИ ОПШТЕСТВЕНИ НАУКИ
CONTEMPORARY SOCIAL SCIENCES

STUDIMET DOKTORALE-CIKLI I TRETË

TEZA:

**POLITIKAT ARSIMORE TË GJITHËPËRFSHIRJES NË
KOSOVË PËRBALLË POLITIKAVE DHE
STANDARDEVE ARSIMORE TË BE-SË**

KANDIDATI:

Maliqe Mulolli–Jahmurataj

MENTORI:

Prof. dr. Abdulla Azizi

Tetovë, korrik 2020

DEKLARATË E AUTORËSISË

Deklaroj më përgjegjësi të plotë se përmbajtja e tezës së doktoratës më titull: “Politikat arsimore të gjithëpërfshirjes në Kosovë përballë politikave dhe standardeve arsimore të BE-së” është plotësisht autentike, e krijuar nga unë në mënyrë të pavarur, duke respektuar rregullat akademike dhe rregullat e sjelljes etike. Deklaroj gjithashtu se ky punim nuk është prezantuar para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar.

LISTA E SHKURTIMEVE DHE FJALORI

FNV	Fëmijë me nevoja të veçanta
RAE	Rom, ashkali, egjiptian
BE	Bashkimi Evropian
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
DKA	Drejtoria komunale e arsimit
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PSAK	Plani strategjik i arsimit në Kosovë
PIA	Plani individual i arsimit
OJQ	Organizatë joqeveritare
BEP	Basic Education Program
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës

ABSTRAKT

Gjithëpërfshirja si koncept dhe si politikë arsimore është relativisht e re në vendin tonë. Ajo ka ardhur qysh në vitin 1999 në kuadër të reformave në arsim dhe është në zhvillim e sipër.

Dëshira dhe vullneti i njerëzve si dhe përpjekja e tyre për një arsim gjithëpërfshirës shihen se janë relativisht të hershme, por që një gjë e tillë fatkeqësisht nuk ka qenë e rregulluar me anë të ndonjë ligji a dokumentacioni mbështetës deri në vitin 2011, kur për herë të parë politika gjithëpërfshirëse është bërë pjesë e ligjit për arsimin parauniversitar dhe që nga ajo kohë e tutje është pjesë e të gjitha politikave të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT).

Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe e minoriteteve në arsim si pjesë e grupeve të marginalizuara në Kosovë vazhdon akoma të mbetet sfidë për vendin. Aktualisht në Kosovë përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta dhe e minoriteteve në arsimin fillor është një sfidë që kërkon përpjekje shtesë, trajnime, motivim, një nivel të mjaftueshëm ndjeshmërie dhe durim. Gardner-i (2005) konkludon se *“Sfida nuk është në klasifikimin e personave të aftë dhe më pak të aftë, por në zhvillimin e tyre në përputhje me aftësitë individuale.”*

Megjithëse parimi kryesor i *Ligjit për arsimin parauniversitar* thotë që *“Asnjë personi nuk guxon t’i mohohet e drejta për arsimim”*, këto dy kategori vazhdojnë të mbeten problematike dhe njëherësh është rrezik të jenë braktisës potencialë të shkollës. Arsimi për fëmijët me nevoja të ndryshme arsimore mund të organizohet në shumë mënyra, me gjithë dallimet organizative, kulturore, ekonomike etj., pasi zhvillimi i mekanizmave për “shkollim të të gjithëve” nuk ndodh vetvetiu. Ky proces kërkon angazhim të madh dhe bashkëpunim me organizma të ndryshëm.

Duke pasur parasysh që aspirata e Kosovës është integrimi në Bashkimin Evropian dhe në mekanizmat ndërkombëtarë, pasi aty shihet perspektiva dhe vlerat universale, integrimi në Bashkimin Evropian është i bazuar në kushte dhe standarde konkrete që duhet të planifikohen dhe të realizohen në Kosovë. Plotësimi i kushteve dhe i standardeve evropiane realizohet përmes harmonizimit të politikave dhe legjislacionit të Kosovës me atë të Bashkimit Evropian.

Gjithëpërfshirja në sistemin arsimor të Kosovës është kusht që Kosova duhet ta plotësojë dhe ta ketë si kategori ligjore në kuadër të sistemit të saj arsimor. Për të realizuar këtë është e nevojshme që politikat dhe legjislacionin e sistemit arsimor Kosova t’i harmonizojë me

direktivat e BE-së dhe me standardet ndërkombëtare që rregullojnë fushën e gjithëpërfshirjes në arsim.

Në kuadër të këtij hulumtimi do të bëhet vlerësimi aktual i politikave dhe i legjislacionit të Kosovës në fushën e arsimit, do të vlerësohet se sa është ky legjislacion në harmoni me direktivat e BE-së dhe me standardet ndërkombëtare dhe cilët hapa duhet të ndërmerren për të pasur përmirësime në këtë rrafsh. Nga kjo do të na ofrohet një pasqyrë reale se në cilën gjendje janë politikat dhe legjislacioni dhe çfarë duhet të veprohet për të përmirësuar këtë gjendje. Pra ky studim ka për qëllim që të sjellë risi në këtë fushë hulumtimi duke synuar të zbulojë se sa është Kosova në hap me direktivat dhe standardet e BE-së në fushën e arsimit, cilat janë shkaqet e mosvijimit të kënaqshëm të mësimit qoftë nga kategoria e fëmijëve me nevoja të veçanta apo nga ana e minoriteteve, si dhe të sugjerojë politika të përshtatshme që do të jenë në harmoni me direktivat e BE-së dhe që njëherësh do të krijojnë korniza që pranojnë diversitetin e situatave personale dhe zhvillojnë solidaritetin reciprok.

Në pikëpamjen sociale studimi do të evidentojë rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut në fushën e edukimit për të përfutur mundësi të barabarta shkollimi për të gjithë. Për realizimin e studimit, do të përdoret metoda hulumtuese sasiore dhe cilësore. Instrumenti matës, i përpiluar në formë të pyetësorit, do të përbëhet nga disa pyetësorë të strukturuar sipas kategorive specifike:

1. Pyetësori për mësimdhënësit që punojnë me fëmijë me nevoja të veçanta (FNV);
2. Pyetësori për studentët e Fakultetit të Edukimit të Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”;
3. Pyetësori për mësimdhënësit që punojnë me fëmijë të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian;
4. Pyetësori për nxënësit e komuniteteve joshumicë: rom, ashkali dhe egjiptian.

Popullata e studimit përbëhet nga mësimdhënësit të shkollave të rregullta, mësimdhënësit të arsimit bazik, fëmijë nga radhët e komuniteteve joshumicë: rom, ashkali dhe egjiptian, që jetojnë në komuna të ndryshme të Republikës së Kosovës.

Të dhënat do të analizohen me anë të paketës statistikore për shkencat sociale (programi SPSS).

Fjalët kyçe: *Gjithëpërfshirje, fëmijë me nevoja të veçanta, minoritete, politikë arsimore, shkollim.*

ABSTRACT

Inclusion as an educational policy and as a concept is relatively new in our country. It has come along with other education reforms since 1999 and is under development. The desire and will of the people as well as their effort for a comprehensive education is seen to be relatively early if such a thing has unfortunately not been regulated by any law or supporting documentation until 2011. In this year for the first time First, comprehensive policy has become part of the Law on Pre-University Education and since then has been part of all policies of the Ministry of Education, Science and Technology (MEST).

The inclusion of children with special needs and minorities in education as part of marginalized groups in Kosovo remains a challenge for the country. Currently in Kosovo, the inclusion of students with special needs and minorities in primary education is a challenge that requires additional effort, training, motivation, a sufficient level of sensitivity and patience. Gardner (2005) concludes that: "The challenge is not in classifying capable and less capable individuals, but in developing them according to individual abilities."

Despite the fact that the main principle of the Law on Pre-University Education states that "No person should be denied the right to education", these two categories continue to be problematic and at the same time risk being potentially dropping out of school. Education for children with different educational needs can be organized in many ways despite organizational, cultural, economic differences, etc., as the development of mechanisms for the "school for all" does not happen by itself. This process requires great commitment and cooperation with various bodies.

Given that Kosovo's aspiration is integration into the European Union and international mechanisms as seen from the perspective and universal values, integration into the European Union is based on concrete conditions and standards which must be planned and implemented by Kosovo. Meeting European conditions and standards is achieved through the harmonization of Kosovo's policies and legislation with that of the European Union.

Inclusion in the education system of Kosovo is a condition that Kosovo must meet and have the same legal category within its education system. In order to achieve this, it is necessary for Kosovo to harmonize the policies and legislation of the education system with the EU Directives and international standards which regulate the field of inclusion in education.

In the framework of this research, the current evaluation of Kosovo's policies and legislation in the field of education will be done, how much it is in line with EU directives and international standards and what steps should be taken. This will give us a realistic picture of the state of policy and legislation and what needs to be done to improve it. So, this study aims to bring innovation in this field of research aiming to find out how much Kosovo is in step with EU directives and standards in the field of education, what are the causes of unsatisfactory learning from either the category of children with special needs or by minorities and to suggest appropriate policies that will be in line with EU directives and which would at the same time create frameworks that accept the diversity of personal situations and develop mutual solidarity. From a social point of view, the study will highlight the importance of respecting human rights in the field of education in order to benefit equal education opportunities for all. Quantitative and qualitative research methods will be used to conduct the study. The measuring instrument compiled in the form of a questionnaire, where several questionnaires structured according to specific categories will be used:

- 1, Questionnaire for Teachers Working with Children with Special Needs (FNV)
2. Questionnaire for students of the Faculty of Education
3. Questionnaire for teachers working with children from non-majority Roma, Ashkali and Egyptian communities
4. Questionnaire for students from non-majority Roma, Ashkali and Egyptian communities

The study population are regular school teachers, basic education teachers, children from non-majority Roma, Ashkali and Egyptian communities of different municipalities of the Republic of Kosovo. The data will be analyzed using the Statistical Package for Social Sciences (SPSS Program).

Keywords: Inclusion, children with special needs, minorities, education policy, education.

FALËNDERIME

Realizimi i këtij punimi ka qenë i mundshëm edhe falë ndihmës së personave të tjerë që më kanë ofruar mbështetje profesionale dhe akademike që nga fillimi deri në përfundim të tij. Prandaj, së pari, falënderoj mentorin tim, prof. dr. Abdulla Azizi, i cili në çdo hap të procesit të punës më ka mbështetur me qëllim që cilësia e punimit të jetë e një niveli të lartë akademik e shkencor. Kontribut të lartë në këtë proces kanë dhënë edhe anëtarët e komisionit, të cilët me këshillat e tyre profesionale kanë mundësuar që tema të kompletohet. Pjesë e rëndësishme e këtij punimi janë edhe nxënësit, studentët, mësimdhënësit etj, të cilët përmes mendimeve të tyre profesionale të dhëna në pyetësor kanë bërë të mundshme që të kemi një pasqyrë të qartë lidhur me problemin që trajton punimi.

Për të gjitha të arriturat në çdo fushë të jetës i jam falënderuese familjes, e cila në çdo formë dhe në çdo mënyrë më ka mbështetur vazhdimisht gjatë gjithë rrugëtimit tim. Prindërit e mi, Fehmi Mulolli dhe Nazmije Cakiqi Mulolli, kanë punuar me përplot vullnet për ngritjen dhe avancimin tim profesional e akademik në fushën e arsimit. Ata kanë qenë mentorët e mi gjatë gjithë jetës, sepse me përkrahjen dhe këshillat e tyre edhe sukseset e mia kanë qenë më lehtë të arritshme. Periudha kur prindërit më kanë rritur, më kanë edukuar dhe më kanë shkolluar ka qenë periudha më e vështirë, pasi kishte të bënte me atë sistem totalitar të pushtetit serb që mohonte prejardhjen, kulturën, territorin, arsimimin dhe qëllimin tonë si qytetarë shqiptarë. Në këtë situatë prindërit jo vetëm ia kanë dalë të më përgatitin për jetë, por edhe të më udhëzojnë se populli shqiptar ka shumë nevojë për arsimim, gjë që ka qenë orientuese për mua për të zgjedhur arsimin si fushë akademike e profesionale. Gjithashtu u jam falënderuese e mirënjohëse edhe motrave, Valbonës dhe Besartës dhe vëllait, Atdheut, të cilët në çdo çast dhe për çdo gjë kanë qenë mbështetja ime e madhe dhe shtyllat mbi të cilat jam ngritur. Gjatë punës në këtë temë kisha fatin që në krah ta kisha një bashkudhëtar, bashkëshortin tim, Isufin, i cili në çdo aspekt ka qenë inspirimi, mbështetja dhe vullneti që suktesi të mos më mungonte në çdo fushë. Isuf, të jem falënderuese përjetë për punën dhe mbështetjen që më ke dhënë në çdo fazë të jetës, si edhe në këtë fazë të studimeve dhe përgatitjes së kësaj teme. Gjithashtu, dua t'i falënderoj edhe fëmijët e mi, Uskanën dhe Thesarin, të cilët ishin inspirim për punë, por shpesh edhe arsye për ndërprerë të punës sime në mënyrë që ata të rriteshin komod duke mos munguar asgjë. Jam e lumtur që në këta rreshta të kësaj teme ruhen kujtime të shkronjave nga gishtat e vegjël të Uskanës, e cila sa herë që punoja bëhej shumë kureshtare dhe herë pas here shtypte ndonjë tast pa i ditur shkronjat a domethënien e tyre.

PËRMBAJTJA

Deklaratë e autorësisë	i
Lista e shkurtimeve dhe fjalori.....	ii
Abstrakt	iii
Falënderime	iv
Përmbajtja.....	v
Lista e grafikëve	vi

HYRJE

1.Përshkrimi i problemit.....	5
2.Qëllimi i punimit.....	6
3.Objektivat specifike të hulumtimit.....	6
4. Hipotezat e punimit.....	7
5.Pyetjet e hulumtimit	7
6.Hipotezat e hulumtimit.....	8
7. Metodologjia e punimit	8
8. Kufizimet dhe vështirësitë	9
9. Çfarë synohet të arrihet?.....	9
10. Rëndësia e hulumtimit.....	10
11. Përshkrimi i situatës	10

KAPITULLI I - Historiku i sistemit arsimor në Kosovë

1. Politikat arsimore dhe sistemi paralel i arsimit në Kosovë (1990 – 2000).....	12
2. Ndërtimi i sistemit arsimor në Kosovë nga viti 2000 e deri më sot.....	14
3. Zhvillimi dhe ngritja profesionale e mësimitdhënësve në Kosovë	23

KAPITULLI II - Zhvillimi i sistemit arsimor dhe gjithëpërfshirja në Kosovë

1. Gjithëpërfshirja në sistemin e arsimit në Kosovë.....	29
2. Koncepti i gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim.....	30
3. Gjithëpërfshirja në arsim si kategori e të drejtave të njeriut.....	33
4. Niveli i gjithëpërfshirjes së fëmijëve me NVA në kuadër të sistemit arsimor në Kosovë	36
5. Motivimi	41
6. Vështirësitë organizative dhe planifikuese	42
7. Kushte të papërshtatshme	43

KAPITULLI III - Politikat e sistemit arsimor lidhur me gjithëpërfshirjen

1. Pasqyra e gjithëpërfshirjes së komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë...	46
2. Përfshirja e fëmijëve nga komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës	53
3. Gjendja aktuale arsimore e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe	58
4. Mbështetja e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian me	61

KAPITULLI IV- Politikat arsimore të gjithëpërfshirjes në Republikën e Kosovës në raport me standardet e BE-së.

1. Partneriteti i Kosovës me Bashkimin Evropian	65
2. Politikat arsimore për gjithëpërfshirje në Kosovë karshi obligimeve të BE-së	71
3. Harmonizimi i legjislacionit – obligim i shteteve para anëtarësimit në BE, rasti i Republikës së Kosovës	73

KAPITULLI V- Metodologjia, forma dhe përbërja e hulumtimit.

1. Metodologjia e hulumtimit	81
2. Metodat e hulumtimit	82
3. Instrumentet e hulumtimit.....	82
4. Popullata e hulumtimit.....	83
5. Kampioni	83
6. Grumbullimi dhe administrimi i të dhënave	84
7. Konsideratat etike.....	84

KAPITULLI VI - Hulumtimi për politikat arsimore të gjithëpërfshirjes në arsimin parauniversitar

1. Një vështrim i shkurtër i përmbajtjes së kapitullit	85
2. Qëllimi dhe procedura e hulumtimit	86
3. I rikujtojmë hipotezat e punimit.....	87
4. Efektet e gjithëpërfshirjes në arsimin parauniversitar në Kosovë.....	87
5. Analiza e të dhënave nga pyetësorët e realizuar me mësimdhënës.....	90
6. Rezultatet e dala nga pyetësorët e realizuar me studentët e Fakultetit të Edukimit	114
7. Analiza e të dhënave nga pyetësori me nxënës të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian	120

ANALIZA SWOT..... 147

PËRFUNDIME 154

REKOMANDIME 157

SHTOJCAT..... 168

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. A keni ndjekur ndonjë trajnim për qasje ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta?

Grafiku 2. A e konsideroni të nevojshme të ndiqni trajnime / seminare të tjera për të marrë njohuri për punën me fëmijët me nevoja të veçanta?

Grafiku 3. Cili institucion i ka ofruar këto trajnime?

Grafiku 4. Sa mendoni që është e nevojshme përfshirja e mësuesve mbështetës në klasat ku ka të përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta?

Grafiku 5. A keni në klasë mësues mbështetës dhe, nëse po, sa e konsideroni të domosdoshme prezencën e tyre në klasën tuaj ?

Grafiku 6. Sa e keni mbështetjen e specialistëve / profesionistëve për çështje të aftësisë së kufizuar gjatë punës suaj?

Grafiku 7. Nga cilët specialistë do ta vlerësonit më të nevojshme mbështetjen?

Grafiku 8. Cilin do e konsideronit si motiv apo inkurajim që do të kishit më shumë nevojë për të punuar me FNV?

Grafiku 9. Si janë raportet e FNV-ve me nxënësit e tjerë të shkollës?

Grafiku 10. A keni njohuri për PIA-n (Planin individual të arsimit)?

Grafiku 11. A keni hartuar ndonjë PIA? Nëse po, sa ka qenë sfiduese për ju dhe a keni arritur t'i përmbushni objektivat?

Grafiku 12. Sa bashkëpunoni me prindërit për zbatimin e programit të hartuar për nevojat specifike të fëmijës së tij/saj ?

Grafiku 13. A keni ambient të përshtatshëm në shkollë për sigurimin e lëvizjes pa barriera të FNV-ve?

Grafiku 14. A ju siguron shkolla materiale didaktike në përputhje me nevojat dhe kërkesat për të punuar me FNV?

Grafiku 15. Çfarë do të sugjeronit në drejtim të përshtatshmërisë së mjeteve? (Mund të shënoni më shumë se një alternativë).

Grafiku 16. A mendoni se FNV-të duhet të vijojnë mësimin në shkolla të zakonshme?

Grafiku 17. Sa jeni të informuar për fëmijët me nevoja të veçanta?

Grafiku 18. Nga kush keni marrë informacione për fëmijët me nevoja të veçanta?

Grafiku 19. Sa mendoni që vijimi i studimeve në universitetin tuaj ofron njohuri të mjaftueshme që nesër ju të jeni një kontribuues aktiv në arsimin gjithëpërfshirës?

Grafiku 20. Sa mendoni që do të jetë sfiduese për një nxënës të kësaj kategorie nëse mësimdhënësi i tij është i papërgatitur për qasje ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta?

Grafiku 21. Përveç mësimi praktik që keni mbajtur në shkolla, a keni vizituar ndonjë institucion tjetër ku ka të përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta?

Grafiku 22. A mendoni se FNV-të duhet të vijojnë mësimin në shkolla të zakonshme?

Grafiku 23. Sa është numri i nxënësve në klasën tuaj?

Grafiku 24. Çfarë janë raportet tuaja me shokët dhe shoqet e klasës?

Grafiku 25. Në cilën bankë uleni?

Grafiku 26. A uleni gjithmonë me shokun apo shoqen e njëjtë?

Grafiku 27. Sa keni mbështetje apo ndihmë rreth detyrave të shtëpisë?

Grafiku 28. Sa merrni pjesë në mësimin plotësues ose shtues?

Grafiku 29. A janë në gjendje prindërit t'ju ndihmojnë rreth detyrave të shtëpisë?

Grafiku 31. Çfarë bëni në kohën e lirë?

Grafiku 32. Cili është suksesi juaj në shkollë?

Grafiku 33. Sa jeni të kënaqur me vijimin e fëmijëve nga komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në shkollë?

Grafiku 34. A keni vështirësi në përfshirjen e këtyre fëmijëve në klasën tuaj?

Grafiku 35. A keni ndjekur ndonjë trajnim për qasje të barabartë ndaj nxënësve?

Grafiku 36. Sa e keni mbështetjen nga shkolla dhe institucionet etjera në punën tuaj?

Grafiku 37. A janë të paragjykuar këta fëmijë nga fëmijët shumicë në klasë?

Grafiku 38. Sa janë të rregullt në takimet e organizuara të klasës prindërit e këtyre fëmijëve?

Grafiku 39. Sa vijnë këta nxënës të përgatitur me detyrat e shtëpisë?

Grafiku 40. A mendoni se këta nxënës kanë mbështetje të mjaftueshme në shtëpi?

Grafiku 41. A ndihmohen këta nxënës nga nxënësit e tjerë të klasës?

Grafiku 42. A marrin pjesë këta nxënës në aktivitetet kulturore-sportive që organizon shkolla?

HYRJE

Gjithëpërfshirja është një faktor mjaft i rëndësishëm në politikat e një vendi në përgjithësi e në ato arsimore në veçanti. Në Kosovë që nga viti 1950 e deri në vitet e 80-ta kanë ekzistuar disa shkolla speciale të nivelit fillor dhe të mesëm. Meqë numri i këtyre shkollave ishte mjaft i vogël, kjo përjashtonte një numër të madh fëmijësh me nevoja të veçanta nga procesi i shkollimit e veçmas fëmijët nëpër fshatra. Në vitet e 90-ta Kosova po kalonte një periudhë mjaft të vështirë në të gjitha aspektet. Në atë kohë punohej në një sistem paralel të mësimi pjesë e të cilit ishte edhe arsimi special. Funksiononin katër shkolla speciale që përfshinin 400 fëmijë¹. Kjo gjendje vazhdon deri në vitin 1999, kur arsimi në Kosovë shënon një kthesë. Masa për futjen e një sistemi gjithëpërfshirës arsimor janë marrë që nga viti 2002, mirëpo politikat dhe kornizat ligjore nevojitet të zhvillohen në vazhdimësi. Në vitin 2003 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë hartoi *Planin strategjik për arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në Kosovë*, i cili përshkruan strategjitë e reja dhe zhvillimin e politikave.

Viteve të fundit përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim ka shënuar rritje. Kështu vetëm në vitin shkollor 2009/2010 numri i fëmijëve me nevoja të veçanta që marrin mbështetje dhe që janë përfshirë në shkolla ka shënuar rritje prej 30%, pra nga 909 fëmijë në vitin shkollor 2008/2009 numri ka arritur në 1179 fëmijë.²

Kosova është shtet që gjithëpërfshirjen e drejton në vazhdimësi kah shkollat e rregullta. Për këtë shkak është krijuar edhe një ekip mësimdhënësish, të quajtur mësimdhënës udhëtues, detyrë e të cilëve është mbështetja e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla të rregullta.

Në periudhën kohore 2009 – 2010, 103 fëmijë me nevoja të veçanta arsimore në shkolla të rregullta janë mbështetur nga qendrat burimore nëpërmjet këtyre mësimdhënësve udhëtues.³

Në Kosovë kishte një numër të caktuar të klasave të bashkuara që funksiononin brenda shkollave të rregullta. Klasat e bashkuara, në bazë të të dhënave të vitit 2010, akomodonin përafërsisht 50% të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe numri i tyre ishte 73 klasa

¹ FSDEK (2003). *Edukimi special në Kosovë*. GME, f. 24.

² Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës – Njësia për arsim special (2009 – 2010).

³ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës – Njësia për arsim special (2009 – 2010).

në gjithë vendin.⁴ Klasat e bashkuara ishin shumë heterogjene për nga mosha dhe lloji i problemit të fëmijëve, prandaj edhe nevojat e tyre për ofrim të arsimit special ishin të larmishme.

Në vitin 2009 Qeveria e Republikës së Kosovës hartoi *Planin e veprimit për persona me aftësi të kufizuara të Republikës së Kosovës* (2009 – 2011). Qëllimi i këtij plani ishte të përmirësonte cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara dhe po ashtu të përmbushte obligimet që Kosova ka për respektimin e konventave ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të njeriut, për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, pika që janë në mesin e parakushteve që Kosova të ecë përpara në procesin e integrimit evropian.

Në vitin 2010 u hartua *Plani strategjik për arsimin e Kosovës* (2011 – 2016) në të cilin, pos të tjerash, ofroheshin mundësi të barabarta në arsimin cilësor për të gjithë.

Në *Ligjin për arsimin parauniversitar* në vitin 2011 gjithëpërfshirja si koncept përshkon tërë ligjin, i cili është i bazuar në Deklaratën e Salamankes. Gjithëpërfshirja si term nënkupton përfshirjen e të gjitha grupeve në jetën shoqërore, grupe që për arsye të ndryshme dikur mund të kenë qenë të përjashtuara. Dy kategoritë që ne synojmë t'i trajtojmë në këtë studim janë fëmijët me nevoja të veçanta dhe fëmijët nga radhët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, përfshirja e të cilëve në arsim është mjaft problematike dhe, njëkohësisht, mjaft e rëndësishme.

Sipas udhëzuesit të UNESCO-s, përgatitur për të ndihmuar proceset e gjithëpërfshirjes kudo në botë, gjithëpërfshirja është konsideruar si një mirëpritje morale, etike, shoqërore e shumëllojshmërive nga e cila përfitojnë të gjithë nxënësit pa përjashtim.

Arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta është një sfidë për të gjitha vendet që synojnë të realizojnë parimin e krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët pa dallim feje, kulture, race, gjinie e diversiteti, që është e drejtë themelore e çdo njeriu. Në shumë sisteme arsimore të vendeve të ndryshme, gjithëpërfshirja është bërë tashmë një realitet, por i shoqëruar me vështirësi të shumta.

Nëse nisemi nga fakti që dita-ditës në Kosovë numri i fëmijëve me nevoja të veçanta është në rritje e sipër, Ministria e Arsimit duhet të hartojë politika të zbatueshme për shkollat dhe institucionet e tjera në mënyrë që kjo kategori e fëmijëve të mos mbetet jashtë institucioneve shkollore. Te ne përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta ka filluar nëpërmjet shkollave speciale.

⁴Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës – EMIS (2010). *Statistikat e arsimit në Kosovë* (2009 – 2010).

Në Kosovë ekzistojnë 7 shkolla speciale: shkolla për fëmijët me dëmtime në të parë në Pejë, shkolla për fëmijët me dëmtime në të dëgjuar në Prizren, shkollat për fëmijët me dëmtime intelektuale në Prishtinë, Prizren, Mitrovicë dhe në Shtime. Po ashtu duhet të përmendim edhe një shkollë speciale në Veriun e Mitrovicës, ku vijnë fëmijët serbë, e cila nuk është e integruar në sistemin e MASHT-it dhe, si pasojë, nuk ka informata të mjaftueshme për të. Këto shkolla janë mjaft të shtrenjta dhe shërbejnë për një numër shumë të vogël nxënësish. Në vitin 2006, me ndihmën e FSDEK-së (Përkrahja Finandeze për Zhvillimin e Sektorit të Arsimit në Kosovë), u mor nisma për transformimin e këtyre shkollave në qendra burimore, pra kalimi nga një shkollë e sistemit të mbyllur në atë të hapur. Ky proces i transformimit vazhdon ende dhe nuk ka përfunduar. Synimi është që stafi i shkollave speciale të mos shërbejë vetëm për fëmijët që ndjekin mësimet në atë shkollë, por ai staf të ofrojë mbështetje edhe për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore që janë në shkolla të rregullta. Transformimi i këtyre shkollave është planifikuar të jetë i tillë që ato të shërbejnë si qendër burimore e përbërë nga dy njësi: nga njësia e shkollës speciale që do të organizojë dhe do të zbatojë mësimin për fëmijët që kanë aftësi të kufizuara të rënda dhe të shumëfishta dhe nga njësia apo qendra e shërbimeve të mbështetjes që do të mbështetë fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe arsimtarët e tyre në shkolla të rregullta. Planifikohet që në të ardhmen të bëhet riorganizimi i brendshëm i qendrave burimore ashtu që më tepër staf të kalojë në njësinë apo në qendrën e shërbimeve të mbështetjes. Gjithashtu është planifikuar që të punësohet staf i ri në qendrat burimore në mënyrë që të rritet kapaciteti i qendrave të shërbimeve të mbështetjes brenda qendrave burimore për të mbështetur nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në shkollat e rregullta ⁵

Qendrat burimore kanë si qëllim që të rritin kualitetin dhe të përgatitin mësimdhënien dhe të mësuarit sipas modelit të rrjedhës së rregullt shkollor. Roli qendror i qendrës burimore është që të përkrahë trajnimin në shërbim për të gjithë mësimdhënësit e nxënësve me nevoja të veçanta në klasat e tyre. Përmes konferencave, seminareve, buletinit informativ dhe përdorimit të internetit, qendrat burimore mund të përkrahin gjurmimin dhe përtëritjen lidhur me zhvillimin e praktikave interdisiplinare.

Krahas qendrave burimore në disa shkolla kanë filluar të funksionojnë klasat e bashkuara. Në këto klasa brenda shkollave të rregullta kanë ndjekur mësimet fëmijët me nevoja të

⁵ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, *Plani strategjik për organizimin e arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë* (2010 – 2015), Prishtinë, mars 2010.

veçanta. Me kalimin e kohës edhe këto klasa janë shuar dhe sot kemi përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta, madje në numër jo shumë të kënaqshëm dhe të përcjella me mjaft sfida e probleme.

Minoritetet në Kosovë ballafaqohen më një sërë problemesh në fushën e arsimit e veçmas kur bëhet fjalë për integrimin e tyre në arsim. Problemet fillojnë nga regjistrimi, pranimi nga komuniteti shumicë, statusi socio-ekonomik etj. Të tilla probleme komunitetin joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian e përcjellin jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë.

Në vitet e 90-ta minoritetet në Kosovë nuk patën edhe aq mundësi, gjendje që u vështirësua akoma më shumë në vitet deri më 1999. Në periudhën e luftës në Kosovë një numër i madh i tyre e lëshuan vendin dhe numri i pjesëtarëve të minoriteteve në Kosovë pësoi rënie. Zvogëlimi i numrit të tyre sikur i dha më tepër mundësi shkollimi kësaj kategorie, mirëpo prapë të shoqëruar me një sërë dukurish, si marginalizimi, diskriminimi, segregimi etj. Përfshirja e minoriteteve në jetën shoqërore dhe institucionale është trajtuar edhe në politikat e vendit.

Në vitin 2001, Kuvendi i Kosovës, në bazë të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, miratoi *Ligjin mbi edukimin parashkollor*, ku pos të tjerash në të gjejmë që “Gjithëpërfshirja (shih Konventa e të Drejtave të Fëmijës, neni 2)⁶ Shtetet Palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmendura në këtë Konventë dhe t’ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë.”⁷

Në vitin 2004 u hartua *Strategjia për arsimin e lartë në Kosovë (2005 – 2015)*, e cila pos të tjerash garanton që do të jetë gjithëpërfshirëse dhe se do të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë pavarësisht nga përkatësia etnike, gjinia, mosha, besimi dhe gjendja sociale. Kjo strategji i lë vendin pastaj *Strategjisë së shvillimit parauniversitar 2010 – 2017*, e cila parasheh po ashtu integrimin e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian.

⁶ Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, nëntor 1989.

⁷ Ligji nr. 02/I-52 mbi edukimin parashkollor, neni 1.

1. Përshkrimi i problemit

Kosova ka hartuar ligje dhe një sërë strategjish për gjithëpërfshirjen. Këto politika të hartuara ndër vite vazhdojnë të zbatohen, por shpesh ndodh edhe të mos gjejnë zbatimin e duhur. Këtë e dëshmon numri i lartë i fëmijëve me nevoja të veçanta jashtë institucioneve edukativo-arsimore, si dhe numri i fëmijëve nga radhët e minoriteteve që për arsye të ndryshme socio-ekonomike, të diskriminimit, segregimit dhe mospranimit nga shumica, shpeshherë i gjejnë jashtë shkollave.

Gjithëpërfshirja është një kusht mjaft i rëndësishëm që i është vendosur Kosovës si shtet i ri për t'u pranuar nga Bashkimi Evropian, andaj duhet gjetur mekanizma e strategji që një gjë e tillë të mos mbetet thjesht vetëm pjesë e dokumenteve të ndryshme, por të gjejë zbatim. Deri më tani lidhur me këtë problematikë, megjithëse është punuar dhe madje kohët e fundit vazhdon të punohet edhe më tepër, qoftë me mbështetje të organizatave të huaja apo edhe nga mekanizmat shtetërorë të vendit, rezultatet vazhdojnë të jenë jo të mira.

Një hulumtim më i thellë i këtyre politikave do të ofronte shpjegime të reja teorike për rolin e politikave arsimore në zbatimin e një të drejte, siç është e drejta e çdo individi për shkollim pa asnjë dallim si dhe do të sillte mundësi, ide e strategji të reja për të ndihmuar procesin e gjithëpërfshirjes dhe, me theks të veçantë, të përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta dhe atyre minoritarë në shkollimin e rregullt.

Në këndvështrimin personal, ky studim u vlerësua i nevojshëm të kryhet për arsye se modeli i zgjedhur në studim ofron një mundësi të re për të bërë vlerësim më të thelluar, nisur nga këndvështrimi i aktorëve më kryesorë (mësues, drejtues të shkollave të zakonshme, prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara – pjesë të procesit), si dhe nga çështjet e fokusuara në zbatimin praktik të arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme, si:

- (a) ndikimi i procesit të gjithëpërfshirjes së nxënësve në praktikat gjithëpërfshirëse, të lidhura me vlerësimin fillestar, programet edukative individuale dhe punën individuale me nxënësit me aftësi të kufizuara;
- (b) përgatitja / formimi i mësuesve për të punuar me nxënës me aftësi të kufizuara dhe të minoriteteve, si kualifikimi, trajnimi, stimulimi i tyre, bashkëpunimi i mësuesve me profesionistë të tjerë;
- (c) infrastruktura mbështetëse e shkollës, përshtatshmëria ndërtimore, mjete të përshtatshme mësimore, transporti, materialet dhe mjetet didaktike, ambientet burimore, mësuesi mbështetës, organizimi i klasave;

(d) përfshirja e prindërve në procesin e gjithëpërfshirjes së fëmijëve të këtyre kategorive, bashkëpunimi i tyre me mësuesit dhe shkollën;

(e) përfitimet akademike dhe sociale të këtyre nxënësve nga procesi i gjithëpërfshirjes;

(f) qëndrimet e prindërve të nxënësve të tjerë kundrejt procesit të gjithëpërfshirjes.

Duke qenë se ky studim mbështetet në parimin e garantimit të së drejtës për arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të fëmijëve të minoriteteve, rezultatet e tij mund të shërbejnë për të nxitur dhe për të mbështetur lëvizjet e grupimeve të prindërve të këtyre fëmijëve, organizatat e fushës së fëmijëve me aftësi të veçanta dhe rrjetet e tjera të interesit në proceset avokuese, në realizimin e plotë të gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të veçanta dhe atyre të minoriteteve në shkollat e rregullta.

2.Qëllimi i punimit

Qëllimi i punimit është pasqyrimi i gjendjes reale të përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta dhe atyre nga radhët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin themelor, si dhe dhënia e ideve dhe e propozimeve për përmirësimin dhe avancimin e kësaj gjendjeje.

3.Objektivat specifike të hulumtimit

a. Qëndrimet e mësuesve për politikën, praktikën dhe kulturën e shkollës që synojnë pranimin e FNV-së dhe të minoriteteve, si dhe mbështetja e koordinuar mësues – prindër;

b. Qëndrimet e prindërve të FNV-së dhe të minoriteteve për politikën e shkollës, për format, arritjet, metodat e pranimit, të bashkëveprimit dhe të mësimdhënies në shkollë;

c. Qëndrimi i prindërve të nxënësve të tjerë për shqetësimet që ata kanë ndaj pranisë së kategorive të lartcekura në klasën e fëmijës së tyre;

d. Rëndësia e përfshirjes së të gjithë fëmijëve në arsimin e obliguar pa dallim;

e. Mekanizmat mbështetës që do të lehtësonin përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta;

f. Rëndësia e harmonizimit të politikave dhe legjislacionit të sistemit arsimor të Kosovës me atë të BE-së në fushën e gjithëpërfshirjes;

g. Roli i MASHT-it në mbikëqyrjen e zbatimit të politikave arsimore për gjithëpërfshirjen në arsim.

4. Hipotezat e punimit

Duke u bazuar në preokupimet nga gjendja aktuale e politikave arsimore dhe në kërshërinë lidhur me shumë elemente përbërëse të arsimit të vendit tonë, në mënyrë që të përcaktojmë rezultate dhe të vëmë në pah shkaqe të ndryshme, pyetjet e adresuara dhe shqetësuese të këtij hulumtimi janë të paraqitura më poshtë.

5. Pyetjet e hulumtimit

1. Sa është numri i fëmijëve të kategorisë së fëmijëve me nevoja të veçanta dhe atyre të minoriteteve të përfshirë në shkollat e rregullta në Kosovë?
2. Deri në çfarë mase janë të neglizhuar dhe cilët janë shkaktarët e mospërfshirjes së tyre në shkollat e rregullta?
3. Cili është qëndrimi i drejtorëve të shkollave përkitazi me akceptimin e këtyre dy lloj kategorive në shkollat e tyre dhe sa pajtohen mësimdhënësit të punojnë në klasa të bashkuara?
4. Cili është roli i MASHT-it lidhur me zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse arsimore?
5. Sa është harmonizuar legjisllacioni në fuqi me atë të BE-së?

6.Hipotezat e hulumtimit

Hipoteza 1. Politikat arsimore të gjithëpërfshirjes nuk monitorohen mjaftueshëm nga politikëbërësit, nëse ato janë duke u zbatuar si duhet ose jo.

Hipoteza 2. Politikat arsimore të gjithëpërfshirjes nuk kanë gjetur zbatim të duhur për kategorinë e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian dhe për kategorinë e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Hipoteza 3. Politikat arsimore të gjithëpërfshirjes janë të mbështetura në politikat dhe standardet e BE-së.

7. Metodologjia e punimit

Studimi do të jetë përshkrues, i realizuar si një rast studimor për vlerësimin e modelit të arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të veçanta dhe atyre të minoriteteve në disa shkolla të rregullta të komunave të ndryshme të Kosovës. Kampioni do të përzgjidhet përmes një metode selektive, duke marrë një kampion përfaqësues jorastësor.

Për mbledhjen e të dhënave do të përdoret një metodologji e kombinuar, sasiore dhe cilësore, që synon t'u japë përgjigje çështjeve themelore të ngritura në studim. Hulumtimi do të prodhojë njohuri origjinale empirike mbi temën bazuar në gamën e gjerë të burimeve parësore dhe dytësore.

Burimet primare do të gjenerohen përmes intervistave me organet kompetente për arsim (MASHT), intervista me mësimdhënës, prindër të të dyja kategorive që do të studiohen në këtë punim dhe drejtorë të shkollave të rregullta.

Si burime dytësore do të përdoren dokumentet zyrtare të arsimit dhe të gjithëpërfshirjes, literaturë akademike dhe revista, botime mbarëkombëtare, studime të politikave të ofruara për arsim, si dhe revistat relevante që lidhen me temën e këtij punimi.

8. Kufizimet dhe vështirësitë

Ky hulumtim është përshtatur me kufizime gjeografike dhe kohore.

Kufizimi gjeografik: hulumtimi në fjalë do të realizohet në disa qendra më të mëdha të Kosovës, si: Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë, Pejë, Gjiçani, Podujevë, Ferizaj dhe Deçan.

Kufizimi kohor: Afati kohor i studimit do të mbulojë gjendjen e arsimit që nga periudha pas luftës (afërsisht pas vitit 2000) deri në vitin 2011, kur aprovohet Kurrikula e re, por ky studim do të përfshijë edhe gjendjen deri në vitin 2017.

Një tjetër kufizim që mund të merret parasysh si mangësi në këtë studim është edhe probabiliteti i përgjigjeve joreale në disa raste të pyetësorëve nga ana e të anketuarve.

9. Çfarë synohet të arrihet?

Hulumtimi pritet të japë rezultatet e mëposhtme:

- Evidentimi i faktorëve veprues, roli dhe rëndësia e tyre në mbarëvajtjen e FNV-së dhe minoriteteve;
- Kontributet origjinale për fillimin e vijimit të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe minoriteteve në shkolla të rregullta;
- Fuqizimi legjislativ i gjithëpërfshirjes për këto dy kategori;
- Sigurimi e një kontributi të ri praktik për orientimin e politikave adekuate për gjithëpërfshirje;
- Shpjegimi i mundësive dhe i kufizimeve të zbatimit të politikave arsimore të gjithëpërfshirjes.

10. Rëndësia e hulumtimit

Hulumtimi do të jetë dobiprurës dhe me interes të veçantë, sepse qysh në fillim pasqyron gjendjen e politikave të arsimit gjithëpërfshirës dhe historinë e saj deri në ditët e sotme, si dhe rolin e MASHT-it në fuqizimin e këtyre politikave. Gjithashtu, evidenton faktorët e supozuar lidhur me mosvijueshmërinë e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe të minoriteteve, që ngjallin interes për t'i kuptuar dhe për t'i deshifruar.

Qasja provuese dhe realizuese do të sjellë një origjinalitet të fortë në këtë hulumtim, pasi do të shtjellohen shkaqet dhe qëllimet e këtij hulumtimi në thellësi dhe burimet do të jenë nga aktorë me një hierarki profesionale. Hulumtimi do të ofrojë një kontribut shkencor origjinal në fushën e studimeve edukativo-arsimore dhe do të hapë një dritare për inovacione në këtë fushë. Po ashtu do të nxitë të kuptuarit e drejtuesve për të bërë zgjedhjet dhe zbatimin e politikave arsimore në gjithëpërfshirjen e kategorive të studiuara në punim.

11. Përshkrimi i situatës

Kosova, një shtet relativisht i ri dhe i dalë vonë nga lufta, është ballafaquar dhe ballafaqohet me një sërë sfidash në fusha të ndryshme, përfshirë këtu edhe fushën e arsimit. Gjithëpërfshirja, si koncept relativisht i ri, edhe pse i përfshirë dhe i mbështetur nga mjaft dokumente, akoma nuk ka gjetur mbështetjen dhe aplikimin e duhur.

Janë dy kategori që konsiderohen si kategori me më shumë rrezik dhe të papërfshira kënaqshëm në arsimin e obliguar: kategoria e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe ajo e minoriteteve.

Ekzistojnë një sërë dokumentesh të nxjerra nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë që e mbështesin gjithëpërfshirjen në arsim, prandaj edhe po i listojmë si në vijim:

- *Ligji mbi arsimin parauniversitar* (2011): Gjithëpërfshirja si koncept e përshkon tërë ligjin që është i bazuar në *Deklaratën e Salamankes* mbi gjithëpërfshirjen dhe në *Konventën mbi të drejtat e njeriut*. Po ashtu ligji përmban nene të veçanta që rregullojnë arsimin e fëmijëve / nxënësve me nevoja të veçanta. Ligji i ri krijon bazën e mjaftueshme ligjore që sistemi arsimor në Kosovë të jetë gjithëpërfshirës.

- *Korniza e kurrikulumit të Kosovës*: Një nga parimet kryesore mbi të cilat është ndërtuar *Korniza e kurrikulumit të Kosovës* është gjithëpërfshirja. *Korniza e kurrikulumit* është në linjë me *Arsimin për të gjithë dhe qëllimet zhvillimore të mileniumit*, duke synuar të ofrojë qasje të barabartë në arsim cilësor për gjithë nxënësit, pa marrë parasysh gjininë, aftësinë e veçantë, etnicitetin, moshën, statusin ekonomik e shoqëror, ngjyrën e lëkurës, kulturën, gjuhën dhe besimet.” Njësia e arsimit special është pjesë e këtij procesi.

- *Plani strategjik për arsimin e Kosovës – PSAK (2011 – 2016)*: Ky është një plan pesëvjeçar që lidh arsimin gjatë gjithë jetës me përfshirjen në arsim dhe një model për të arritura të të gjithë nxënësve, si dhe ofron mundësi të barabarta në arsimim cilësor për të gjithë. Në këtë plan strategjik arsimi i fëmijëve me nevoja të veçanta i referohet *Planit strategjik për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin parauniversitar (2010 – 2015)*, dokument që është hartuar në vitin 2010.

- *Plani strategjik për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin parauniversitar 2010 – 2015*: Ky plan strategjik veprimi përcakton në mënyrë të strukturuar dhe të integruar se të trajtohet çështja e procesit të gjithëpërfshirjes dhe si t’i qasesh asaj, por në një aspekt më praktik dhe më funksional. Vizioni i kësaj strategjie është për të pasur “një sistem arsimor cilësor për të gjithë fëmijët, duke marrë parasysh dhe duke respektuar nevojat individuale, interesat dhe mundësitë secilit fëmijë.” MASHT-i i referohet këtij plani strategjik për arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

- *Plani individual i arsimit – PIA (dokument pedagogjik)*: PIA është dokument zyrtar pedagogjik i hartuar për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, për të cilët ekipi vlerësues i ekspertëve të fushave të ndryshme zhvillimore ka marrë vendimin për edukim dhe arsimim e kësaj kategorie. PIA shërben për planifikimin sistematik të edukimit e të mësimdhënies dhe për mbështetjen dhe përcjelljen e përparimit individual të fëmijës në mësim. Plani është duke u zbatuar në shume institucione arsimore në gjithë Kosovën.

KAPITULLI I

Historiku i sistemit arsimor në Kosovë

1. Politikat arsimore dhe sistemi paralel i arsimit në Kosovë (1990 – 2000)

Në vitin 1989, atëherë kur autonomia e Kosovës në ish-Jugosllavi u suprimua nga regjimi serb, i drejtuar nga Slobodan Millosheviqi, Kosova humbi të gjitha fuqitë legjislative dhe ekzekutive, duke përfshirë edhe ato që kishin të bënin me arsimin. Çdo vendim rreth kurrikulave dhe librave shkollorë tani merrej në Beograd. U bënë ndryshime në kurrikula e sidomos në lëndë si historia, gjeografia dhe gjuha shqipe. Kjo me qëllim që studentëve kosovarë t'u servoheshin informacione dhe të dhëna të rreme lidhur me historinë e popullit, dhe shtrirjen territoriale. Më e keqja është që ata kishin qëllim që të dobësonin ndjenjën e të rinjve për përkatësinë e tyre kombëtare.

Një vit më vonë, në vitin 1990, Serbia filloi segregimin në shkolla shqipe, duke mbajtur mësim nxënësit serbë paradite dhe ata shqiptarë pasdite. Sipas tyre, kjo u bë me qëllim që studentët serbë të ndiheshin më të sigurt, sepse ata pretendonin që nuk po ndiheshin të sigurt për shkak se numri i studentëve shqiptarë ishte shumë më i madh dhe shkollat në ndërrimin e pasdites ishin të tejmbushura me nxënës.

Në këtë vit në shkollat shqipe ndodhi helmimi i nxënësve kryesisht shqiptarë, gjë që ndodhi gjatë tërë vitit në vazhdimësi, duke çuar numrin e nxënësve të helmuar deri në 8000.

Në vitin 1990 shqiptarët shpallën Kosovën republikë të ish-Jugosllavisë me qëllim të sfidimit të shtetit serb, i cili po e rriste në vazhdimësi shtypjen dhe presionin ndaj shqiptarëve të Kosovës. Kjo republikë sigurisht që nuk u njoh nga shteti serb, mirëpo shqiptarët e Kosovës në këtë mënyrë filluan organizimin e një shteti paralel.

Në vitin 1991, kur Serbia po bënte luftë me Kroacinë, policia serbe në Kosovë rrethoi shkollat shqipe duke larguar të gjithë mësimdhënësit dhe nxënësit nga shkollat. Mësimdhënësit që refuzuan të punonin me plan-programe serbe u larguan nga puna dhe disa edhe u burgosën, ndërsa drejtorët e shkollave shqiptare u zëvendësuan me ata serbë.

Mbi 400 mijë studentë shqiptarë nuk vijuan mësimet për një vit deri në janar të vitit 1992. Gjatë kësaj kohe sa nuk u zhvillua mësim, të gjithë u mobilizuan për të gjetur shtëpi e bodrume që u shndërruan në shtëpi-shkolla.

Në pranverën e vitit 1992 Kosova formoi sistemin paralel të arsimit.

Me gjithë përpjekjet që u bënë dhe realizimin mjaft të mirë të sistemit paralel, prapë një numër i madh nxënësish braktisën shkollën. Sipas disa dokumenteve, një numër i konsiderueshëm lanë vendin dhe shkuan në vende të tjera e një numër i madh që braktisën shkollën ishin vajza që jetonin në zonat rurale, prindërit e të cilave nuk ndienin siguri t'i dërgonin në shkollat-shtëpi për shkak të patrullimeve të mëdha të forcave serbe.

Sistemi arsimor paralel në Kosovë ishte më shumë sesa angazhim kundër zbrapsjes së analfabetizmit të shqiptarëve. Ishte gjithashtu mjeti kryesor përmes të cilit shqiptarët po mundoheshin të realizonin republikën. Gati të gjithë në Kosovë ishin të përfshirë në këtë ushtrim të shtetndërtimit: mësuesit, studentët, prindërit, si dhe të gjithë ata që kontribuan financiarisht dhe ofruan shtëpitë e tyre. Kosova po organizonte një sistem arsimor publik paralel, si dhe, në thelb, një shtet paralel. Ashtu siç e shpjegon Judah, “nëse flasim nga perspektiva politike, shkollat kishin një ndikim të jashtëzakonshëm, sepse të gjitha dokumentet shkollore vuloseshin sikur ishin botuar nga ‘Republika e Kosovës.’”

Në vitin 1996, me ndihmën e ndërmjetësuesve të huaj, Ibrahim Rugova dhe Millosheviqi sikur arritën një marrëveshje për t'i kthyer studentët shqiptarë në universitet. Kjo marrëveshje nuk u mbajt nga pala serbe dhe studentët shqiptarë përfunduan sërish në shtëpitë-shkolla.

Për shkeljen e kësaj marrëveshjeje, studentët shqiptarë më 1 tetor 1997 bënë një protestë të madhe në të cilën u kërkua respektimi i marrëveshjes. Edhe pse ajo protestë u shtyp dhunshëm nga forcat serbe, protesta të tjera u riorganizuan në vazhdimësi për t'u treguar atyre që më frika nuk ishte mes tyre. Këto protesta të vazhdueshme e sfiduan pushtetin serb. Kjo periudhë përfundoi me një luftë të ashpër që ndodhi në Kosovë, për pasojë shumë shkolla u dogjën dhe u shkatërruan.⁸

⁸ <https://kallxo.com/rrefim/mesime-ne-rezistence-sistemi-paralel-arsimit-ne-kosove-ne-vitet-90/>

2. Ndërtimi i sistemit arsimor në Kosovë nga viti 2000 e deri më sot

Periudhën nga viti 1999 e këtij e karakterizuan shumë elemente. Po ndodhte një reformim i plotë i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet në përputhshmëri me standardet më të larta ndërkombëtare. Ky reformim përfshinte: qëllimet arsimore në ndërtimin e aftësive mendore, shkathtësitë profesionale, kulturën qytetare dhe mirëqenien individuale e shoqërore të qytetarëve të Kosovës; Zbatimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies e mësimnxënies, të bazuara në standarde dhe objektiva mësimore; Zgjerimin e sistemit të arsimit të obligueshëm për një klasë dhe organizimi i arsimit privat si alternativë dhe konkurrues në zhvillimin e arsimit në Kosovë.

Si hap i parë i këtij sistemi merret themelimi i Departamentit të Arsimit dhe Shkencës (DASH), i cili ishte përgjegjës për të gjitha çështjet që kishin të bënin më arsimin në Kosovë. Në atë kohë u bë një lloj decentralizimi i kompetencave menaxhuese nga DASH-i në komunat përkatëse e që më vonë komunat mëtuan që të bartnin pastaj decentralizimin nga to nëpër shkolla, mirëpo një gjë e tillë u vërejt fare pak ose aspak. Që nga ajo kohë e tutje vazhdojmë të kemi një sistem arsimor mjaft të centralizuar.

Për të intervenuar në fusha të caktuara të sistemit arsimor atë kohë DASH-i kishte angazhuar duke ua besuar punën disa agjencive udhëheqëse që ishin edhe bartëse të projekteve të ndryshme të donatorëve evropianë për përmirësimin e sistemi arsimor në Kosovë. U emëruan këto agjenci, si në vijim:

1. Zhvillimi i kurrikulave – UNICEF;
2. Edukimi parashkollor – UNICEF;
3. Trajnimi i mësimdhënësve – Qeveria e Kanadasë;
4. Arsimi special – Qeveria e Finlandës;
5. Arsimi profesional – Bashkëpunimi Teknik Gjerman (GTZ).

Arsimi i lartë, arsimi i mesëm, arsimi special, edukimi parashkollor etj. menaxhoheshin direkt nga DASH-i. Ndërkaq, si detyrë ekskluzive e DAA-ve ishte implementimi i politikave të DASH-it, ku përfshiheshin çështjet që kishin të bënin me zbatimin e kurrikulës, vlerësimin e nxënësve dhe të shkollës, metodologjitë e mësimdhënies, punësimin dhe pushimin e punëtorëve të arsimit nga puna, ndërkohë që përgjegjësi primare e DKA-ve ishte menaxhimi i resurseve materiale, shërbimeve ndihmëse të shkollës, përkujdesja për transportin e nxënësve e të ngjashme.⁹

Kjo etapë pastaj u përcoll me krijimin e infrastrukturës ligjore dhe profesionale, e cila duhej të lehtësonte lidhur me reformimin rrënjësor të arsimit (sistemi 5 + 4 + 3 - 4 në arsimin e përgjithshëm dhe në atë profesional dhe Marrëveshja e Bolonjës në arsimin e lartë), si dhe me themelimin e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë në mars të vitit 2002.

Pas themelimit të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë në vitin 2002, lindi nevoja për hartimin e një plani strategjik për zhvillim të arsimit në Kosovë. Si rrjedhojë nga udhëheqësit u formua asokohe një grup punues në të cilin u përfshinë ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë detyrë e të cilëve ishte hartimi i *Planit strategjik 2002 – 2007*.

Grupi i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë arritën të përfundonin punën në maj të vitit 2003. Kështu ata prodhuan të ashtuquajturin plan të parë për të nxjerrë arsimin nga ajo gjendje emergjente dhe për të konsoliduar atë, gjithmonë duke pasur parasysh edhe integrimin në rrjedhat dhe proceset evropiane. Edhe pse brenda këtij ekipi ekspertësh që hartuan këtë plan strategjik nuk kishte pjesëmarrës që praktikonin arsimin dhe ballafaqoheshin me sfidat e përditshme të një sistemi arsimor të dalë nga paslufta, rezultoi të jetë një plan i mirë dhe një udhërrëfyes pune për vitet 2002 – 2004. Planit ishte i përqendruar kryesisht në zhvillimin e plan-programeve dhe të teksteve të reja të përshtatshme për zbatimin e këtyre plan-programeve.

Megjithatë në vitin 2005 u bë një vlerësim i procesit të plan-programeve nga Instituti i Edukimit i Londrës. Në atë kohë tashmë po përfundonte zhvillimi i plan-programeve të reja, shumica e plan-programeve ndërkombëtare për mbështetjen e arsimit në vendin tonë kishin përfunduar ose ishin procesuar tashmë në fazën e tyre të dytë, kur projekti i Bankës Botërore për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim ngadalë po i afrohej përfundimit dhe në kohën kur ishte zhvilluar tashmë *Strategjia për zhvillimin e arsimit të lartë 2005 – 2015*, u kuptua

⁹ D. Pupovci, H. Hyseni, J. Salihaj, *Arsimi në Kosovë*, 2001.

se strategjia e deritanishme tanimë nuk ishte e mjaftueshme sidomos për dy pika mjaft të rëndësishme, siç ishin zhvillimi i kapaciteteve të mësimdhënësve dhe administrata.

Tashmë kur arsimi në vend e kishte kaluar atë fazën emergjente, u rrit interesimi edhe për dokumente e strategji të rëndësishme edhe të vendeve të tjera të zhvilluara që kishin ndikim mjaft të rëndësishëm në reformimin e sistemit arsimor, siç ishin Procesi i Lisbonës që përfshinte reformat arsimore në Evropë deri në vitin 2020 dhe Deklarata e Kopenhagës për zhvillim të arsimit dhe aftësimit profesional.

Në korrik të vitit 2005 u vendosën pikat e një plani afatmesëm strategjik për zhvillimin e arsimit për periudhën 2007 – 2017, të cilat ishin:

- a) të themelohet Këshilli i Ekspertëve për Arsimin Parauniversitar për koordinimin e procesit të zhvillimit dhe të zbatimit të *strategjisë*;
- b) procesi i strategjisë së arsimit parauniversitar të bazohet në përvojat pozitive të procesit të strategjisë së arsimit të lartë;
- c) të krijohet një strukturë mbështetëse e procesit (agjenci implementuese, sekretariat, konsulencë) për të siguruar zhvillim koherent dhe të papenguar të procesit dhe
- d) hartimi i një strategjie të veçantë të komunikimit si për procesin e strategjisë, ashtu edhe për informimin e opinionit për zhvillimet arsimore në Kosovë në përgjithësi.

Pjesë e këtyre punëtorive padyshim që ishin marrë faktorë të rëndësishëm që pastaj do të përballeshin me këtë proces, si mësimdhënës, administratorë e zyrtarë të ndryshëm të arsimit nga mbarë vendi, duke mos harruar edhe ekspertë që ishin përfshirë edhe në strategjinë paraprake 2005 – 2015.

Derisa strategjia për zhvillimin e arsimit ishte në përgatitje e sipër rëndësi e madhe iu kushtua edhe cilësisë së mësimdhënies dhe programeve të ndryshme për aftësimin e mësimdhënësve, kur dihet se vendi kishte kaluar nëpër një periudhë të gjatë okupimi dhe zhvillimi i mësimdhënësve dhe përballja e tyre me metodologji të reja të mësimdhënies linte shumë për të dëshiruar.

Fakulteti i Edukimit, institucion që përgatiste mësimdhënësit, përgatiti programe të ndryshme për aftësimin dhe përgatitjen e mësimdhënësve. Kështu, mbi 7 mijë mësimdhënës u përfshinë në trajnime të ndryshme, duke filluar nga ai për qasjen me nxënësin në qendër, për të vazhduar me filozofi të reja të mësimdhënies, si gjithëpërfshirja, ndërveprimi dhe

përqendrimi më i madh te shkathtësitë, kur dihet se sistemi ynë arsimor deri në atë kohë ishte më tepër sistem teorik se praktik.

Në disa pika u krijuan qendrat didaktike në të cilat trajnoheshin mësime dhënësit e të gjitha vendeve rurale e urbane. Rol të rëndësishëm luajti edhe Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), e cila filloi me zbatimin e programit “Hap pas Hapi”, program në të cilin u trajnua një numër i konsiderueshëm i mësime dhënëseve, për të vazhduar pastaj me programin “Zhvillimi i Mendimit Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit” (MKLSH), program që asokohe certifikoi mbi 3 mijë mësime dhënëse, kurse edhe sot e kësaj dite vazhdon të organizohet nga OJQ të ndryshme, duke u vlerësuar si program me rëndësi mjaft të madhe që edhe sot mbetet i kërkuar edhe nga vetë mësime dhënësit.

Të gjitha këto aktivitete të ndërmarra nga MASHT-i dhe mbështetës të arsimit kosovar nga vendet e zhvilluara dhe mbështetëse për vendin tonë ndikuan që të përmirësohej cilësia e mësime dhënies dhe të ndryshoheshin raportet brenda klasës.

Pos programeve të shumta të trajnimeve e rëndësishme, vlen të përmendet edhe fakti i hartimit të shumë rregulloreve që kishin për qëllim të siguronin qëndrueshmërinë e ndryshimeve të ofruara dhe të bëra deri atëherë. Po ashtu u rritën kapacitetet për të trajnuar dhe për të aftësuar grupe të caktuara mësime dhënëse të fushave të ndryshme. Detyrë e këtyre trajnimeve ishte bartja e njohurive të mësime dhënësit e tjerë me anë të organizimit të trajnimeve.

I gjithë ky proces ishte shoqëruar me hartimin e shumë materialeve mbështetëse të këtyre trajnimeve për të lehtësuar punën e mësime dhënëseve.

Rol mjaft të rëndësishëm kishte luajtur edhe Programi Kanadez për Aftësimin e Mësime dhënëseve Kosovare (KEDP), duke bashkërenduar përpjekjet e organizatave të ndryshme që kishin ofruar programe aftësimi, duke ndihmuar në hartimin e rregulloreve dhe në themelimin e Fakultetit të Edukimit, duke organizuar një sërë trajnimesh, duke mbështetur mësime dhënësit dhe duke organizuar botimin e materialeve të rëndësishme për zhvillimin dhe aftësimin profesional të mësime dhënëseve.

Shikuar për nga volumi dhe përpjekjet e bëra nuk mund të themi që nuk u bë shumë për përmirësim të cilësisë së mësime dhënies dhe ngritjes së cilësisë në arsim, mirëpo shikuar nga aspekti i vlerësimit të ekspertëve u konstatua se akoma në arsimin kosovar kishte shumë vështirësi, veçmas në fushën e mësime dhënies dhe në përgatitjen e mësime dhënëseve.

Ky grup ekspertësh vuri në pah një sërë problemesh, si numrin e konsiderueshëm (15 %) të mësimitdhënësve të pakualifikuar, mospasjen e një rregulloreje për të akredituar programet e trajnimeve të ofruara nga organizata të ndryshme, vonimin e procesit të licencimit të mësimitdhënësve dhe, në mënyrë të veçantë, pagat demotivuese të mësimitdhënësve, të cilat, megjithëse ndryshuan ndër vite, nuk ndikuan mjaftueshëm në rritjen e cilësisë në arsim.

Shqetësim tjetër i këtij grupi ishte edhe mospërfshirja e të gjithë mësimitdhënësve në këto programe reformuese aftësimi e trajnimi. Të gjitha këto konstatime bënë që akoma t'i jepej vëmendje e nevojshme dhe e mjaftueshme mësimitdhënies cilësore në mënyrë që të ndërtonim një sistem arsimor cilësor.

Pas këtij konstatimi tanimë vëmendja nuk ishte te plan-programet, por te mësimitdhënia, gjegjësisht tek aftësimi dhe përgatitja e tyre profesionale për të pasur mësimitdhënie sa më cilësore.

Po ashtu, një sfidë e rëndësishme që u rekomandua për trajtim nga ky grup dhe nga grupi për financa ishte edhe propozimi për reformim të sistemit të pagave në sektorin e arsimit, në mënyrë që të sigurohet sistem më i drejtë dhe më motivues i kompensimit të personelit arsimor i bazuar në meritë, përvojë, shkathtësi dhe në shkallë të kualifikimit.

Duke pasur parasysh që Kosova doli nga një luftë e ashpër që shkatërroi gjithçka e, mes të tjerash, edhe objektet shkollore, atëherë domosdoshmërisht lindi nevoja për rimëkëmbjen e tyre për të filluar funksionalizimin e sistemit arsimor në vend.

Është më se e qartë se Kosova nuk do të mund ta bënte këtë gjë pa mbështetjen e miqve ndërkombëtarë, andaj investimet e donatorëve ndërkombëtarë, investimet e institucioneve vendore, si dhe ato nga ana e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian ndihmuan në përmirësimin e gjendjes së objekteve shkollore, në mënyrë që në vitin 1999 – 2000 të ishte i mundur fillimi i procesit mësimor.

Donatorët ndërkombëtarë që kontribuan ishin të shumtë, ndër të cilët po përmendim këtu UNICEF-in, Agjencionin Evropian për Rindërtim, Bankën Islamike për Zhvillim dhe shtete individuale, si Gjermania, Zvicra, Holanda, Danimarka, Japonia e të tjerë, që investuan shuma të konsiderueshme për të krijuar kushte fizike për organizim të mësimi pas shkatërrimeve të fundit të viteve të nëntëdhjeta dhe të mungesës së çfarëdo mirëmbajtjeje nga shteti në shkollat kosovare për më se njëzet vjet.

Përpos ndihmës së ofruar në ndërtimin e objekteve, këto organizata dhe shtete ndihmuan edhe në pajisjen e tyre me inventarë, me mjete të teknologjisë informative që deri atë kohë nuk kishte nëpër shkollat tona, ofruan shumë programe për promovimin e shkollave të shëndetshme, ndikuan në përmirësimin e mjedisit për mësimdhënie dhe mësimnxënie etj. Që të gjitha këto shiheshin si një parakusht shumë i mirë për një arsim cilësor.

Me kalimin e kohës, kur tashmë edhe prindërit po sensibilizoheshin për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla, lindi nevoja edhe për investime shtesë infrastrukturore në mënyrë që ambienti fizik të përshtatej për këta fëmijë. Një gjë të tillë e kërkonte edhe ligji për arsim dhe kjo ishte konform politikave të gjithëpërfshirjes.

Nga viti 2002 investitorët e huaj gradualisht po largoheshin dhe tani një barrë e tillë, pra ajo e investimeve dhe e sigurimit të infrastrukturës fizike, iu vu institucioneve vendore. Nga ai vit e deri në vitin 2005 u rinovuan diku rreth 39 objekte dhe u ndërtuan 28 objekte të reja shkollore nga ana e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë. Në këtë mënyrë u pa qartë se u përmirësuan në masë të madhe kushtet fizike në shkollat e Kosovës.

Shumica e shkollave të ndërtuara pas luftës u ndërtuan në vendet e shkollave të vjetra të kohës së paraluftës. Kishte edhe raste kur nuk ishte marrë parasysh zhvendosja e popullatës nga një zonë, veçmas nga ajo rurale në atë urbane dhe shkolla e re ishte ndërtuar për nevoja të një numri shumë të vogël nxënësish. Një shpërputhje e tillë ndërmjet lëvizjeve demografike dhe ndërtimit e rinovimit të shkollave ishte evidente në pjesë të shumta të Kosovës dhe, rrjedhimisht, disa qytete përfunduan me shkolla të mbingarkuara dhe me mësim në më shumë se dy ndërrime, në kohën kur në disa fshatra kishte hapësirë për zhvillim të mësimi tërëditor.

Edhe pse u ndërtuan këto objekte shkollore, pati probleme në vazhdimësi në shumë aspekte e veçmas në atë të mirëmbajtjes dhe menaxhimit të tyre. Ndër të tjera, mungonte edhe bashkëpunimi me komunitetin joshumicë (rom, ashkali dhe egjiptian), i cili po të ishte i mirorganizuar dhe i motivuar do të ndikonte shumë në investime të vazhdueshme dhe të nevojshme në shkolla. Element tjetër me rëndësi ishte edhe mungesa e buxhetit për mirëmbajtje dhe menaxhim, si dhe menaxhimi jo i mirë ose keqmenaxhimi i mjeteve dhe i pajisjeve të sjella nëpër shkolla etj.

Të gjitha këto ndikuan që investitorët të largoheshin gradualisht dhe të mos ofronin më mbështetjen e tyre për këto institucione. Edhe pse në vazhdimësi ngrihet si diskutim nëse infrastruktura fizike ndikon në cilësi, për çka ka edhe mendime të ndryshme, lirisht mund të

thuhet se infrastruktura është element me ndikim të theksuar në cilësinë në arsim. Planifikimi i masave për sigurimin e punës në së paku dy ndërrime deri në vitin 2010 dhe sigurimi i zhvillimit të balancuar teknologjik dhe infrastrukturor në mes të zonave rurale dhe urbane janë dy nga sfidat kryesore të kësaj strategjie 2007 – 2017 dhe të punës së institucioneve arsimore në periudhën e ardhshme afatmesme. Për këto probleme është diskutuar mjaft nga grupi punues dhe lidhur me këtë çështje dhe atë të teknologjisë informative janë propozuar masa konkrete në mënyrë që të përmirësohet situata dhe të gjitha këto të jenë në shërbim të cilësisë në arsim, gjegjësisht në ngritjen e saj.¹⁰

Është më se e qartë se arsimi parauniversitar në Kosovë ka një rëndësi të veçantë dhe pothuajse gjithmonë i gjithë fokusi bie mbi të. Kjo për faktin se konsiderohet si bazë e arsimit të lartë. Në Kosovë deri në vitin 2000 ekzistonin një sërë mekanizmesh që kishin për qëllim ngritjen e cilësisë në arsim, si Enti Pedagogjik i Kosovës, entet pedagogjike komunale dhe pedagogët në shkolla, të cilët u zhbënë në vitin 2000 me një vendim të UNMIK-ut.

Pas kësaj u krijuan në Kosovë institucione, si Instituti Pedagogjik i Kosovës dhe Inspeksioni i Arsimit, por të cilave iu dhanë detyra të tjera dhe jo sigurimi i cilësisë. Ligji për arsimin në komuna, menjëherë pas shpalljes së pavarësisë në Kosovë, sjell disa risi, ndër të cilat vend të rëndësishëm zë edhe sigurimi i cilësisë. Ky ligj një numër të konsiderueshëm autorizimesh i bart në nivelin qendror dhe lokal. Por ky ligj, duke qenë se erdhi shumë shpejt, gjë që komunat i zuri të papërgatitura sa i përket kuadrit që do të merrej me këto punë, hasi vështirësi edhe sa i përket aspektit logjistik. Për t'u ardhur në ndihmë sa i përket sigurimit të cilësisë, tani në arsim shfaqet projekti i binjakëzimit, i financuar nga BE-ja "Mbështetje për zbatimin e Planit strategjik të sektorit të arsimit në Kosovë 2011 – 2016".

Periudha shtator 2014 – korrik 2015 është periudha e planifikimit të kësaj strategjie. Pjesëmarrës në këtë strategji ishin të gjitha palët me interes, duke filluar nga zyrtarët e MASHT-it e deri te përfaqësuesit e komunave, ekspertët dhe drejtorët e shkollave. Fillimisht u skanua gjendja aktuale e arsimit, duke u analizuar me anë të analizës SËOT, e cila vë në pah pikat e forta dhe të dobëta të institucioneve arsimore të të tria niveleve: MASHT, komunë, shkollë.¹¹

¹⁰ Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë (2007 – 2017).

¹¹ Strategjia e sigurimit të cilësisë për arsimin parauniversitar në Kosovë (2016 – 2020).

Si çdo strategji që hartohet me një qëllim të caktuar, edhe kjo strategji kishte qëllimin e saj që ishte prezantimi i një sistemi të plotë të sigurimit të cilësisë në nënsektorin e arsimit parauniversitar në Kosovë në mënyrë që të kontribuohet në përmirësimin e shërbimeve arsimore dhe rezultateve të arsimit.

Kjo strategji ka katër komponentë të ndryshëm, të përfaqësuar përmes objektivave strategjike dhe masave të ndërlidhura me to:

“Objektivi 1: Ndërtimi i mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë;

- Ngritja e sistemit efikas për vlerësim të shkollës;
- Aplikimi i ciklit të menaxhimit të cilësisë në arsim;
- Fuqizimi i organeve shkollore (aktivet dhe këshillat) për të kryer funksionin e tyre të SC-së;
- Definimi i rolit të DKA-së në SC dhe ngritja e strukturave përkatëse për SC në DKA;
- Funksionimi i inspektoratit në aspektin juridiko-administrativ dhe pedagogjik-profesional;
- Funksionalizimi i sistemit të licencimit të mësimeve;
- Shfrytëzimi efektiv i të dhënave për monitorimin e arsimit për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet;

Objektivi 2: Avancimi i planifikimit zhvillimor në nivel shkolle dhe komune;

- Rishikimi i procedurave dhe i instrumenteve për planifikim zhvillimor;
- Monitorimi i zbatimit të planeve zhvillimore të shkollave;
- Harmonizimi i planeve komunale me planet shkollore sipas fushave të cilësisë;
- Nxitja e shkëmbimit të praktikave më të mira;

Objektivi 3: Ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet;

- Ngritja e kapaciteteve të inspektimit për përgjegjësitë e reja;
- Hartimi i doracakut për aktivet e shkollës me fokus të qartë në zhvillimin e cilësisë;
- Trajnimi i stafit të DKA-së, drejtorëve dhe stafit përgjegjës të shkollave për menaxhimin e cilësisë;

- Ofrimi i ndihmës nga grupet profesionale në nivel komunal;
- Trajnimi i përfaqësuesve të shkollave dhe të komunave për planifikimin zhvillimor;
- Zbatimi i sistemit të monitorimit për mësimdhënësit e rinj në shkolla;

Objektivi 4: Ngritja e vetëdijes së palëve të interesuara për sigurimin e cilësisë;

- Publikimi i rezultateve të testeve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Promovimi i sukseseve dhe shpërblimi i arritjeve;
- Informimi i prindërve për aspekte të ndryshme të kurrikulës dhe sigurimit të cilësisë;
- Promovimi i debateve publike lidhur me cilësinë në arsim;
- Krijimi i portalit për sigurimin e cilësisë.”¹²

Në vitin 2009 Kosova miratoi Qasjen Mbarësektoriale në Arsim (QMS). Në atë kohë u vendos që të ketë një plan gjithëpërfshirës dhe të veçantë për tërë sektorin e arsimit, gjë që çoi në zhvillimin e *Planit strategjik të arsimit në Kosovë* (PSAK) 2011 – 2016. Raporti i vlerësimit i nëntorit të vitit 2015 tregoi se ky plan ishte zbatuar në mënyrë mjaft të mirë dhe të suksesshme në disa fusha të caktuara, kurse në disa të tjera nuk ishte arritur në mënyrë të kënaqshme ajo që ishte planifikuar dhe ishte pritur. Si procesi i zhvillimit të PSAK-së 2017 – 2021, ashtu edhe dokumenti që rezulton pas tij kishin mundësi të përfitonin nga përvojat e nxjerra gjatë zhvillimit, zbatimit dhe rishikimit të PSAK-së 2011 – 2016.

Në nivel kombëtar është konsideruar e domosdoshme që të harmonizohet PSAK-ja 2017 – 2021 me *Strategjinë kombëtare për zhvillim*, e cila është përgatitur nën udhëheqjen e zyrës së kryeministrit të Kosovës. Ndërlidhja kryesore e PSAK-së dhe SKZH-së është realizuar përmes kapitullit të parë *Zhvillimi i kapitalit njerëzor*, ku rritja e numrit të fëmijëve në edukimin parashkollor, avancimi i performancës së mësimdhënësve, rritja e kualifikimit të tyre, përmirësimi i raportit shkollim – kërkesa të tregut të punës dhe forcimi i mekanizmave të llogaridhënies përmes procesit të vlerësimit janë vetëm disa nga politikat që adresonte kapitulli në fjalë.¹³

¹² Strategjia e sigurimit të cilësisë për arsimin parauniversitar në Kosovë (2016 – 2020).

¹³ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, *Plani strategjik i arsimit të Kosovës* (2017 – 2021).

3. Zhvillimi dhe ngritja profesionale e mësimehënësve në Kosovë

“Zhvillimi profesional definoheh si aktivitet që zhvillon shkathtësitë individuale, njohuritë, zgjeron eksperiencat dhe karakteristikat e tjera si mësimehënës” (OECD).

Një shtet që synon të arrijë rezultate të larta në arsimimin e brezave, padyshim që duhet t’u kushtojë vëmendje të veçantë mësimehënësve. Për rëndësinë e mësimehënësve kanë shkruar në vazhdimësi edhe filozofë e njerëz të mençur.

“Mësimehënësi me cilësi të lartë është gjithmonë i gatshëm të mësojë, është kyç për krijimin e qytetarëve që mund të menaxhojnë jetën e tyre dhe të jenë të lidhur me të tjerët rreth tyre në një botë gjithnjë në ndryshim. Nuk ka zëvendësim për mësuesit e mirë. Ne nuk mund të kemi një shoqëri që mëson pa mësues që mësojnë profesione” (Fullan, 1933).

Zhvillimi profesional ndodh në vende të ndryshme dhe secili sipas specifikave të tyre. P.sh. në Austri zhvillimi profesional i mësimehënësve realizohet si një formë e trajnimit pasuniversitar, për çka në fund mësimehënësi pajiset me një diplomë. Secili mësimehënës në bazë të përzgjedhjes së tij realizon 15 orë program për zhvillim profesional.

Në anën tjetër, në Holandë ku sistemi arsimor është i decentralizuar, shkollat janë ato që i vlerësojnë nevojat e tyre dhe në bazë të nevojave ndajnë fonde për zhvillimin profesional të mësimehënësve.

Në vendin tonë, pra në Republikën e Kosovës, zhvillimi profesional i mësimehënësve nga paslufta, gjegjësisht nga viti 1999, ka kaluar nëpër zhvillime të shumta. Dekada e fundit është faza gjatë së cilës sistemi arsimor ka fituar një dimension të ri gjithmonë në përpjekje që të ndërtohet një sistem arsimor i qëndrueshëm e më theks të veçantë në aspektin e zhvillimit profesional të mësimehënësve në mënyrë që të përmirësohen sa më shumë kompetencat e mësimehënies. Kjo është bërë, pasi zhvillimi profesional i mësimehënësve konsiderohet si njëri ndër faktorët kyçë në ngritjen e cilësisë së mësimehënies dhe të nxëniet.

Ky segment në Kosovë është i rregulluar me ligj. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) është përgjegjëse për planifikimin e fondeve të nevojshme, akreditimin e programeve të trajnimit, hartimin e standardeve për sigurimin e cilësisë dhe krijimin e mekanizmave për zbatimin e zhvillimit profesional të mësimehënësve. Për trajnimin e mësimehënësve janë përgjegjëse drejtoritë komunale, të cilat lidhur me këtë gjë bazohen në nevojat dhe fushat e tyre për trajnim, duke vepruar në koordinim me MASHT-in

për të siguruar buxhetin për realizimin e atyre trajnimeve, si dhe në bashkëpunim edhe me ofertuesit që ofrojnë programe trajnimi.

Në Sistemin e Licencimit të Mësimdhënësve, zhvillimi profesional i mësimdhënësve është një komponent i veçantë që është vendosur si instrument i llogaridhënies, motivimit dhe si mekanizëm për zhvillim të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve. Ky sistem është sfiduar në vazhdimësi dhe shpeshherë nuk ka qenë funksional e i qëndrueshëm për shkak të moszbatimit të plotë të tij. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë zë vend në të gjitha planifikimet e MASHT-it, duke përfshirë këtu edhe dokumentet strategjike dhe planifikimet zhvillimore në nivel komune e shkolle.¹⁴

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve të ne është i mbështetur kryesisht në programet e trajnimit që ofrohen nga institucione dhe ofertues të ndryshëm, të përzgjedhur nga MASHT-i në bazë të kriterëve të përcaktuara. Programet e trajnimit të mësimdhënësve përbëjnë një përpjekje për të plotësuar nevojat praktike të mësimdhënësve për zhvillim profesional dhe për zbatim të reformës kurrikulare. Programet e trajnimit janë të publikuara në *Katalogun* e MASHT-it dhe të njëjtat janë të specifikuara se nga kush ofrohen, çfarë përmban trajnimi, sa kredi ka secili trajnim etj. Këto trajnime ofrohen varësisht nga nevojat e mësimdhënësve që i paraqesin shkollat në drejtoritë komunale. Institucionet përgjegjëse për procesin e kualifikimit të mësimdhënësve në sistemin e arsimit parauniversitar janë të përcaktuara me *Ligjin për arsimin parauniversitar në Kosovë* (2011) dhe me *Ligjin për arsimin e lartë në Kosovë* (2012). Sipas *Ligjit për arsimin e lartë* përcaktohet se vetëm institucionet publike të arsimit të lartë mund të ofrojnë programe studimi që shpien në kualifikimin e një mësimdhënësi për t'u punësuar në një shkollë.¹⁵ Në Kosovë programet për përgatitjen e mësimdhënësve ofrohen nga Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Gjilanit, Universiteti i Gjakovës, Universiteti i Prizrenit dhe Universiteti i Mitrovicës. Përveç këtyre, në Kosovë ekzistojnë edhe disa institucione private të arsimit të lartë që ofrojnë programe për përgatitjen e mësimdhënësve. Duhet cekur se si universitetet shtetërore edhe ato private janë të obliguara që t'i akreditojnë programet e tyre në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA).

“*Ligji për arsimin parauniversitar në Kosovë*, neni 33, pika 4, përcakton që të gjitha programet universitare që çojnë drejt kualifikimit për mësimdhënës duhet që më së voni deri

¹⁴ Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim, *Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë*, Prishtinë, prill 2019.

¹⁵ Ligji nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në Kosovë.

në fillim të vitit akademik 2012/2013 të jenë ekuivalent me programet e ciklit të dytë prej 300 ECTS që përmbajnë komponentin akademik, profesional dhe pjesën praktike, hollësitë e të cilave rregullohen përmes akteve nënligjore. Në bazë të kësaj dispozite të *Ligjit për arsimin parauniversitar në Kosovë*, në *Udhëzimin administrativ* që rregullon sistemin e licencimit dhe zhvillimin e mësimdhënësve në karrierë (2017), përkatësisht, nenin 4 të këtij akti nënligjor (Kualifikimi i mësimdhënësve para shërbimit/mësimdhënësve të rinj), është përcaktuar që kohëzgjatja e studimeve për përgatitjen e mësimdhënësve të jetë si në vijim:

- Kohëzgjatja e studimeve për përgatitjen e mësimdhënësve parashkollorë dhe fillorë, së paku 240 ECTS, prej tyre së paku 25 ECTS nga praktika profesionale;
- Kohëzgjatja e studimeve për përgatitjen e mësimdhënësve lëndorë, së paku 300 ECTS, 180 ECTS përgatitje akademike dhe 120 ECTS (MA), komponenti pedagogjik dhe praktik, prej tyre së paku 15 ECTS nga praktika profesionale; dhe
- Kohëzgjatja e studimeve për përgatitjen e mësimdhënësve të profilit të shkollave profesionale (AAP), së paku 300 ECTS, prej tyre 180 ECTS përgatitje profesionale dhe 120 ECTS (MA) përgatitje pedagogjike dhe praktike. Prej tyre së paku 15 ECTS praktikë profesionale.¹⁶

Në Kosovë në vitin 2010 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka filluar zbatimin e programit për Avancimin e Kualifikimit të Mësimdhënësve (AKM), program që ishte vazhdimësi e atij për rikualifikim të mësimdhënësve pa shkëputje nga puna (2006/2007), i cili ishte i mbështetur në *Strategjinë për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007 – 2017*. Ky program u krijua për mësimdhënësit që ishin në marrëdhënie pune dhe të cilëve u kërkohej ngritja profesionale krahas ushtrimit të profesionit. Ky program kryesisht atakoi mësimdhënësit që kishin kualifikim dyvjeçar në shkollat e larta pedagogjike (SHLP).

Ky program është mbështetur financiarisht nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë dhe është realizuar nga Fakulteti i Edukimit në Prishtinë, Gjakovë, Prizren dhe në Gjilan. Për këtë bashkëpunim këto dy institucione kanë nënshkruar marrëveshje në janar të vitit 2010.¹⁷

¹⁶ Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim, *Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë*, Prishtinë, prill 2019.

¹⁷ Sipas Katalogut të programeve të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (2017), në shtator të vitit 2010, Agjencia e Kosovës për Akreditim ka riakredituar katër programe të Fakultetit të Edukimit

Numri i atyre që kanë ndjekur këtë program avancimi nga viti 2010 është 6,828.¹⁸

Në vazhdimësi numri i atyre që kërkonin për të ndjekur programet që ofronte Fakulteti i Edukimit, programet Fillor dhe Parashkollor, u rrit duke kaluar normën e numrit të pjesëmarrësve në grup që ishte 30 sish, gjë që e rrezikoi cilësinë e programit.

Fakulteti i Edukimit në Prishtinë në shtator të vitit 2010 akreditoi katër programe nga Agjencia e Kosovës për Akreditim. Këto programe u akredituan për një periudhë trevjeçare, si programet Parashkollor dhe Fillor dhe dy programe master. Deri në vitin akademik 2012/2013 programet vazhduan të funksionojnë me numër të kufizuar të regjistrimeve në koordinim me MASHT-in.¹⁹

Programi për Avancimin e Kualifikimit të Mësimdhënësve është duke vazhduar me pedagogët që punojnë në nivelin e edukimit parashkollor dhe arsimit fillor, të cilët sipas *UA/Normativi mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm*, n.10/2018, programin duhet ta përfundojnë deri në fund të vitit shkollor 2020/2021. Po ashtu, sipas këtij udhëzimi, mësimdhënësit që janë në marrëdhënie pune në institucionet e arsimit parauniversitar me gradë kualifikimi baçelor trevjeçar (180 ECTS), që kanë më shumë se gjashtë vjet përvojë pune në arsim dhe që kanë licencë të mësimdhënësit, e vazhdojnë punën në profesionin e tyre deri në përfundim të vitit shkollor 2020/2021, me kusht që gjatë kësaj periudhe të plotësojnë kërkesat për kualifikim sipas normativave në fuqi për mësimdhënës.

Reformat e mëdha në kurrikulën e Kosovës padyshim që kanë sjellë edhe ndryshime në punën e mësimdhënësve, gjë që nuk ka kaluar pa u vërejtur dhe pa shkaktuar vështirësi.

Tani sikur roli i mësimdhënësit ka ndryshuar. Mësimdhënësi nuk është më ai që vetëm sjell informacione, por ai krijon mjedis të përshtatshëm të të nxënësit në mënyrë që të gjithë nxënësit të përfshihen në aktivitete pa dallim në mënyrë që të zotërojnë kompetencat dhe rezultatet e të nxënësit për nivelin përkatës.

për periudhën trevjeçare: programin Parashkollor dhe programin Fillor (në të tria qendrat), si dhe ka akredituar dy programe master. Ndërkaq, të gjitha programet e tjera që ofrojnë përgatitjen e mësimdhënësve për ciklin e mesëm të ulët (mësimdhënës lëndorë) janë akredituar për një periudhë njëvjeçare dhe vetëm në qendrën e Prishtinës. Deri në vitin akademik 2012/2013 programet vazhduan të funksionojnë me numër të kufizuar të regjistrimeve në koordinim me MASHT-in.

¹⁸ Linda Grapci-Kotori, Raport mbi gjendjen e të diplomuarve në programin Avancimi i Kualifikimit të Mësimdhënësve (raport i papublikuar), 29. 3. 2017.

¹⁹ <https://edukimi.uni-pr.edu/getattachment/Ballina/Katalogu.pdf.aspx>

Tanimë nga shkollat dhe mësimdhënësit pritet që të zhvillojnë programet lëndore që në vazhdimësi janë përshkruar nga autoritetet dhe proceset kombëtare. Kurse kurrikula e re u jep mundësi mësimdhënësve që të japin kontributin e tyre drejt arritjeve të rezultateve.

MASHT-i, pas pilotimit të kurrikulës së re (2013/2014, 2014/2015 dhe 2015/2016), ka hequr përgjegjësinë e mësimdhënësve për zhvillimin e programeve lëndore për klasë dhe tanimë këtë përgjegjësi e ka Divizioni për Zhvillimin e Kurrikulave në MASHT bashkë me grupet punuese që angazhojnë. Megjithatë, në bazë të autonomisë së tyre, ende mbetet që mësimdhënësit dhe shkollat të zhvillojnë kurrikulën me zgjedhje, të zhvillojnë programe jashtëkurrikulare dhe të ofrojnë më shumë orë mësimore mbi minimumin e përcaktuar nga autoritetet kombëtare. Të gjitha këto procese reflektojnë në punën e mësimdhënësve dhe në rolin e tyre.

Në vitin 2016 *Korniza kurrikulare e arsimit të Kosovës* është rishikuar nga MASHT-i. Pas rishikimit MASHT-i ka marrë vendim që nga viti shkollor 2017/2018 ky dokument zyrtar të gjejë zbatim në të gjitha shkollat e Kosovës, gjegjësisht në nivelin parafillor, në nivelin fillor: në klasën e parë (I), në klasën e gjashtë (VI) dhe në klasën e dhjetë (X) në gjimnaze. Trajnimet e mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës nga viti shkollor 2016/2017 janë organizuar nga Divizioni për ZHPM, në bashkëpunim me koordinatorët e 28 komunave që kanë qenë të angazhuar në procesin e organizimit të trajnimeve.²⁰

Përgatitja e mësimdhënësve për aplikimin e kurrikulës së re është përcjellë me një varg vështirësish. Zbatimi i kurrikulës bëhet i suksesshëm atëherë kur mësimdhënësit fitojnë përvojat e duhura, njohuritë, shkathtësitë, idetë dhe qëndrimet e drejta për kurrikulën apo programin mësimor që do ta zbatojnë në praktikë. Vetëm kur kurrikula pranohet plotësisht nga mësimdhënësit e një shkolle dhe kur veprimtaritë e lidhura me të kthehen në rutinë, mund të thuhet se kurrikulumi ka arritur fazën e “institucionalizimit”.²¹

Mësimdhënësit janë filtrat nëpërmjet të cilëve kalojnë kurrikulat e planifikuara. Ata luajnë rol vendimtar në planifikimin e kurrikulës shkollore, edhe pse vendimmarrja shpesh cenohet

²⁰ Divizioni për Zhvillim Profesional të Mësimdhënësve në MASHT (2017). Raport përmbledhës për trajnimin e mësimdhënësve për zbatimin e KKK-së, mars – korrik 2017.

²¹ Colin J. Marsh, *Koncepte themelore për ta kuptuar kurrikulumin*, (Botimi i katërt në shqip), Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2009.

nga përpjekja për të kontrolluar dhe për të standardizuar gjithçka në emër të ngritjes së efikasitetit.²²

Për zhvillimin profesional të mësimeve kanë rol institucionet përgjegjëse. Mekanizmat e brendshëm të MASHT-it që kanë përgjegjësi në zhvillimin profesional të mësimeve janë: Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimeve dhe Divizioni për Zhvillimin Profesional të Mësimeve. Pas tyre përgjegjësia bie edhe mbi drejtoritë komunale të arsimit, institucionet shkollore, Inspektoratin e Arsimit dhe mbi institucionet që ofrojnë programe për ZHPM. Por rol kyç për zhvillimin e mësimeve ka MASHT-i.

²² H. Hyseni, N. Mita, J. Salihaj, D. Pupovci, Qeverisja dhe udhëheqja në arsim – Si të bëheni udhëheqës i suksesshëm? (Udhëzues), f. 271, Qendra për Arsim e Kosovës, Prishtinë, 2003.

KAPITULLI II

Zhvillimi i sistemit arsimor dhe gjithëpërfshirja në Kosovë

1. Gjithëpërfshirja në sistemin e arsimit në Kosovë

Gjithëpërfshirja në sistemin arsimor është pjesë e konceptit dhe orientimit të shoqërisë dhe shtetit të Republikës së Kosovës. Kjo për faktin se shoqëria dhe shteti i Republikës së Kosovës është i orientuar drejt vlerave universale të të drejtave dhe lirive të njeriut, duke pretenduar të jetë vend demokratik dhe shtet i së drejtës. Kur i referohemi këtij koncepti, të njëjtin e bazojmë në këto fakte: Kosova në Kushtetutën e saj ka të inkorporuar mekanizmat ndërkombëtarë për mbrojtjen e lirive të njeriut. Si e tillë Kosova është vendi i vetëm në botë që në kuadër të kushtetutës përcakton mekanizmat përkatës për mbrojtje të të drejtave të njeriut, mbrojtje nga diskriminimi, për mundësi të barabarta për të gjithë, mbrojtje të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian.

Lidhur me kategorinë e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe kategorinë e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në arsim, edhe pse ndër vite është shënuar përmirësim, mbetet akoma sfidë e vendit dhe një nga standardet që vendi duhet ta plotësojë karshi kërkesave të BE-së.

Për këto dy kategori janë ngritur edhe departamente të veçanta brenda MASHT-it, të cilat janë të autorizuar dhe të ngarkuara që të hartojnë politika të përshtatshme, të krijojnë mekanizma mbikëqyrës dhe të vlerësojnë mbarëvajtjen e çdo procesi që ndërmerret lidhur me këto dy kategori.

2. Koncepti i gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim

Arsimi gjithëpërfshirës është përfshirja e të gjithë fëmijëve në shkolla të rregullta. Kështu secilit fëmijë i ofrohet mësim sipas nevojave specifike. Si i tillë ky proces ka filluar në vitet e 80-ta të shekullit XX dhe përparimi i tij po shkon me një shpejtësi bukur të madhe. Lirshëm mund të themi se arsimi gjithëpërfshirës po zëvendëson arsimin tradicional që përfaqësohet nga një sistem binar i ndarë në dy komponentë: në arsim të rregullt dhe në arsim special. Sistemi binar ka përjashtuar nga shkolla e zakonshme një numër të madh të fëmijëve me nevoja të veçanta. Për këto dy kategori është ofruar mësim i ndryshëm në objekte edhe fizikisht të ndara. Jo të gjithë fëmijët me aftësi të veçanta kanë vështirësi në të nxënë, andaj si pasojë e kësaj ata ndjekin mësimet në shkolla speciale, varësisht nga lloji i vështirësisë, problemit a dëmtimit që kanë.

Derisa në shekullin XX shkollat speciale kanë qenë shpresa e vetme e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe vendi i vetëm ku ata kanë qenë të përfshirë, me kalimin e viteve kjo ka filluar të ndryshojë dhe të marrë formën e një arsimi gjithëpërfshirës.

Në vendet perëndimore edukatorët dhe mësuesit i kanë kontribuar shumë ngritjes së sistemit të arsimit special. Kjo bëri që e gjithë ekspertiza për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta të përqendrohej në shkolla speciale. Mënyra e veçantë e edukimit në shkollat speciale bëri që këto shkolla të ishin të veçuara dhe të pavarura. Që prej vitit 1920 sistemi i veçuar i arsimit special ka ardhur duke u zgjeruar dhe duke u fuqizuar deri në fund të viteve të 70-ta të shekullit XX (Meijer, Pijl dhe Hegarty, 1970).

Australia filloi të integrojë studentë me aftësi të veçanta në klasat kryesore në vitet e 70-ta të shekullit XX pas gati një shekull edukimi të studentëve me aftësi të veçanta në ambiente të ndara.

Një nga faktorët që mund të cilësohet si mjaft i rëndësishëm se pse ata po ndryshonin qëndrimet e tyre ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta ishte parimi i ashtuquajtur i “normalizimit”, e drejta që njerëzit me aftësi të veçanta të mësojnë në ambiente mjedisore sa

më normale apo të zakonshme pa pasur nevojë për ambiente speciale që i dallojnë nga të tjerët (Bank-Mikkelsen, 1969; Nirje, 1970). Wolfensberger (1970) gjithashtu shkroi gjerësisht për këtë çështje, duke krijuar termin "valorizimi i rolit shoqëror" për të nënvizuar të drejtën e të gjithë individëve për t'u vlerësuar në mënyrë të barabartë dhe të kenë mundësinë për të kontribuar në mënyrë domethënëse për komunitetin joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian.

Nga mesi i viteve të 70-ta e tutje Australia ka hartuar politika për integrimin e studentëve me aftësi të veçanta që gjatë ditës disa orë të kenë mundësi t'i kalojnë në klasat e rregullta me bashkëmoshatarët e tyre, kurse objektet e specializuara të mbeten vetëm për nxënësit vështirësitë e të cilëve janë mjaft të mëdha dhe e kanë të pamundur përfshirjen në klasa të zakonshme. Studentët që integroheshin në këto klasa punonin me kurrikula të rishikuara dhe të përshtatura për ta, varësisht nga nevojat e tyre, mirëpo jo gjithmonë u angazhuan për ta mësues asistentë.

Studentët me specifika për të cilët nevojiteshin ambientet e përshtatura fizike, tualete të modifikuara, materiale të shtypura me alfabet Braj etj., ishte e pamundur që të përfshiheshin gjithmonë në këto ambiente. Si pasojë e kësaj ata shpesh e kishin të pamundur të ndiqnin mësimet në shkollën e lagjes dhe obligoheshin të shkonin në shkolla më të largëta, ku këto mjete dhe karakteristika fizike ishin të centralizuara.

Gjatë dy dekadave të fundit nocioni i "përfshirjes" ka shtyrë më tej debatin në lidhje me arsimimin e studentëve me aftësi të veçanta (Forlin, 1997). Përfshirja synon të heqë plotësisht dallimin midis arsimit special dhe të rregullt dhe të sigurojë një arsim të përshtatshëm në shkollën lokale për të gjithë studentët, pavarësisht nga niveli i aftësisë së veçantë. Ai përfshin një ristrukturim të plotë të sistemi arsimor në mënyrë që të gjitha shkollat të kenë përgjegjësinë për të siguruar lehtësira, burime dhe një kurrikulë të përshtatshme për të gjithë studentët, pavarësisht nga aftësia e tyre e veçantë. Kjo tendencë ndodhet brenda një agjende të gjerë të drejtësisë sociale, e cila argumenton se barazia për të gjithë duhet të përfshijë qasje për të gjithë nxënësit në shkollën e tyre lokale.²³

Arsimi gjithëpërfshirës është një nga format më të mira të arsimimit për të gjithë pa dallim. Edhe pse te ne është i ri si nocion, ai po përhapet në shoqëri me një shpejtësi relativisht të madhe, gjë që mund të cilësohet si mjaft pozitive.

²³ University of Wollongong Research Online, Inclusion of students with disabilities in new times: responding to the challenge, 2008 (shfletuar në dhjetor 2019).

Është e drejta e çdo fëmije të arsimohet në shkollë dhe të trajtohet me dinjitet. Mësimdhënia duhet t'u përshtatet specifikave, nevojave dhe mundësive të çdo nxënësi. Shkollë është e njëjtë për të gjithë fëmijët dhe për vijimin e saj të gjithë kanë shanse të barabarta, pavarësisht nga aftësitë që ka gjithsecili.

E drejta për arsimim është e drejtë e secilit dhe mosrespektimi i saj sanksionohet me akte ndërkombëtare dhe kombëtare. Konventa e Kombeve të Bashkuara që është "Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara thekson detyrimin e shteteve palë për të njohur të drejtën e personave me aftësi të veçanta për edukim dhe për ta realizuar këtë të drejtë pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta. Shtetet që janë apo që synojnë të jenë pjesë e Bashkimit Evropian detyrohen të sigurojnë një sistem edukimi gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet, të orientuar:

- a) drejt zhvillimit të plotë të potencialit njerëzor, dinjitetit dhe vetëvlerësimit; fuqizimit të respektit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe diversitetit njerëzor;
- b) drejt zhvillimit të personalitetit, talenteve dhe krijimtariisë së personave me aftësi të veçanta, si dhe aftësive të tyre mendore e fizike, deri në potencialin e tyre të plotë;
- c) drejt pjesëmarrjes efektive të personave me aftësi të veçanta në një shoqëri të lirë (Eorl Vision, 2012).

Është e nevojshme të hedhim një sy mbrapa dhe të shohim në historikun e arsimit special dhe në këtë mënyrë të sqarojmë paradigmen e aftësisë së veçantë. Arsimi special, i ndarë apo i vecuar, sikurse edhe shërbimet e tjera për këtë kategori njerëzish, lindi si shprehje e përkujdesjes që shoqëria shfaqti për ta. Ajo i mënjanoi prej të tjerëve, të paktën përkohësisht, duke u përpjekur që t'i rehabilitonte dhe t'i arsimonte në mënyrë që pastaj t'i risillte të arsimuar dhe të rehabilituar në mesin e shoqërisë. Edhe pse qëllimi final i përkujdesjes shoqërore mund të cilësohet si i mirë dhe jo qëllimkeq, pasi synonte t'i risillte ata të përgatitur në gjirin e shoqërisë, përvoja e gjatë e shekullit të kaluar tregoi të kundërtën. Trajtimi dhe përkujdesja jashtë ambientit shoqëror jo vetëm që nuk ndikoi që njerëzit me nevojë të veçanta t'i "rikthente" në mesin e shoqërisë, përkundrazi ajo ndikoi që t'i largonte përgjithmonë në vende të veçuara dhe larg syrit të shoqërisë dhe t'i mbante në institucionet e përkujdesjes sociale dhe edukimit special.

Duke u bazuar në konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, çdo nxënës ka të drejtë të shkollohet në një sistem të caktuar arsimor. Në zbatim të këtij parimi, çdo sistem arsimor është i detyruar të përfshijë të gjithë nxënësit në ndjekjen e arsimit të detyruar.

3. Gjithëpërfshirja në arsim si kategori e të drejtave të njeriut

Disa të drejta që i takojnë njeriut dhe që gjatë jetës i gëzon nuk janë dhurata që ia dhuron njeriu njeriut apo shteti njeriut, po janë të drejta që njeriut i takojnë që nga lindja. Të drejtat e njeriut janë të drejta që i takojnë njeriut qysh kur lind dhe gëzimi i tyre është i garantuar pavarësisht nga vullneti i njeriut apo i shtetit. Në kuadër të këtyre të drejtave që njeriut i takojnë që nga lindja janë e drejta për jetë, liri personale, privatësi, mbrojtje dhe për arsim.

E drejta për arsim është një e drejtë që çdo njeriu i takon dhe ajo është nga të drejtat më fundamentale dhe me të rëndësishme. Edhe pse është një e drejtë që fitohet që nga lindja, për të qenë e mbrojtur dhe e sigurt, kjo e drejtë është përcaktuar në mekanizma ndërkombëtarë që i referohen mbrojtjes së të drejtave të njeriut, më pas në kushtetutë dhe në ligje përkatëse. E drejta për arsim është një e drejtë e çdo njeriu pa asnjë dallim, prandaj gjithëpërfshirja është një e drejtë që i mundëson çdo njeriu të jetë pjesë e sistemit të arsimit.

Si të drejtë fundamentale të njeriut e konsideron të drejtën për arsim edhe Republika e Kosovës. Si e drejtë e çdo qytetari pa asnjë dallim është përcaktuar që në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, më pas në politikat dhe legjislacionin përkatës në fuqi që i referohet së drejtës në arsim. E drejta për arsim është një e drejtë e njeriut që mundëson gjithëpërfshirje në sistemin arsimor pa asnjë dallim.

Republika e Kosovës është shtet i të gjithë qytetarëve të saj, pa asnjë dallim. “Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj.”²⁴ Barazia e qytetarëve në Republikën e Kosovës është kategori kushtetuese. Pavarësisht nga dallimet që qytetarët mund të kenë, nga shteti do të kenë trajtim dhe qasje të njëjtë, duke respektuar edhe të drejtat e caktuara që i përkasin komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. Me këtë kuptojmë se qasja e shtetit të Republikës së Kosovës është respektimi i të drejtave të njeriut dhe qytetarëve të saj pa asnjë dallim. Kjo siguron trajtim të

²⁴ Neni 47, paragrafi 2, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.

barabartë, mbrojtje nga diskriminimi dhe respektim të të drejtave të njeriut si vlerat më të larta të botës demokratike.

Gjithëpërfshirja në sistemin arsimor është një e drejtë e përcaktuar, pasi “secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.”²⁵ Duke pasur për bazë këtë që ka përcaktuar Kushtetuta, kjo mund të kualifikohet si një siguri juridike që shteti e ka përcaktuar për çdo person lidhur me të drejtën për shkollim, si një e drejtë fundamentale për zhvillim të çdo njeriu dhe për të qenë i dobishëm për vetveten, për familjen dhe për shoqërinë. Përpos së drejtës për arsim, Kushtetuta siguron edhe mundësi të barabartë për t’u arsimuar. Kështu krijohet barazia e qytetarëve për arsim. Nga kjo që shohim, kuptojmë se Republika e Kosovës të drejtën për arsim e ka të përcaktuar dhe gjithëpërfshirjen si vlerën që i atribuohet orientimit progresiv dhe zhvillimor të Republikës së Kosovës.

Kompetente dhe përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën e arsimit është Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, e cila ka kompetencë që “të promovojë një sistem arsimor jodiskriminues në të cilin respektohet e drejta e secilit person për arsim dhe mundësitë e shkollimit cilësor të vihen në dispozicion të të gjithëve.”²⁶ Në kuadër të këtyre kompetencave është edhe hartimi i politikave dhe i legjislacionit për fushën arsimi, si dhe obligimi për qasje gjithëpërfshirëse.

Për asnjë moment e drejta për arsim nuk bën që të mohohet, pasi Ministria e Arsimit ka për detyrë që “të promovojë sistem jodiskriminues të arsimit në të cilin respektohen të drejtat e secilit person për arsim dhe aftësim, si dhe ofrohen mundësi të barabarta për arsim cilësor, të promovojë mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në kuadër të sistemit të arsimit dhe aftësimi, të sigurojë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësit dhe të punësuarve në institucionin arsimor dhe aftësues, si dhe të avancojë masat për parandalimin e braktisjes.” Nga ajo që është përcaktuar në legjislacion përkatës për sistemin arsimor parauniversitar, kuptojmë se qasja dhe orientimi i shtetit të Republikës së Kosovës janë drejt sigurimit dhe promovimit të gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor.

Në Republikën e Kosovës është rregulluar dhe janë përcaktuar kushtet edhe sa i përket arsimit të lartë. Edhe tek arsimi i lartë është përcaktuar dhe është rregulluar e drejta për arsim të lartë si një e drejtë që i takon çdo qytetari të Republikës së Kosovës. Në Republikën

²⁵ Neni 47, paragrafët 1 dhe 2, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.

²⁶ Neni 3, paragrafi b, Ligji nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës.

e Kosovës sigurohen "mundësi të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin në institucionet e arsimit të lartë pa diskriminim."²⁷ Përpos sigurisë për arsim në nivelin parafillor, kjo siguri është edhe për arsimin e lartë në kuadër të të cilit janë edhe gjithëpërfshirja dhe jodiskriminimi si vlera të mbrojtura.

Përpos legjislacionit që trajton dhe rregullon të drejtën në arsim dhe gjithëpërfshirjen si koncept të zhvillimit të arsimit në Republikën e Kosovës, Ministria e Arsimit e ka te trajtuar dhe e ka përcaktuar gjithëpërfshirjen edhe në dokumentet e saja strategjike. "Arsimi gjithëpërfshirës ofron mjedis mësimor që mundëson qasje, akomodim dhe mbështetje për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë që shkollat duhen përshtatur për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga gjendja e tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore ose faktorë të tjerë. Gjithëpërfshirja ka për synim minimizimin e pabarazive në shoqëri, luftimin e diskriminimit, shmangien e marginalizimit dhe të përjashtimit, si dhe sigurimin e mirëqenies për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë. Prandaj është e domosdoshme të zbatohen politika dhe praktika arsimore që synojnë procese gjithëpërfshirëse, në veçanti në raport me grupet shoqërore të marginalizuara, siç janë personat me nevoja të veçanta arsimore, komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, të varfrit, si dhe disa kategori të tjera shoqërore."²⁸

Koncepti i gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor është i rregulluar edhe në *Planin strategjik të arsimit në Kosovë*, si dokument që përcakton qartë formën dhe mënyrën e aktiviteteve konkrete për të zbatuar gjithëpërfshirjen në arsim si një të drejtë për çdo qytetar të Republikës së Kosovës. Sa i përket gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor, ndër të tjera, si sfida mbeten: shkalla e ulët e përfshirjes në edukimin parashkollor, përfshirja dhe pjesëmarrja e ulët në arsim e fëmijëve nga grupet e marginalizuara, fenomeni i braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në arsim. Këto janë disa nga sfidat që e përcjellin gjithëpërfshirjen në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës.

²⁷ Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, Ligji nr. 04/l-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

²⁸ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, *Plani strategjik i arsimit në Kosovë (2017 – 2021)*, fq. 42.

4. Niveli i gjithëpërfshirjes së fëmijëve me NVA në kuadër të sistemit arsimor në Kosovë

Në Ministrinë e Arsimit ekzistojnë mekanizma me anë të të cilëve çdo vit sigurohen të dhëna mbi numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta të përfshirë në shkollim. Një numër i këtyre fëmijëve, varësisht nga llojet dhe shkalla e vështirësisë, është i përfshirë në qendra burimore apo shkolla speciale dhe një numër tjetër në shkolla të rregullta. Synimi i MASHT-it është që këta fëmijë të përfshihen sa më shumë në klasa të rregullta.

Klasë/grupmosha	Gjithsej		
	M	F	GJ
Gr. 1-2	0	0	0
Gr. 2-3	4	5	9
Gr. 3-4	61	12	73
Gr. 4-5	72	34	106
Gr. 5-6 (Parafillor)	141	52	193
Gr. 5-6 (Parash./çerdhe)	60	36	96
Gjithsej	338	139	477

Fig. 1. Përfshirja e FNV-ve në institucionet parafillore dhe parashkollore.²⁹

Nëse i bëhet një analizë e thjeshtë kësaj tabele, atëherë shihet se te grupmoshat 1-2 dhe 2-3 ka numër dukshëm më të vogël krahasuar me grupmoshat më të rritura. Nga kjo mund të konkludojmë se shumë shpesh familjet që kanë fëmijë me vështirësi të caktuara ndoshta në fillim hezitojnë të deklarohen ose nuk i dërgojnë fare në çerdhe. Me kalimin e kohës, kur bëhet e domosdoshme që këta fëmijë të kalojnë në institucione, sepse nga qëndrimi në shtëpi ata vetëm mund të humbin dhe asnjëherë të fitojnë, atëherë edhe prindërit detyrohen t'i paraqesin këta fëmijë.

²⁹ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, *Statistikat e arsimit në Kosovë* (2016 – 2017).

Nxënësit sipas klasave dhe llojit të dëmtimit të përfshirë në qendrat burimore

Mosha / Klasa	Dëmtim intelektual	Dëmtim në të dëgjuar	Dëmtim në të parë	Dëmtime fizike	Dëmtime të shumëfishta	Vështirësi në të folur, komunikim dhe të gjuhës	Autizëm	Çrregullime emocionale dhe të sjelljes	Vështirës / Çrregullime në të nxënë	Sindroma Daun	Gjithsej
3 - 4 vjeç	-	-	-	-	1	3	1	3	1	1	10
5 - 6 vjeç	-	-	-	-	1	2	3	2	1	-	9
Klasa 1	1	4	3	1	-	7	-	-	-	-	15
Klasa 2	-	2	1	-	7	-	2	-	-	-	12
Klasa 3	-	3	-	1	6	-	1	-	-	-	11
Klasa 4	1	1	-	-	17	-	-	-	-	2	21
Klasa 5	-	4	2	1	5	-	-	-	-	1	13
Klasa 6	6	1	3	-	6	-	3	-	-	1	20
Klasa 7	13	2	1	1	8	-	-	-	-	-	25

Klasa 8	7	5	2	-	14	-	3	-	-	3	34
Klasa 9	7	8	3	-	10	1	2	-	-	2	33
Klasa 10	10	5	3	-	4	-	2	-	-	3	27
Klasa 11	1	4	3	-	6	-	-	-	-	-	14
Klasa 12	9	5	5	-	8	-	-	-	-	-	27
Gjithsej	58	43	24	3	100	6	17	5	2	13	271

Fig. 2. Përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në qendra burimore.³⁰

Në të dhënat e paraqitura në tabelë shohim se gjithsej janë 271 nxënës të përfshirë në qendra burimore, që është një numër jo edhe shumë i madh, nëse e krahasojmë me numrin e fëmijëve që tashmë janë përfshirë në klasa dhe shkolla të rregullta.

Nxënësit me nevoja të veçanta në klasa të rregullta

Gr. / Klasa	D. intelektuale	D. në të dëgjuar	D. në të parë	D. fizike	D. të shumëfishita	Veshë, të folur, komunikim	Autizëm	Çrregullime emocionale	Vështrrsi në të nxënë	Deprivime socio-kulturale dhe gjuhësore	Sindroma Daun	Gjithsej
1-2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

³⁰ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, *Statistikat e arsimit në Kosovë* (2016 – 2017).

2-3	0	1	1	1	0	5	1	0	0	0	0	9
3-4	2	0	0	0	30	19	12	4	1	0	5	73
4-5	15	2	1	1	18	23	27	5	2	0	12	106
5-6 parshk- Çerdhe	15	0	0	15	4	6	29	2	10	0	15	96
5-6 parafillor	42	12	31	6	12	36	5	39	3	0	7	193
Klasa 1	37	24	95	17	39	83	5	13	21	0	18	352
Klasa 2	71	13	176	26	25	79	7	15	35	0	10	457
Klasa 3	61	10	179	18	47	63	6	7	56	2	13	462
Klasa 4	78	6	246	15	43	78	6	37	60	6	11	586
Klasa 5	40	22	193	49	56	62	4	24	38	0	3	491
Klasa 6	98	12	178	37	38	66	12	10	26	1	16	494
Klasa 7	58	27	200	28	40	36	5	12	28	0	7	441

Klasa 8	101	13	194	38	40	31	5	7	17	2	13	461
Klasa 9	98	15	199	29	38	79	5	16	20	0	21	520
Klasa 10	20	11	83	18	5	15	2	19	0	0	3	176
Klasa 11	11	6	13	91	11	14	12	0	0	1	0	148
Klasa 12	9	11	125	63	10	7	0	1	0	0	0	226
Klasa 13	0	0	3	0	0	0	0	0	0	0	0	3
Gjithsej	751	192	1995	372	495	700	131	211	318	11	1547	5294

Fig. 3. Nxënësit me nevoja të veçanta në klasa të rregullta.³¹

Në dokumentin e paraqitur nga MASHT-i për kategorinë e lartcekur thuhet që këto informata duhet të merren me rezervë për shkak se akoma ekipet e vlerësimit (ekipe të formuara së fundmi që përbrenda vetes kanë ekspertë të kësaj fushe për identifikimin e vështirësive të nxënësve), të krijuara nëpër komuna, nuk kanë arritur të bëjnë vlerësimin e të gjithë fëmijëve nëpër shkolla ku dyshohet se mund të ketë fëmijë me nevoja të veçanta, por për të cilët nuk kemi dëshmi nga profesionistët.

Nëse i bëhet një analizë gjithë asaj që u cek më lart, sa i përket gjithëpërfshirjes në arsim të fëmijëve me nevoja të veçanta, mund t'i identifikojmë tri grupe problemesh të kësaj fushe:

1. Motivimi
2. Vështirësitë organizative

³¹ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, *Statistikat e arsimit në Kosovë* (2016 – 2017).

3. Kushte të papërshtatshme

5. Motivimi

Në Kosovë arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta është duke u realizuar në kuadër të kornizës së sistemit të arsimit gjithëpërfshirës. Kjo është një filozofi e re që kërkon përpjekje të konsiderueshme për të mbështetur individët për pjesëmarrje të plotë, ndryshe nga sigurimi i shërbimeve të ndara për personat me dëmtime. Fëmijët me nevoja të veçanta janë fëmijë si të gjithë fëmijët e tjerë dhe prandaj, me mbështetjen që u nevojitet, duhet të edukohen bashkë me fëmijët e tjerë në të njëjtat shkolla dhe klasa. Lind pyetja: Sa në të vërtetë është duke ndodhur kjo gjë? Mund të themi që jo në mënyrë të kënaqshme. Nëse bazohemi në të dhënat e viteve të fundit, numri i nxënësve me nevoja të veçanta të përfshirë në arsim ka shënuar rritje për 30%. Nga 909 nxënës sa ishin në vitin shkollor 2008-2009, ky numër është rritur në 1179 nxënës, mirëpo një numër i madh i tyre prapë ka mbetur jashtë institucioneve arsimore. Në Kosovë mungon edhe kuadri për të punuar me këta fëmijë. Sipas *Planit kombëtar të veprimit për persona më aftësi të veçanta të Republikës së Kosovës* (2009 – 2011), në komunën e Prishtinës janë të punësuar 13 mësimdhënës që punojnë me FNV, 13 asistentë dhe 2 nga personeli administrativ.

Arsimi gjithëpërfshirës është pjesë e projektit të madh të përfshirjes shoqërore, prandaj, ndër të tjera, varet shumë edhe prej vetë shoqërisë, po sidomos prej trysnisë që ushtrojnë prindërit për përfshirjen e fëmijëve të tyre në shoqëri. Një tryzni e tillë nuk vërehet në rastin konkret. Këtu vërehet një gatishmëri e ulët e prindërve për t'u marrë me rrethin shoqëror, me paragjykimet e tyre e shpeshherë me etiketimin e fëmijëve të tyre. Pos kësaj, prindërit e këtyre fëmijëve nuk shprehin gatishmëri që të përballen me institucionet përgjegjëse për këto çështje, duke përfshirë këtu edhe shkollën. Kjo indiferencë e tyre mund të jetë edhe si pasojë e kushteve të vështira ekonomike, të cilat e vështirësojnë informimin e prindërve për rrjedhën e gjërave jashtë ambientit të shtëpisë.

Si problem tjetër mund të cilësohet edhe mosgatishmëria e mësimdhënësve për t'i futur këta fëmijë në gjirin e nxënësve të tjerë. Mësimdhënësit nuk janë të stimuluar për t'u marrë me këto raste, andaj sikur nuk shprehin interesim për një gjë të tillë. Shumë prej tyre e konsiderojnë të pamundur reformimin e tyre dhe nuk janë të gatshëm të pajisen me njohuri të vazhdueshme apo të jenë fleksibilë për t'iu përshtatur kërkesave të kohës.

Një arsimim gjithëpërfshirës nuk lejon të kemi probleme të këtyre natyrave. Procesi i gjithëpërfshirjes edhe ashtu po ecën me hapa shumë të ngadalshëm, andaj çdo pengesë a çdo ngecje në këtë drejtim sjell vetëm ngadalësim të këtij procesi, kurse ata që pësojnë më së shumti në këtë rast janë fëmijët me nevoja të veçanta.

6. Vështirësitë organizative dhe planifikuese

Çështja e përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në klasat e rregullta është parë si obligim nga institucionet përgjegjëse në Kosovë. Shqyrtim më i posaçëm i nevojave të këtyre fëmijëve u bëhet sidomos pas vendosjes në Kosovë të administratës ndërkombëtare (1999), sepse gjithëpërfshirja është njëkohësisht edhe një nga standardet që duhet të plotësohen për t'u integruar në BE. Por, megjithatë, rezultatet nuk kanë qenë të mira deri më tani.

Ky obligim i institucioneve tona dhe, në përgjithësi, i shoqërisë ndaj këtyre fëmijëve mund të themi se është edhe obligim ndërkombëtar. Kësaj shtrese shoqërore të drejtën për t'u arsimuar ua garanton edhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, e cila, ndër të tjera, e thekson edhe obligimin që marrin shtetet kur pranojnë këtë Konventë, (të cilën edhe Kosova e ka pranuar). Edhe *Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm* (2002/2) në Kosovë i garanton shkollim kësaj kategorie fëmijësh. Neni 3 që ka të bëjë me të drejtën për arsimim e obligon MASHT-in që t'ua sigurojë të gjithë fëmijëve të drejtën për arsim. Mbi bazën e këtij ligji janë nxjerrë edhe disa udhëzime administrative që mbështesin inkuadrimin e të gjithë fëmijëve në shkollë, pavarësisht nga niveli i zhvillimit fizik, emocional dhe psikik të tyre. P.sh. *Udhëzimi administrativ* 6/2008, i datës 3.3.2008, përkatësisht neni 5 i tij, parasheh inkuadrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet parashkollore dhe ka të bëjë me përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet parashkollore.

Edhe në *Strategjinë për zhvillim parauniversitar* (2007 – 2017) njëri nga shtatë objektivat strategjikë (objektivi i katërt) ka të bëjë kryesisht me masat që duhet të merren për gjithëpërfshirje në arsimin kosovar (masa 4.3.4. Sigurimi i kushteve të përshtatshme për përfshirje të fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin e arsimit). Por rezultatet e hulumtimeve dhe shifrat zyrtare nuk janë pozitive. Afërsisht 10% e FNV-ve janë të përfshirë në shkollim. Në Prishtinë në qendrën burimore “Përparimi” ka 126 nxënës, kurse 25 janë të shpërndarë në tri shkolla të Prishtinës. Sipas një raporti të MASHT-it të vitit 2006, në Kosovë në shkolla fillore dhe të mesme i ndjekin mësimet 1030 FNV. Në kuadër të

shkollave të rregullta, brenda klasave të bashkuara, që gjithsej janë 71 klasë, i ndjekin mësimet 519 nxënës në krejt Kosovën. Nga një hulumtim i HENDIKOS-it dhe MASHT-it (2006) rezulton se 27.68% e nxënësve nuk i ndjekin mësimet për shkak të mungesës së transportit.

Edhe pse nuk mungon infrastruktura ligjore, realizimi i këtij synimi në praktikë ende nuk ka shënuar ndonjë sukses. Kjo ka ardhur si pasojë e mosgatishmërisë për të krijuar klasa inkluzive, pastaj niveli i ulët i bashkëpunimit mësues – prind etj. Për të punuar me këta fëmijë mësimdhënësi duhet të ketë njohuri edhe lidhur me përpilimin e PIA-s dhe gjithashtu të ketë të dhëna të sakta edhe për sa i përket diagnostifikimit të tyre. Çdo hezitim i mësimdhënësve për t'u marrë me këta fëmijë buron edhe nga fakti se një pjesë e mësimdhënësve nuk kanë njohuri lidhur me zbatimin e teknikave të reja në mësimdhënie. Shumica e mësimdhënësve në Kosovë nuk kanë pasur rast të ndjekin ndonjë trajnim që do t'ua lehtësonte punën me këta fëmijë, gjë që ka ardhur edhe si pasojë e moskoordinimit të mirë të punës nga autoritetet përgjegjëse në arsim.

7. Kushte të papërshtatshme

Kushtet aktuale për gjithëpërfshirje në arsim janë të pamjaftueshme, edhe pse MASHT-i është duke bërë përpjekje të vazhdueshme që në shkollat tona të ketë sa më shumë gjithëpërfshirje. Por nuk mund të thuhet se në shkollat tona ka mësimdhënës të përgatitur profesionalisht që të merren me këtë kategori të fëmijëve. Kjo bën që fëmijët me nevoja të veçanta të mos kenë një trajtim adekuat profesional në shkollë. Po ashtu për t'u marrë me këtë kategori të fëmijëve kërkohet që mësimdhënësit të kenë përgatitje të veçantë, ndërsa ata mësimdhënës që kanë njohuri për trajtimin adekuat të tyre janë të angazhuar në shkolla speciale. Sipas disa statistikave, vetëm 10% e fëmijëve me nevoja të veçanta janë brenë procesit mësimor.

Trajtimi i këtyre fëmijëve kryesisht realizohet nga ana e MASHT-it, ndërkaq bashkëpunimi me institucione të tjera këshilluese zbatohet në baza individuale nga ana e mësimdhënësve, çka do të thotë se shkollat në Kosovë nuk kanë ndonjë program adekuat dhe përvojë të mjaftueshme të organizimit të mësimi për fëmijët e tillë, megjithëse ato vazhdimisht janë duke u përpjekur që këta fëmijë të kenë kushte më adekuate në hapësirat shkollore. Në komunën e Prishtinës është një qendër burimore “Përparimi”, që ka 126 nxënës (me

dëmtime intelektuale) dhe janë tri klasë të bashkuara në tri shkolla: "Elena Gjika", "Ismail Qemali" dhe "Zenel Hajdini". Kjo qendër burimore në shtator pritet të bartet në një objekt të ri dhe modern.

Një fakt tjetër është edhe infrastruktura e papërshtatshme për mbajtje të mësimi. Mungojnë hapësira adekuate në shkollë, po ashtu edhe numri i madh i nxënësve në klasa është mjaft problem. Sipas disa të dhënave jo mirë të konfirmuara, në komunën e Prishtinës janë rreth 60% e shkollave me pjerrina. Përveç kësaj, në komunat tona mungojnë edhe qendra këshillimore psikologjike. Gjithashtu ka edhe probleme të tjera, siç janë: mungesa e mjeteve teknologjike për trajnimin e mësimeve, ndërrimi i metodologjive të mësimi, përshtatja e kurrikulës shkollore, mungesa e mjeteve konkretizuese, si dhe kushtet e vështira ekonomike të familjeve të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Fëmijët me nevoja të veçanta janë barrë e shoqërisë për sigurimin e kushteve të shkollimit dhe të jetës, ndërsa për vetë fëmijët nuk shihet ndonjë perspektivë në shoqërinë tonë. Nga ana tjetër, kapaciteti i kufizuar i hapësirave që u afrohet këtyre fëmijëve ka bërë që një numër i konsiderueshëm i tyre të mos u drejtohen dyerve të shkollave dhe enteve të tjera speciale. Si pasojë e gjithë kësaj, është rritur numri i këtyre fëmijëve që nuk dinë as shkrim e as lexim.

Të gjitha këto rrethana që u përmenden mund të shkaktojnë vështirësi në krijimin e kushteve më të mira për gjithëpërfshirje në shkollat në Kosovë.

Element tjetër i rëndësishëm është edhe përfshirja e kësaj kategorie në jetën aktive shoqërore edhe pas përfundimit të shkollimit, gjë që është element motivues ose demotivues për këtë kategori për t'u shkolluar.

Komuna e Prishtinës në vitin 2016 ka themeluar Komitetin Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta apo aftësi të veçanta. Ky komision është i përbërë nga 5 anëtarë që janë njohës të mirë të kësaj problematike.

Qëllimet e këtij komiteti janë të shumta, si nxitja, mbrojtja dhe siguri i mundësisë që të gjithë personat e kësaj kategorie në nivel të komunës së Prishtinës të kenë mundësi të gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre bazuar në specifikat e këtyre personave. Ky komitet bashkëpunon me shumë OJQ vendore e ndërkombëtare në të mirë të përmirësimit të gjendjes së fëmijëve me nevoja të veçanta.

Megjithëse personat me nevoja të veçanta janë pjesë e pandashme e shoqërisë, ata ende janë grup i marginalizuar, pasi krahas vështirësive të tyre shëndetësore psiko-fizike, kanë edhe barriera të tjera të shumta që iu paraqiten në jetën e tyre të përditshme. Si pasojë e paragjytimeve dhe stereotipave, ata ballafaqohen edhe me vështirësi në edukim e në punësim, gjë që u bëhet edhe më e vështirë të integrohen në jetën publike.

Komiteti, brenda përgjegjësive të veta, në këtë periudhë të funksionimit, është angazhuar që t'i sublimojë nevojat, kërkesat dhe interesat e personave me aftësi të veçanta në komunën e Prishtinës me qëllim të avancimit të tyre.

Është vërejtur se në aspektin e legjislacionit ky komunitet ka një përfshirje të mirë, por në zbatim të tij ka ngecje të theksuara. Mbështetur në legjislacion dhe nisur nga parimi bazë i barazisë sociale dhe të një diskriminimi pozitiv, komiteti fuqimisht i inkurajon dhe bashkëpunon ngushtë me institucionet që punojnë dhe funksionojnë në komunën e Prishtinës, që të njohin dhe të zbatojnë të drejtat e personave me aftësi të veçanta, njësoj si pjesa tjetër e popullsisë. Këtë së bashku mund ta bëjmë dhe duhet ta bëjmë. Ata janë pjesë e shoqërisë dhe ne kemi obligim t'i përkrahim dhe t'i inkurajojmë për një jetë të dinjitetshme.³²

³² <https://prishtinaonline.com/drejtore/arsimit>

KAPITULLI III

Politikat e sistemit arsimor lidhur me gjithëpërfshirjen

1. Pasqyra e gjithëpërfshirjes së komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë

Regjistrimi i vitit 1981 konsiderohet si regjistrim i fundit i popullsisë i vlefshëm në Kosovë. Në regjistrimin e vitit 1981 dhe në vlerësimin e vitit 1991 Kosova kishte numër të popullsisë prej 1,584,440, respektivisht 1,956,196 banorë. Gjatë këtyre dy regjistrimeve Kosova kishte këtë strukturë të përbërjes etnike. (Shih statistikën e viteve 1981 dhe 1991 si dhe ndryshimet në mes këtyre dy periudhave të regjistrimit).

Etniciteti	Gjithsej (1981)	Në për qind	Gjithsej (1991)	Në për qind	Diferenca
Shqiptarë	1.226.736	77.4 %	1.596.072	81.6 %	+ 369.336
Serb	209.798	13.2 %	194.190	9.9 %	- 15.608
Turg	12.513	0.8 %	10.445	0.5 %	- 2.068
Romë	34.126	2.2 %	45.745	2.3 %	+ 11.619
Tjerë	101.267	6.4	109.744	5.6 %	+ 8.477
Gjithsej	1.584.440	100,00%	1.956.196	100,00%	+ 371.756

Sipas statistikave të tanishme, në Kosovë minoritetet përbëjnë një pakicë të vogël, rreth 12 % të popullatës së përgjithshme dhe shumica prej tyre janë serbë.³³

“Të dhënat e fundit zyrtare mbi përfaqësimin e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë janë marrë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, sipas të cilit në Kosovë jetojnë 8.824 romë, 15.436 ashkalinj dhe 11.524 egjiptianë. Kështu, romët përbëjnë 0.51 për qind të popullsisë në Kosovë, ashkalinjtë 0.89 për qind dhe egjiptianët 0.66 për qind. Megjithatë, këto shifra nuk paraqesin imazhin e saktë demografik të këtyre tri komuniteteve, meqë në regjistrim nuk morën pjesë të gjithë pjesëtarët e tyre dhe regjistrimi

³³ <https://www.gjiganti.com/kosova/info/minoritetet.html>

nuk është kryer në katër komunat veriore. Për më tepër, përfaqësuesit e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian dhe zyrat komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK) kanë vlerësime joformale të numrit të secilit komunitet dhe mospërputhjet në numër mund të paraqesin shkallën e lindshmërisë dhe vdekshmërisë brenda komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, por edhe lëvizjet e popullatës në lidhje me migracionin dhe riatdhesimin nga Evropa Perëndimore, veçanërisht në periudhën 2014 dhe 2016.”³⁴

Pjesëtarët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë janë të shtrirë në disa komuna. Përqindjen më të madhe të tyre e gjejmë në komunat si Prizren, Obiliq, Pejë dhe Mitrovicë. Në Prizren 4.2% e popullatës së përgjithshme është e përbërë nga romët. Në qytete të tjera të Kosovës kjo përqindje vjen duke rënë dukshëm, p.sh. përqindjen më të vogël, rreth 0.1%, e gjejmë në komunën e Zveçanit.

Grupet e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian kanë prejardhjen nga India dhe flasin kryesisht gjuhën e tyre rome dhe është duke u punuar që gjuha e tyre të standardizohet, mirëpo folësit e këtij komuniteti cilësohen edhe si bilingualë, sepse pos gjuhës amtare flasin edhe gjuhën serbe apo shqipe, varësisht nga komuna ku jetojnë dhe veprojnë. Romët kryesisht i përkasin fesë islame, ndonëse disa e identifikojnë veten si të krishterë ortodoksë. Në Kosovë romët jetojnë kryesisht në Graçanicë që është komunë me shumicë serbe.

Sa i përket aspektit ekonomik, papunësia e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian është mjaft e madhe dhe norma e papunësisë në komunat e banuara me romë sillet nga 95% – 100%. Anëtarët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian zakonisht mbijetojnë me të hollat që u dërgohen nga anëtarët e familjes që punojnë jashtë vendit, por edhe falë punës së herëpashershme fizike apo edhe bujqësore, kurse në shkallë të vogël janë që punojnë si zyrtarë në institucione.

Kjo normë e lartë e papunësisë vjen si pasojë e pozitës së varfër socio-ekonomike të romëve, si pasojë e mungesës së kualifikimit, mungesës së informimit mbi mundësitë për punësim dhe si pasojë e diskriminimit institucional.

Arsimimi për komunitetin serb ofrohet në gjuhën shqipe dhe serbe për komunat me shumicë serbe. Në ato komuna ofrohen edhe kurse në gjuhën rome. Pavarësisht nga kjo norma e

³⁴ OSBE, Pasqyrë e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, janar 2020.

pjesëmarrjes në shkollim është mjaft e vogël dhe lirisht mund të themi se është më e vogël sesa e pakicave të tjera në Kosovë. Kjo i atribuohet kryekëput vlerës së vogël që ky komunitet i jep arsimimit dhe gjendjes së vështirë ekonomike të tyre.

Komuniteti ashkali është kryesisht i shtrirë në qytetin e Fushë-Kosovës dhe përbën 9.57% të popullatës së përgjithshme të kësaj komune. Ndërsa pjesa tjetër, 0.2% – 2.5%, banojnë në komuna të tjera. Ky komunitet i ka rrënjët në Persi, kurse në Kosovë shqipen e kanë si gjuhë të tyre dhe shumica i përkasin fesë islame.

Sa i përket përfaqësimit të tyre politik, mund të themi se është minimale, sepse ata kanë vetëm nga një përfaqësues në kuvende komunale në dy komuna: Ferizaj dhe Fushë-Kosovë. Ashkalinjtë në Kosovë jetojnë në një gjendje të rëndë ekonomike. Sikurse edhe komuniteti rom, ky komunitet ka shkallë të lartë të papunësisë që sillet mes 95% – 100% në komunat ku janë të koncentruar. Kjo vjen si pasojë e kualifikimeve të pamjaftueshme, mungesës së qasjes në mundësitë për punësim, mungesës së njohurive rreth të bërit biznes, kushteve të vështira ekonomike etj. Me një fjalë, gjendja e tyre nuk është aspak e kënaqshme.

Edhe fusha e arsimit vazhdon të mbetet një shqetësim për komunitetin joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. Këto komunitete ndjekin mësimin në shkolla të rregullta dhe ndryshe nga komunitetet e tjera këta flasin gjuhën shqipe dhe kjo sikur ua lehtëson qasjen në të gjitha shkollat. Megjithëkëtë, numri i tyre që ndjekin mësimin është jo i kënaqshëm. Kjo për faktin se ky komunitet nuk i jep vlerën e duhur shkollimit dhe shpesh numri i vogël i pjesëmarrësve në shkollë është edhe si pasojë e diskriminimit, problemeve socio-ekonomike etj. Pjesëtarët e këtyre tri komuniteteve përballen me të njëjtat probleme sikur komunitetet e tjera, siç janë:

- infrastruktura e dobët,
- mungesa shkollave të mesme cilësore dhe
- mungesa e teksteve shkollore cilësore.

Egjiptianët janë një tjetër komunitet pakicë që jetojnë në Kosovë. Ata përbëjnë 1% – 5% të popullatës së përgjithshme dhe jetojnë në disa komuna të Kosovës, si Gjakovë, Istog (përqindja më e madhe), Klinë, Pejë dhe Prizren.

Egjiptianët e konsiderojnë veten si një grup i ardhur nga Egjipti. Ata në Kosovë flasin gjuhën shqipe dhe kryesisht i përkasin besimit mysliman. Sikurse edhe komunitetet e tjera, edhe ky komunitet është i përfaqësuar pak ose fare në aspektin politik. Norma e papunësisë te ky

komunitet është mjaft e lartë dhe sillet mes 90% – 100% në vendbanimet ku jetojnë. Varësisht nga komuna, pjesëtarë të këtij komuniteti janë të punësuar kryesisht në sektorin e bujqësisë, në kompani private dhe një numër i vogël i tyre edhe në institucionet zyrtare të sektorit publik.

Problemet me të cilat përballlet ky komunitet janë:

- mungesa e kualifikimeve,
- mungesa e informatave mbi mundësitë për punësim,
- mungesa e investimeve në zhvillimin e bizneseve të vogla dhe sektorit të bujqësisë dhe
- gjendja e vështirë ekonomike në tërësi.

Sa i përket arsimimit, edhe ky komunitet ballafaqohet me një sërë problemesh. Meqë edhe ata flasin gjuhën shqipe, nuk e kanë problem përfshirjen në shkolla, mirëpo përgjithësisht nuk e vazhdojnë shkollimin tutje dhe mbesin vetëm me nivelin fillor.

Kjo vjen si pasojë e vlerës jo të kënaqshme që ata i japin shkollimit (jo të gjithë), statusit të tyre socio-ekonomik, infrastrukturës së dobët të shkollave dhe shpeshherë edhe mungesës së transportit.³⁵

Megjithëse shteti dhe MASHT-i në vazhdimësi kanë bërë përpjekje për të përmirësuar gjendjen e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, shihet qartë se ky komunitet ballafaqohet me probleme mjaft të theksuara në çdo rrafsh, prandaj shteti duhet të bëjë më shumë për të përmirësuar jetën e tyre, pasi për më tepër ky është edhe një obligim që duhet të përmbushet në kuadër të standardeve të Bashkimit Evropian.

“Situata në lidhje me shkollimin është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme. Monitorimi i OSBE-së tregon se braktisja e shkollimit nuk është më problem sistematik. Në vitin shkollor 2018/2019, 1.509 romë të Kosovës (810 djem, 699 vajza), 3,439 ashkalinj të Kosovës (1.750 djem, 1.689 vajza) dhe 847 egjiptianë të Kosovës (444 djem, 403 vajza) vijonin shkollimin fillor dhe të mesëm të ulët me kurrikulë të Kosovës. Numri i nxënësve nga komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian që vijojnë shkollimin e mesëm tregon një trend pozitiv – në vitin shkollor 2018/2019, 161 romë të Kosovës (98 djem dhe 63 vajza), 262 ashkalinj të Kosovës (151 djem dhe 111 vajza) dhe 160 egjiptianë të Kosovës (93 djem dhe 67 vajza) vijonin shkollat e mesme me kurrikulë të Kosovës. Kjo u ndihmua nga dhënia

³⁵ Zyra për çështje të komuniteteve, (shfletuar në dhjetor 2019).

e bursave nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. Gjithashtu numri i studentëve universitarë nga të tria komunitetet joshumicë (rom, ashkali dhe egjiptian) është rritur në vazhdimësi. Sipas përfaqësuesve të Roma Versitas, 42 studentë nga të tria këto komunitete joshumicë u regjistruan në institucionet e arsimit të lartë në vitin akademik 2018/2019, ndërsa kjo shifër u rrit në 53 studentë në vitin akademik 2019/2020.”³⁶

Në vitin 2008 u harta *Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës* (2009 – 2015). Kjo strategji kishte për qëllim që të identifikonte dhe të mobilizonte të gjitha burimet relevante që lidhen me sistemin arsimor të të gjitha niveleve, në mënyrë që të kontribuonte në përmirësimin e ngritjes së shkallës së arsimit dhe njëkohësisht të fuqizonte komunitetin rom, shkali e egjiptian në Kosovë. Kjo pastaj do të ndikonte në një zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik dhe social të tyre. Strategjia kishte paraparë dizajnimin dhe implementimin e politikave dhe programeve konkrete që do të ndikonin drejtpërsëdrejti në zbutjen e varfërisë, pjesëmarrjen dhe përfshirjen e tyre sa më të madhe në jetën publike, ngritjen e numrit të të arsimuarve dhe ndikimin në ruajtjen e vlerave kulturore dhe etnike të tyre si komunitete.

Për hartimin dhe zbatimin e *Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës* (2009 – 2015), padyshim që MASHT-i gjeti mbështetje të madhe të partnerëve ndërkombëtarë. Një dokument po aq të rëndësishëm për komunitetin joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, MASHT-i e kishte hartuar edhe në vitin 2007, në kuadër të së cilit ishin paraparë të gjitha problemet me të cilat ballafaqoheshin këto tri komunitete, si dhe masat dhe aktivitetet për zgjidhjen e tyre.

Komponenti i arsimit në kuadër të strategjisë për këto tri komunitete përgjithësisht plotëson *Strategjinë e arsimit parauniversitar në Kosovë*. Veçanërisht lehtëson lidhur me masat që duhet të ndërmerren rreth arsimit të grupeve jo të favorizuara, lidhur me promovimin e diversitetit, barazisë dhe përfshirjes në arsim. OSBE-ja dhe KFOS-i janë dy partnerët kryesorë që në vitin 2006 përkrahën hartimin e *Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës*. Për hartimin e kësaj strategjie padyshim që u përfshinë palët e interesit dhe përfaqësuesit e të tria komuniteteve nga të gjitha viset e Kosovës.

Në punëtorinë e organizuar me palët e interesit fillimisht u identifikuan fushat problemore, të cilat pastaj duhej të adresoheshin në strategji për të gjetur rrugë dhe mënyra për t'i

³⁶ OSBE, Pasqyrë e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, janar 2020.

tejkualuar. Analiza është bërë sipas fushave. Për fushën e arsimit është krijuar një grup i veçantë me pjesëmarrës të ndryshëm nga Qeveria e Kosovës, organizatat e ndryshme, partitë politike etj. Grupi ka përdorur analizën SËOT për të rishikuar në mënyrë specifike rezultatet e dala nga punësoria e parë. Është shikuar edhe relacioni me legjislacionin ndërkombëtar, me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e personave të cilëve u takojnë pakicat nacionale apo etnike, fetare dhe gjuhësore. Ky dokument, i aprovuar në vitin 1992, thekson që “shtetet duhet t’u qasen të drejtave për edukim të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në mënyrë proaktive.”

Kjo strategji padyshim që shfrytëzoi të gjitha dokumentet ekzistuese që në një mënyrë a në një tjetër i mbështesin minoritetet. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, e miratuar në vitin 1948, jep një mbështetje të fuqishme, duke thënë se të drejtat e njeriut janë të bazuara në njohjen dhe pranimin e personit njerëzor në të gjithë diversitetin e tij. Ekzistojnë një sërë të drejtash të cilësuar si të drejta ndërkombëtare të njeriut. Ndër to përfshihen jodiskriminimi, liria e shprehjes dhe e religjionit etj. Më parë, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e vitit 1948 solli bazë të re, meqë ishte instrumenti i parë ndërkombëtar që e deklaroi shkollimin si të drejtë të njeriut, pasi në nenin 26 të kësaj deklarate thuhet se shkollimi elementar është i obligueshëm. Ajo i obligon shtetet që teknikut dhe profesionalisht ta bëjnë të mundshëm shkollimin, kurse arsimin e lartë ta bëjnë të kapshëm në bazë të meritave. Kjo deklaratë po ashtu na bën të qartë se qëllimi i shkollimit është zhvillimi i personalitetit njerëzor. Më tej, në nenin 26 thuhet se shkollimi promovon mirëkuptim, tolerancë dhe miqësi mes kombeve, grupeve racore ose fetare dhe kontribuon për ruajtjen e paqes. Ky dokument strategjik po ashtu i referohet nenit 14 të Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ku deklarohet e drejta e pakicave për ruajtjen e identitetit të tyre kolektiv nëpërmjet gjuhës amtare, e drejtë që realizohet nëpërmjet shkollimit.

Në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, saktësisht në nenin 27, u garantohet pakicave e drejta e përdorimit të gjuhëve të tyre në bashkësi dhe me anëtarët e tjerë të grupit të tyre. Pikë tjetër mjaft e rëndësishme që është trajtuar në *Strategjinë për integritimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian* është edhe diskriminimi në fushën e arsimit. Neni 5 i Konventës së UNESCO-s kundër Diskriminimit në Arsim garanton mundësitë e pakicave kombëtare për të mësuar gjuhën e tyre amtare.

Objektivat e kësaj strategjie janë mbështetur edhe në një sërë dokumentesh të tjera. Një dokument i tillë është edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës, nenit 28, i cili flet për të

drejtën e arsimimit, por edhe neni 30. Sipas saj, në ato shtete ku ekzistojnë minoritetet gjuhësore, fëmijës që i takon një minoriteti të caktuar nuk i mohohet e drejta e përdorimit të gjuhës. Pra, mosofrimi i shkollimit në gjuhën e minoriteteve në një vend mund të konsiderohet si veprim diskriminues dhe nuk mund të arsyetohet. Por kjo nuk do të thotë që çdo kërkesë e paplotësuar e minoriteteve për edukim në gjuhë specifike është automatikisht edhe shkelje e të drejtave të njeriut, pavarësisht nga kostoja ose vështirësitë praktike që mund të ngrihen.³⁷

Në këtë dokument strategjik, gjegjësisht në komponentin e edukimit, tregohet për rëndësinë që ka gjuha e minoriteteve në fushë të edukimit të tyre. Për më tepër, kjo është në përputhje me respektimin e vlerave të diversitetit dhe tolerancës, të cilat në shoqëritë demokratike konsiderohen si gurthemel të asaj shoqërie.

Ky dokument strategjik paraqet situata të pafavorshme që mund t'i hasin fëmijët që gjuhën amtare nuk e kanë gjuhë zyrtare. Sa i përket kësaj çështjeje, mund të themi se nxënësve minoritarë, varësisht nga nevojat dhe vendosja e tyre në shkolla, u ofrohet mësim në gjuhën e tyre amtare nga autoritet publike të vendit.

Kjo gjë e ka zanafillën në konsensusin e dalë nga traktatet e mëvonshme dhe instrumentet e tjera të Këshillit të Evropës, të OSBE-së dhe të institucioneve të bashkësisë evropiane që lidhen me minoritetet dhe edukimin në gjuhët e tyre.

“Objektivat e dokumentit strategjik kosovar për komunitetin joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian mund të hasen në kuadër të normave të përcaktuara me dokumentet ligjore të BE-së. Deri në janar të vitit 2007 bashkësia evropiane ka prodhuar një numër të konsiderueshëm të rezolutave për komunitetin rom (shtatë nga Parlamenti Evropian dhe tri nga Këshilli i Bashkimit Evropian). Ndër to janë:

- Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi situatën e romëve në komunitet (1984),
- Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi edukimin e fëmijëve prindërit e të cilëve nuk kanë vendbanim të përhershëm (1984),
- Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi analfabetizmin dhe edukimin e fëmijëve prindërit e të cilëve nuk kanë vendbanim të përhershëm (1989),
- Rezoluta e Parlamentit Evropian për romët në komunitet (1994),
- Rezoluta e Parlamentit Evropian mbi diskriminimin kundër romëve dhe sintëve (1995),
- Rezoluta mbi situatën e romëve dhe sintëve në Bashkimin Evropian (2005),

³⁷ Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, 2009 – 2015.

- Rezoluta mbi situatën e femrave romë dhe sinte në Bashkimin Evropian (2006),
- Dy rezoluta nr. 89/C 153/02 të Këshillit të Bashkimit Evropian mbi dispozitat shkollore për fëmijët romë dhe ata udhëtarë (1989),
- Rezoluta e Këshillit dhe e Ministrave të Edukimit mbi dispozitat shkollore për fëmijët udhëtarë të zënë me punë (1989),
- Rezoluta e Këshillit dhe përfaqësuesve të vendeve anëtare etj.

Ka pasur edhe aktivitete dhe takime të tjera në këtë drejtim, si:

- Takimet qeveritare përbrenda Këshillit mbi gatishmërinë e sistemeve të edukimit për trajtimin e problemeve të racizmit dhe ksenofobisë (1995),
- Përkrahja e BE-së për komunitetin rom (2002),
- Situata e romëve në një Evropë të zmadhuar (2004),
- Punësimi dhe çështjet shoqërore,
- Rishikimi i asistencës PHARE të Bashkimit Evropian.

Që nga viti 1984 Këshilli i Evropës në Strasburg ka prodhuar më tepër se 500 dokumente që lidhen me komunitetin rom, gjegjësisht me përfshirjen e tyre në fusha të ndryshme shoqërore.

Në anën tjetër, zyra e komisarit të lartë për pakica kombëtare në OSBE doli me dokumentin Rekomandimet e Hagës lidhur me të drejtat e shkollimit të pakicave kombëtare. Sipas këtij dokumenti, shtetet inkurajohen që t'u qasen të drejtave të njeriut në mënyrë proaktive, sipas frymës së nenit 31 të Dokumentit të Kopenhagës, i cili inkurajon shtetet ta mbrojnë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të pakicave kombëtare.

Dokumenti strategjik kosovar i qaset në mënyrë proaktive trajtimin të elementit gjuhësor dhe edukativ të Rekomandimeve të Hagës, me çka përmbushet edhe neni 33 i Dokumentit të Kopenhagës, ku kërkohet që shtetet ta mbrojnë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të pakicave që jetojnë në territorin e tyre dhe të krijojnë kushte për promovimin e këtij identiteti.³⁸

2. Përfshirja e fëmijëve nga komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës

³⁸ Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, 2009 – 2015.

Komuniteti rom në mbarë botën ndihet më i lënë pas dore, ndërsa në Kosovë në të njëjtën kategori me romët janë edhe ashkalinjtë dhe egjiptianët që njihen si komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. Ky komunitet ballafaqohet me probleme nga më të ndryshmet, me theks të veçantë në arsim dhe punësim. Edhe pse kohët e fundit janë bërë disa lëvizje pozitive sa i përket shkollimit të fëmijëve, këto tri komunitete vazhdojnë të kenë përqindjen më të madhe të analfabetëve në Kosovë.

Në Kosovë jetojnë rreth 10 mijë romë, ndërsa 32 mijë janë egjiptianë dhe ashkalinj. Sipas statistikave të fundit, nga 1.7 milionë banorë sa ka Kosova, rreth 55 mijë prej tyre janë analfabetë klasikë, që nuk dinë shkrim-lexim. Ndërsa analfabetë funksionalë që dinë shkrim dhe lexim, por nuk janë në gjendje ta kuptojnë atë që shkruajnë, janë 82 mijë 188 persona.

Shumica prej këtyre personave që nuk dinë shkrim dhe lexim i përkasin komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. Këto komunitete, që njihen si RAE, kanë shkallë shumë të ulët të shkollimit, prandaj edhe janë krijuar shkolla nate për zbutjen e analfabetizmit.

Gjithëpërfshirja e nxënësve nga radhët e minoriteteve në arsim vazhdon akoma të mbetet një sfidë e madhe për vendin. Gjithëpërfshirja sociale në të shumtën e rasteve është e lidhur me përjashtimin social. Shumë autorë e definojnë gjithëpërfshirjen sociale në mënyra të ndryshme, p.sh., ajo zakonisht është përkufizuar si një shoqëri në të cilën të gjithë individët ndihen të vlerësuar dhe nevojat e tyre themelore janë të plotësuara, me gjithë dallimet mes pjesëtarëve të shoqërisë, pasi dallimet e tilla respektohen dhe trajtohen si faktorë kontribues të diversitetit (Robo, 2014). Gjithëpërfshirja sociale është e ndërlidhur me ndjenjën e përkatësisë, pranimin dhe njohjes së diversitetit të personit. Vlerat kryesore të gjithëpërfshirjes sociale janë të bazuara në parimet që vlerësojnë diversitetin, por në të njëjtën kohë premtojnë mbështetje për njëri-tjetrin, si: çdonjëri ka nevojë për mbështetje, çdonjëri mund të kontribuojë, çdonjëri mund të komunikojë dhe çdonjëri është i gatshëm. Në anën tjetër, përjashtimi social është i përkufizuar si proces që parandalon integrimin e individit në komunitet nëpërmjet përjashtimit të tij nga jeta sociale, politike, ekonomike dhe kulturore (Cappo, 2002).

Duke marrë parasysh se përjashtimi mund të ndodhë shumë herët në jetë, arsimi gjithëpërfshirës është një nga mekanizmat më të rëndësishëm që do të sigurojë promovimin dhe zgjerimin e konceptit të gjithëpërfshirjes sociale. Për më tepër, arsimi gjithëpërfshirës konsiderohet si një nga kërkesat thelbësore për një shoqëri demokratike (Lipsky dhe

Gartner, 2013) dhe kontribuon fuqishëm në kontekstin e shëndetit mendor (OBSh, 2012). Megjithëse, gjetjet nga literatura theksojnë përkufizime të ndryshme në lidhje me gjithëpërfshirjen sociale, p.sh. Mathieson, Popay, Enoch, Escorel, Hernandez, Johnston dhe Rispel, 2008, qasja e projektit është të merret një përkufizim i gjerë i gjithëpërfshirjes në arsim, duke iu referuar një sistemi të arsimit që menaxhon duke njohur dhe duke akomoduar nevojat e të gjitha grupeve në shoqëri, duke i përfshirë ato që janë të marginalizuara dhe që janë në rrezik të marginalizimit, siç është rasti me komunitetin joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian.³⁹ Edhe pse në vazhdimësi është punuar në përfshirjen e nxënësve nga radhët e komuniteteve RAE në arsimin e obliguar, për më shumë edhe janë stimuluar dhe janë mbështetur financiarisht nga MASHT-i dhe OJQ të ndryshme për ndjekjen dhe vazhdimin e shkollimit, mbetet akoma për t'u bërë me këtë kategori fëmijësh.

Në një analizë që i është bërë sistemit arsimor në Kosovë është theksuar që megjithëse Kosova ka shënuar një përmirësim në gjithëpërfshirjen sa u përket nxënësve në shkollimin parafillor, duhet të punohet edhe më tej në përfshirjen e grupeve të marginalizuara të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian.⁴⁰

Në nëntor të vitit 2016 KEC-i (Qendra për Arsim e Kosovës) realizoi një hulumtim në tri qytete të Kosovës të banuara me minoritete të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. Hulumtimi është bërë me qëllim që të shihet gjendja e minoriteteve dhe vështirësitë me të cilat ata ballafaqohen, përfshirë këtu edhe problemet në arsim. Hulumtimi ka nxjerrë disa përfundime, si:

- Shkollimi i fëmijëve nuk është cilësuar si vlerë dhe si prioritet i shumicës së prindërve;
- Një numër shumë i vogël i këtyre fëmijëve ndjekin shkollimin parashkollor;
- Pjesëmarrja e nxënësve nga këto komunitete në nivelin 1-9 apo në nivelin e obliguar të shkollimit është mjaft e lartë, ndërsa shkollimi i mesëm i lartë është mjaftë i ulët;
- Nxënësit minoritarë kanë ankesa lidhur me sjelljet e nxënësve nga radhët e komunitetit shumicë, si dhe nga ana e mësimdhënësve;
- Papunësia në mesin e këtij komuniteti është mjaft e lartë dhe edhe ata që punojnë bëjnë kryesisht punë fizike;

³⁹ Natyra Agani-Destani, Linda Hoxha, Kaltrina Kelmendi, Hulumtim mbi arsimin gjithëpërfshirës në dhjetë shkolla fillore të Kosovës, nëntor 2015.

⁴⁰ Luljeta Aliu, Analizë e sistemit arsimor në Kosovë, Prishtinë, 2019.

- Martesat para moshës 18-vjeçare vazhdojnë të jenë të pranishme në këto komunitete, gjë që u pamundëson vazhdimin e shkollimit etj.⁴¹

“Sistemi i Menaxhimit të Informatave për Arsimin (SMIA) në vitin 2005/2006 evidenton se nga niveli parashkollor deri në nivelin e mesëm të lartë numri i fëmijëve të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian të përfshirë në arsim është 4527 ose 1.1 % karshi komunitetit shumicë” (MASHT, SMIA 2005/2006). “Numri i personelit rom, ashkali dhe egjiptian, i punësuar në arsim, sipas të dhënave të Ministrisë së Shërbimeve Publike të majit 2007, është gjithsej 140 ose 0.53 % karshi komunitetit shumicë” (MSHP, 2007).

Në një plan të përgjithshëm, nëse merren të dhënat nga Dekada e Romëve dhe krahasohen me vendet fqinje, numri i fëmijëve që kanë përfunduar nivelin e mesëm të lartë në Kosovë është 4.5 %, gjersa në Shqipëri 4.3 %, në Serbi 9 %, në Maqedoni 11.6 % dhe në Mal të Zi është 3.7 %. Zbatimi i strategjisë për komunitetin joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian synonte mobilizimin e strukturave relevante në mënyrë që të hapeshin rrugë për këto komunitete, që të integroheshin plotësisht dhe t’u mundësohej gjithëpërfshirja, si dhe t’u jepej mundësia që të promovonin vlerat e tyre kulturore e të përparonin në rrafshin e identitetit të tyre.

Konsiderohet se komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian është i integruar pjesërisht. Për këtë ekzistojnë edhe disa faktorë që kanë shtyrë integrimin e pjesshëm të tyre në jetën shoqërore në Kosovë. Konsiderohet se organet qeveritare nuk kanë pasur mobilizim të mjaftueshëm për të shtyrë proceset e integrimit të këtyre komuniteteve joshumicë në masë më të kënaqshme, kanë munguar fondet nga qeveria, si edhe ato të donatorëve, është identifikuar edhe mungesa e fushatave vetëdijesuese për rëndësinë e arsimit dhe pjesëmarrjes në jetën shoqërore, si dhe kanë munguara iniciativat për të avokuar lidhur me të drejtat e minoriteteve në vend. Megjithëse pas luftës së fundit në Kosovë shihen disa shkëndija të vogla iniciativash, veçmas në fushën e arsimit, ku qëllim kryesor është zhdukja apo zbutja e analfabetizmit, akoma vazhdon të mbetet shqetësues numri i atyre që nuk ndjekin fare shkollim apo që gjatë rrugës për shkaqe të ndryshme e braktisin atë.

Statusi i pafavorshëm socio-ekonomik, numri jo i kënaqshëm apo tejet i vogël i edukatorëve dhe i mësimdhënësve nga radhët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, pamundësia për t’u shkolluar në gjuhën e tyre amtare, gjë që si pasojë i obligon të mësojnë në gjuhë zyrtare, për çka krijohen edhe më shumë vështirësi për ta, paragjykimet e shumta dhe stereotipat që u vishen pjesëtarëve të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian,

⁴¹ Jusuf Thaqi, Petrit Tahiri, Raport hulumtimi, Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në Kosovë, nëntor 2016.

duke filluar nga bashkëmoshatarët në shkolla e deri te moshat e rritura në shoqëri, të gjitha këto kanë bërë që përfshirja e pjesëtarëve të këtyre tri komuniteteve në arsim të vazhdojë të mbetet në nivel shumë të ulët.

Siç u tha edhe më lart, pjesëmarrja e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në arsim nuk është e nivel të kënaqshëm. Kur kemi parasysh nivelin e lartë të varfërisë dhe nivelin e ulët të shkollimit të prindërve të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, atëherë lirisht mund të themi se ky mund të jetë një faktor mjaft i rëndësishëm që ndikon në mosshkollimin e fëmijëve, sepse prindërit u shërbejnë si një shembull jo i mirë dhe nuk janë që i nxitin fëmijët e tyre drejt këtij procesi. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, që është organi kryesor për të krijuar bashkëpunim me komunitetin joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, sikur ka e humbur zinxhirin e bashkëpunimit. Si pasojë, MASHT-i nuk është i informuar sa duhet lidhur me vështirësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. Si pasojë, kjo ka ndikuar që të ketë mungesë të transparencës për sa u përket vendimeve që merren nga MASHT-i për ta.

Një problem tjetër i komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian është regjistrimi i fëmijëve me vonesë në shkollë apo edhe braktisja e saj, pasi të kenë filluar shkollimin, meqë detyrohen t'u dalin në ndihmë prindërve të tyre për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike. Shumë hulumtime tregojnë se këta fëmijë që kanë braktisur shkollën, e bëjnë këtë për shkak të diskriminimit që u bëhet nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera. Për këtë arsye, MASHT-i në bashkëpunim me OSBE-në për vite me radhë kanë ofruar programe për mësim intensiv për nxënës të që për arsye të ndryshme kanë ndërprerë shkollimin. Ku lloj mësimi ka shërbyer si alternativë që atyre që kishin ndërprerë shkollimin t'u mundësohej ta përfundonin. Kjo u bë me qëllim që pjesëtarët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian të arrinin ta përfundonin të paktën shkollimin fillor me qëllim që të bëheshin konkurrentë në tregun e punës, kur dihet se shkollimi fillor është kusht i domosdoshëm për shumicën e punëve.

Për të përmirësuar këtë gjendje, strategjia ka paraparë hartimin e politikave mbështetëse, si: dhënien e bursave që u shpërndahen nxënësve të këtyre komuniteteve për vazhdimin e shkollimit të lartë dhe njëherësh shërben si motiv që ata ta përfundojnë shkollimin e lartë, kuota për fëmijët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, në mënyrë që të vazhdojnë studimet në fusha të ndryshme. Pra, konkurrenca në tregun e punës kërkon që pjesëtarët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian të jenë të arsimuar dhe të përgatitur profesionalisht në mënyrë që të mund të kenë një vend të punës. Dimë se Kosova,

megjithëse ka legjislacion të veçantë kundër diskriminimit dhe se legjislacioni arsimor i ndalon të gjitha format e diskriminimit dhe segregimit, praktika tregon se akoma kemi raste të diskriminimit dhe të segregimit në raport me pjesëtarët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian.⁴²

3. Gjendja aktuale arsimore e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian

Komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë ballafaqohet me probleme të ndryshme lidhur me arsimimin, veçmas kur bëhet fjalë për integrimin e tij në sistemin e arsimor. Sfidat dhe vështirësitë janë të pranishme që në fazën e regjistrimit, siç janë gjuha dhe pranimi nga radhët e komuniteteve shumicë. Për më tepër, ka edhe dallime të mëdha socio-ekonomike në mes të komuniteteve shumicë dhe pakicë. Probleme të kësaj natyre ka edhe komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në Evropën Juglindore. Megjithatë, zhvillimet në fillimin e viteve të 90-ta në Kosovë kanë lënë në pozitë edhe më të pafavorshme qasjen në arsim të këtyre komuniteteve.

Pozita e minoriteteve në Kosovë është vështirësuar akoma më shumë për shkak të luftës së fundit në vend, me ç'rast edhe është bërë dëbimi i popullatës në vendet e tjera përreth e më gjerë. Vlerësimet e përafërta nga KB-ja tregojnë se pas konfliktit të vitit 1999 numri i romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në popullatën e Kosovës ka pësuar rënie nga 100 mijë në 35 – 40 mijë pjesëtarë, gjë që ka ndikuar dukshëm edhe në përfshirjen e pjesëtarëve të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor. Edhe pse ka kaluar një kohë nga ajo periudhë, këto minoritete vazhdojnë të përballen ende me probleme të shumta, siç janë statusi i vështirë socio-ekonomik i tyre, dukuritë e marginalizimit, të diskriminimit e të segregimit.

Sipas të dhënave të fundit të dala nga Sistemi i Menaxhimit të Informatave për Arsimin (SMIA), të vitit 2005/2006, nga niveli parashkollor deri në nivelin e mesëm të lartë numri i

⁴² Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, Komponenti i edukimit, 2007 – 2017.

fëmijëve të përfshirë në arsim nga komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian është 4,527 ose 1.1 % karshi komunitetit shumicë, gjersa numri i personelit rom shkali e egjiptian në arsim, sipas të dhënave të Ministrisë së Shërbimeve Publike të majit 2007, është gjithsej 140 ose 0.53 % karshi komunitetit shumicë. “Në një plan të përgjithshëm, nëse merren të dhënat nga Dekada e Romëve dhe krahasohen me vendet fqinje, numri i fëmijëve që kanë përfunduar nivelin e mesëm të lartë në Kosovë është 4.5 %, gjersa në Shqipëri 4.3 %, në Serbi 9 %, në Maqedoni 11.6 % dhe në Mal të Zi është 3.7 %. Zbatimi i këtij dokumenti do të mobilizojë të gjitha strukturat relevante për t’i hapur rrugë komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian për integrim të plotë, gjë që do t’i mundësojë këtij komuniteti gjithëpërfshirjen, ruajtjen, promovimin, zhvillimin dhe përparimin e identitetit, të traditës dhe kulturës së tij.

Integrimi i pjesshëm i komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në arsim, sipas analizave të bëra për pozitën e këtij komuniteti në Kosovë, ka ndodhur për shkak të disa faktorëve e ndër më kryesorit janë: mobilizimi i pamjaftueshëm i organeve qeveritare, fondet e limituara qeveritare dhe të donatorëve, fushatat e pakta në lidhje me rëndësinë e arsimit, mungesa e iniciativave për të avokuar dhe për të lobuar për të drejtat e minoriteteve,

Megjithëse në Kosovë janë ndërmarrë iniciativa të ndryshme me qëllim të krijimit të klimës pozitive në klasë dhe në shkollë, duke pasur edhe programe të veçanta stimuluese për motivimin e nxënësve për vijim të rregullt të shkollës, programe për zhdukjen e analfabetizmit përmes mësimi të përsheptuar, programe për arsim joformal dhe kuotime për rritjen e regjistrimit në arsimin e mesëm dhe universitar, programe për kthim të atyre atyre që kanë braktisur shkollën në bankat shkollore etj., ende mbetet shqetësues numri i vogël i fëmijëve të përfshirë në arsimin e nivelit parauniversitar dhe universitar dhe numri i madh i fëmijëve që braktisin dhe nuk përfundojnë shkollën.

Statusi i pavolitshëm socio-ekonomik, numri i vogël i edukatorëve dhe i mësimdhënësve nga radhët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, mungesa e arsimit në gjuhën rome, vështirësitë në zotërimin e gjuhës zyrtare në fillim të shkollimit, si dhe paragjykimet dhe stereotipat karshi këtij komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, paraqesin disa nga barrierat e tjera që kanë bërë që përfshirja e pjesëtarëve të këtij komuniteti joshumicë në arsim të vazhdojë të mbetet në nivel shumë të ulët. Pjesëmarrja jo e kënaqshme e këtij komuniteti në arsim është edhe për shkak të nivelit të siguri së lëvizjes në Kosovë, i cili në këto 7-8 vitet e fundit ka bërë që në disa vendbanime fëmijët e komunitetit joshumicë rom,

ashkali dhe egjiptian të mos ndihen të sigurt për të vijuar mësimet në kuadër të sistemit të rregullt arsimor. Kjo ka bërë që të krijohet një shërbim improvizues arsimor, i cili vazhdon të funksionojë në kampe, si në Gjilan dhe Plemetin, ku puna zhvillohet në kushte të pavolitshme, shpesh me mësimdhënës të pakualifikuar dhe në kushte shumë të vështira. Niveli i mësimdhënies dhe mësimnxënies në këto shkolla ka qenë shumë i ulët dhe shpeshherë jo në pajtim me sistemin e rregullt arsimor, gjë që u ka pamundësuar nxënësve të transferohen në arsimin e rregullt. Po ashtu bashkëpunimi i pamjaftueshëm në mes të MASHT-it dhe organizatave të shoqërisë civile të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, që merren me çështjet e arsimit, ka bërë që autoritetet arsimore të mos njohin nga afër vështirësitë dhe problemet me të cilat ballafaqohen nxënësit e këtij komuniteti joshumicë në Kosovë, gjë që ka ndikuar të ketë mungesë transparence gjatë marrjes së vendimeve me interes për këto pjesëtarët e këtij komuniteti.

Niveli i varfërisë, konceptet dhe niveli i ulët i arsimimit të prindërve, përfshirja në nivel jo të duhur në edukimin parashkollor, mungesa e programeve alternative për edukimin e pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian janë faktorë të tjerë që kanë ndikuar në mospërfshirjen e pjesëtarëve të këtij komuniteti në arsim. Numri i fëmijëve që nuk regjistrohen me kohë dhe i atyre që e braktisin shkollën është shumë i madh. MASHT-i dhe OSBE-ja ka disa vjet që ofrojnë programe të mësimi intensiv për nxënësit që kanë ndërprerë shkollën. Ky mësim ofrohet si mundësi alternative për vazhdimin dhe përfundimin e arsimit të obliguar. Shumë fëmijë për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike detyrohen të ndërpresin shkollën për t'u bërë krahë pune i prindërve të tyre.

Paragjykimet dhe stereotipat e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera etnike ndaj pjesëtarëve të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian janë të dukshme edhe në sistemin arsimor, gjë që rezulton me diskriminim të nxënësve dhe prindërve të këtij komuniteti joshumicë. Duke pasur parasysh që arsimimi është kusht i domosdoshëm për konkurrencë në tregun e punës, është e nevojshme që pjesëtarët e këtij komuniteti të përfundojnë së paku arsimin fillor dhe të mesëm. Për të arritur këtë status, strategjia parasheh hartimin e politikave mbështetëse, siç janë: dhënia e bursave dhe caktimit i kuotave për fëmijët e këtij komuniteti në mënyrë që të vazhdojnë studimet në fusha të ndryshme. Konkurrenca në tregun e punës kërkon që pjesëtarët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian të jenë të arsimuar dhe të përgatitur profesionalisht për të zënë një vende pune.

Edhe pse Kosova ka legjislacion të veçantë kundër diskriminimit, kurse legjislacioni arsimor ndalon të gjitha format e diskriminimit dhe segregimit, megjithatë në praktikë janë të pranishme raste të diskriminimit dhe të segregimit që u bëhen pjesëtarëve të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian.⁴³

4. Mbështetja e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian me anë të legjislacionit

Legjislacioni në Kosovë u jep të gjitha të drejtat minoriteteve në vend dhe si rrjedhojë ata i gëzojnë këto të drejta me ligj, mirëpo zbatimi i tyre në praktikë ende lë shumë për të dëshiruar. Në vazhdim përmendim disa ligje që mbështesin minoritetet.

Ligji nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë (neni 1.4.) përkufizon komunitetet si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës që nuk janë në shumicë. Këto grupe janë komuniteti serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran, malazez, kroat dhe komunitete të tjera. Më tej, ligji përcakton se anëtarët e komunitetit shumicë në Kosovë që jetojnë në një komunë ku ata janë në pakicë kanë të drejtë të gëzojnë të drejtat e radhitura në ligj.

Korniza ligjore për arsimin e fëmijëve nga komunitetet pakicë. Të drejtat e nxënësve nga komunitetet që kanë të bëjnë me arsimimin janë përcaktuar në Kushtetutë (2008) dhe ofrimi i arsimimit për pakicat në Republikën e Kosovës është i rregulluar me disa ligje që janë të paraqitura në Shtojcën 8 dhe në udhëzimet administrative të nxjerra nga qeveria. Gjithashtu *Plani strategjik i arsimit të Kosovës (2011 – 2016)* parasheh masat që duhen të ndërmerren për rritjen e pjesëmarrjes së komuniteteve në sistemin arsimor në të gjitha nivelet. Ligji (nr. 03/L-047) për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të

¹¹. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, Komponenti i edukimit, 2007 – 2017.

tyre në Kosovë përcakton të drejtat e veçanta të komuniteteve të Kosovës në lidhje me identitetin e tyre, përdorimin e gjuhëve, medie, kulturës, fesë, arsimit, shëndetit, mundësitë ekonomike dhe sociale, si dhe përfaqësimin e tyre politik.

Ligji thotë se të gjithë personat që u përkasin komuniteteve kanë të drejtë të marrin shkollim publik në të gjitha nivelet në njërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës sipas zgjedhjes së tyre, dhe ata kanë të drejtë për arsimim parashkollor, fillor, të mesëm publik në gjuhën e tyre, edhe nëse ajo nuk është gjuhë zyrtare (neni 8.1). Neni 8.7. thekson se Qeveria e Kosovës do të hartojë kurrikulat e integruara në gjuhët e komuniteteve që nuk janë gjuhë zyrtare, si dhe standardet arsimore për të gjitha aspektet e arsimit dhe do të monitorojë dhe do të zbatojë cilësinë e ofrimit të arsimit në gjuhët e komuniteteve. Përveç kësaj, neni thotë se komunitetet duhet të kenë të drejtë të bashkëpunojnë me qeverinë për të gjeneruar module arsimore lidhur me kulturën e vet, historinë dhe traditat e tyre. Kurrikula arsimore kombëtare e Kosovës duhet të përfshijë historinë, kulturën dhe atributet e tjera të komuniteteve tradicionalisht të pranishme në vend, për të nxitur frymën e respektit, mirëkuptimit dhe tolerancës ndërmjet të gjitha komuniteteve në Kosovë. Edhe organizatat përfaqësuese të komuniteteve duhet të konsultohen në procesin e hartimit të një kurrikule të tillë (neni 8.12). Udhëzimet administrative në vijim janë lëshuar nga MASHT-i: UA nr. 37/2009 për komisionin e pavarur për rishikimin e materialeve mësimore në gjuhën serbe; UA nr. 7/2010 për miratimin e kurrikulës rome në kuadër të sistemit të institucioneve arsimore të Kosovës; UA nr. 07/2010 për zbatimin e programeve të rishikuara të punës për lëndën Gjuhë rome me elemente historike dhe kulturore; UA nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe proporcioni mësimdhënës – nxënës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës – Neni 124.6. Komunitat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet; Të zbatojnë obligimet e përshkruara në Kushtetutë dhe vendimet gjyqësore. Neni 5. Gjuhët zyrtare: Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Gjuha turke, boshnjake dhe rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligjin. Neni 47. E drejta në arsimim: Secili fëmijë në komunën tuaj gëzon të drejtën për shkollim themelor. Secili fëmijë në komunën tuaj gëzon të drejtën për mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj. Nenet 59.2 – 59.4. Të drejtat e posaçme arsimore për pakicat: Të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet në njërin nga gjuhët zyrtare, sipas zgjedhjes së tyre; Secili fëmijë në komunën tuaj të marrë arsimim publik parafillor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre, deri në masën e përcaktuar me ligj.

Ligji për mbrojtje nga diskriminimi nr. 05/L021 – Neni 1. Qëllimi: Përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë. Neni 11. Mekanizmat institucionalë për mbrojtje nga diskriminimi në ministri dhe komuna: Të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe për të raportuar zbatimin e këtij ligji.

Ligji nr. 05/L -020 për barazinë gjinore – Neni 20. Ndalimi i diskriminimit gjinor dhe trajtimit të pabarabartë: Ndalohet diskriminimi mbi bazë gjinore në institucione arsimore në të gjitha nivelet, duke përfshirë qasjen në arsimim, procesin e pranimi, qasjen në shërbime, mjete dhe përfitime si bursat, rezultatet e vlerësimit, marrjen e diplomave dhe titujve shkencorë, qasjen në trajnime profesionale, ndjekjen e arsimimit, sporteve dhe fushave tjera. Neni 21. Edukimi për barazinë gjinore: Në shkolla dhe institucione të tjera arsimore mjetet mësimore të përdorura duhet të bazohen në barazinë gjinore dhe edukimi për barazinë gjinore duhet përfshirë në kurrikulat shkollore në të gjitha nivelet; Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i programit arsimor-edukativ, hartimi i materialeve, teksteve shkollore dhe rishikimi i materialeve dhe teksteve ekzistuese duhet të bëhet me përfshirjen e perspektives gjinore dhe eliminimin e stereotipave negativë, paragjykimëve, praktikave zakonore dhe praktikave të tjera, që janë në kundërshtim me parimin e barazisë gjinore; Përfshirja në aktivitete edukative dhe trajnuese në programet e shkollave që synojnë sensibilizimin e të rinjve për barazinë gjinore dhe përgatitjen e tyre për qytetari demokratike; Të ketë përfshirje të barabartë të femrave dhe meshkujve në trajnime të arsimit profesional dhe joprofesional dhe këshillimit për ato profesione që konsiderohen tradicionalisht vetëm për femra dhe vetëm për meshkuj.

Ligji për përdorimin e gjuhëve nr. 02/L-37 – Nenet 19 – 24. Përdorimi i gjuhëve në arsim: Të sigurohet mësimdhënie përkatëse në gjuhën zyrtare të zgjedhur nga personi. Në komunat ku gjuha e zgjedhur zyrtare e personit nuk përdoret nga asnjë shkollë në mësim, do të bëhen përpjekje përkatëse për të siguruar mësimin e duhur në gjuhën e tyre të zgjedhur zyrtare.

Ligji për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 – Neni 17. Kompetencat vetanake të komunave në arsim: Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit. Neni 4. Përgjegjësitë e komunave: Zbatojnë politikat dhe praktikën e tyre për të mbështetur bashkëjetesën dhe paqen ndërmjet qytetarëve të tyre dhe për të krijuar kushte të përshtatshme që u mundësojnë të gjitha komuniteteve për t'i shprehur, ruajtur e zhvilluar identitetet e tyre etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore.

Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës nr. 03/L-047 (I amendamentuar me ligjin nr. 04/L-020) – Neni 8. Të drejtat e komuniteteve në arsim: Të mundësohet e drejta në shkollim publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre edhe nëse ajo nuk është gjuhë zyrtare; Programet dhe tekstet shkollore të përmbajnë historinë, kulturën dhe atributet e tjera të komuniteteve.

Ligji për arsimin parashkollor nr. 02/L-52 – Neni 5. Gjuha: Në vendet me popullsi të përzier, të sigurohet arsimim parashkollor në gjuhët e pakicave, në përputhje me ligjin.

Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032 – Neni 40. Arsimi gjithëpërfshirës: Shkollat dhe institucionet e tjera mësimore duhet të respektojnë parimin e arsimit gjithëpërfshirës, duke akomoduar të gjithë fëmijët, pavarësisht nga kushtet e tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera; dhe promovimin e integritetit dhe kontaktit ndërmjet fëmijëve. Neni 3.5. Gjatë zbatimit të funksioneve dhe përgjegjësi të tyre në kuadër të këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, ministria, komunat dhe institucionet arsimore apo ato aftësuese do të: Respektojnë dhe avancojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, siç parashihet me Kushtetutë dhe me ligjet në fuqi; Kultivojnë njohuritë për kulturën, historinë dhe gjuhën e të gjitha komuniteteve. Neni 39. Nevojat e arsimit të veçantë: Fëmija nuk duhet të konsiderohet se ka vështirësi në mësim vetëm për shkak se gjuha ose forma e gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi nuk është e njëjtë me gjuhën ose me formën e gjuhës që përdor në shtëpi të tij, ose sepse i takon një komuniteti të caktuar dhe në rastet e tilla komuna duhet të sigurojë që fëmijës t'i ofrohet mbështetje efektive në gjuhën e mësimdhënies.

Ligji për arsim në komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068 – Neni 4. Përgjegjësitë dhe kompetencat e komunave në arsim: Të ofrojë arsim fillor dhe të mesëm, duke përfshirë

regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, marrjen në punë, pagesën e rrogave dhe aftësimin e mësimdhënësve dhe administratorëve; Bashkëpunim i mirë me komunat dhe institucionet e tjera në fushën e arsimit. Neni 6. Përgjegjësitë administrative të komunave: Monitorimi dhe raportimi lidhur me menaxhimin dhe veprimtaritë arsimore.

KAPITULLI IV

Politikat arsimore të gjithëpërfshirjes në Republikën e Kosovës në raport me standardet e BE-së

1. Partneriteti i Kosovës me Bashkimin Evropian

Orientimi i shtetit të Republikës së Kosovës është drejt vlerave universale që i përkasin Bashkimit Evropian dhe të shteteve me orientim demokratik. Përpos kësaj, të njëjtin orientim e ka edhe populli i Republikës së Kosovës, pasi jetën dhe të ardhmen e vet e sheh të dobishme duke e bazuar në këto vlera. Për të dëshmuar këtë orientim të qartë dhe të pakompromis që nga pas lufta e vitit 1999, Republika e Kosovës në çdo dokument të saj ka proklamuar orientimin drejt vlerave të Bashkimit Evropian.

Në kuptim të kësaj, Kosova që nga Korniza Kushtetuese e Vetëqeverisjes së Përkohshme kishte shprehur qëndrimin dhe orientimin drejt këtyre vlerave, duke i paraparë në mënyrë taksative, me qëllim që të krijohet shteti i së drejtës, ku do të respektohen liritë dhe të drejtat e njeriut dhe ku “institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes dhe zyrtarët e tyre ushtrojnë pushtetin e tyre në përputhje me dispozitat e Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe kushtet e përmendura në këtë Kornizë Kushtetuese; Promovojnë dhe respektojnë plotësisht rendin juridik, të drejtat dhe liritë e njeriut, parimet demokratike dhe pajtimin dhe promovojnë dhe respektojnë parimin e ndarjes së pushteteve

mes atij legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.”⁴⁴ Në këtë kuptim, fillimisht qasja është që të kemi një rregullim kushtetues, më pas ndërtim të rendit juridik si mekanizëm që do të përcaktojë formën e zhvillimit dhe mbrojtjen e jetës në vend, duke pasur për bazë çdoherë liritë dhe të drejtat e njeriut si vlera që do të gjejnë zbatim në çdo fushë të jetës.

Sa u përket vlerave dhe standardeve të Bashkimit Evropian dhe standardeve ndërkombëtare, qasje proaktive kemi të fokusuar në çdo fushë. Ajo që është me shumë interes, të drejtat e njeriut zënë vendin e duhur në çdo dokument politik. Përpos kësaj, në mënyrë taksative kjo përcaktohet edhe në Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme se “dispozitat për të drejtat dhe liritë e parashtruara në këto instrumente aplikohen në Kosovë drejtpërsëdrejti si pjesë e kësaj Kornizë Kushtetuese, siç bëjnë pjesë ato në: Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut; Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e Saj; Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Njeriut dhe Protokollet e Saj; Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial; Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Konventën për të Drejtat e Fëmijëve; Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare dhe Kornizën e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare.”⁴⁵ Duke iu referuar kësaj, mund të themi se shoqëria kosovare përmes kësaj kornize ka paraparë që në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjejnë zbatim mekanizmat që u referohen lirive dhe të drejtave të njeriut. Ajo që mund të thuhet është se Kosova është vendi i vetëm në botë, ku në mënyrë të drejtpërdrejtë inkorporohen mekanizmat ndërkombëtarë për liritë dhe të drejtat e njeriut, që i referohen arsimit, ekonomisë, punësimit etj. në Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme.

Si për çdo fushë, edhe në atë të arsimit kemi trajtim dhe orientim drejt vlerave universale të BE-së, si dhe drejt atyre të të drejtave të njeriut. Kjo është përgjegjësi e institucioneve kompetente për zhvillim të arsimit në vend. Zhvillimi i arsimit në vend konform standardeve ka filluar që nga Korniza Kushtetuese e Vetëqeverisjes së Përkohshme, ku është përcaktuar: “Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes kanë përgjegjësi në këto fusha vijuese: në arsim, shkencë dhe teknologji.”⁴⁶

Nga sa u tha më lart, arsimi është bërë pjesë e planifikimit dhe zhvillimit në institucionet e Kosovës. Për më shumë, arsimi është trajtuar edhe nga aspekti i të drejtave të njeriut dhe ai i

⁴⁴ Korniza Kushtetuese e Vetëqeverisjes së Përkohshme, neni 2, pikat a, b, c.

⁴⁵ Korniza Kushtetuese e Vetëqeverisjes së Përkohshme, neni 3, paragrafët 3.2 dhe 3.3.

⁴⁶ Korniza Kushtetuese e Vetëqeverisjes së Përkohshme, neni 5, paragrafi 1.

komuniteteve në vend, siç është përcaktuar: “Komunitetet dhe anëtarët e tyre kanë të drejtë: të përdorin lirisht gjuhën dhe alfabetin e tyre, duke përfshirë përdorimin e saj para gjykatave, organizmave dhe organeve të tjera publike të Kosovës; të arsimohen në gjuhën e tyre dhe të ofrojnë arsim e të krijojnë institucione arsimore, në veçanti për shkollimin në gjuhën, alfabetin dhe kulturën e tyre, si dhe në historinë e komunitetit të tyre për çka ofrojnë ndihmë financiare, duke përfshirë fondet publike në përputhje me ligjin e zbatueshëm, me kusht që plan-programi të respektojë ligjin e zbatueshëm dhe të reflektojë frymën e tolerancës midis komuniteteve dhe respektin për të drejtat e njeriut dhe traditat kulturore të të gjitha komuniteteve.”⁴⁷

Në vitin 2004 Kosova në mënyrë të qartë ka hyrë në partneritet me Bashkimin Evropian, duke qenë mekanizëm i dalë nga Agjenda e Selanikut, që ka pasur për qëllim mbështetjen dhe procesin e reformimit në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe për t’i sjellë ato më afër BE-së. Përmes këtij mekanizmi, synohet që vendet që janë në zhvillim, përmes identifikimit të prioritetëve, t’i adresojnë ato për të aspiruar dhe për të hyrë në BE. Përmes këtij mekanizmi, synohet që mbi bazën e asistencës së BE-së të arrihet që të plotësohen Kriteret e Kopenhagës për shtetet e Ballkanit Perëndimor. “Prej Samitit të Selanikut më 2003, Kosova ka qenë fuqimisht e përfshirë në kornizën e procesit të stabilizimit dhe asociimit. Më 20 prill 2005, Komisioni Evropian miratoi komunikatën “E ardhmja evropiane për Kosovën”, që përforcon edhe më tepër përkushtimin e BE-së ndaj Kosovës. Në vitin 2006, Këshilli Evropian miratoi Partneritetin e parë Evropian dhe më 18 shkurt 2008 Partneritetin e dytë Evropian për Kosovën. Si përgjigje ndaj kësaj, më 31 korrik 2008, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi *Planin e veprimit për implementimin e partneritetit evropian (PVPE)* 2008.”⁴⁸ Duke i bërë vlerësim kësaj, shihet se Kosova që në fazën embrionale të krijimit të shtetit dhe mekanizmave të vet institucionalë ka pasur planifikim dhe qasje pro vlerave evropiane.

Me rëndësi është edhe fakti se në këtë orientim për të arritur në cak është krijuar një partneritet i qartë mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Si rrjedhojë, ndihma e BE-së ka qenë e vazhdueshme për zhvillim dhe reformim të sektorëve me rëndësi duke e përfshirë edhe arsimin, si një mekanizëm zhvillimor në vend. “Instrumenti kryesor i asistencës së donatorëve gjatë periudhës 1999 – 2006 ka qenë Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim (CARDS). Më 2007, programi CARDS u zëvendësua me

⁴⁷ Korniza Kushtetuese e Vetëqeverisjes së Përkohshme, kreu 4, paragrafi .4.4, pikat a, b dhe j.

⁴⁸ Plani i veprimit për implementimin e partneritetit evropian për Kosovën, 2009, fq. 8.

Instrumentin e Ndhmës së Paraanëtarësimit (IPA). Kosova përfiton nga IPA përmes dy komponentëve të saj: komponenti I – mbështetja për ndërtimin dhe tranzicionin e institucioneve dhe komponenti II – bashkëpunimi ndërkufitar.”⁴⁹ Në kuadër të asistencës për rindërtim dhe zhvillim, një pjesë i referohet edhe fushës së arsimit, kjo pasi gjendja në të cilën ka dalë nga lufta dhe kërkesat që i dedikohen arsimit për proceset integruuese janë shumë larg mundësive që Kosova vetë të arrijë t’i plotësojë.

Duke qenë çdo ditë e më shumë kërkuar ndaj Kosovës për plotësimin e standardeve për procesin e integritetit, është konsideruar se Bashkimi Evropian duhet të hyjë me Kosovën në raporte kontraktuese, që Kosovës t’i bëhen e njohura saktë kushtet dhe afatet brenda të cilave duhet t’i plotësojë standardet, të specifikuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. “Negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) janë iniciuar duke u bazuar në konfirmimin e perspektivës evropiane të Kosovës në kudo të Studimit të Fizibilitetit që kishte konstatuar se Kosova ishte e gatshme t’i fillonte ato.

Bazuar në këtë, më 12 dhjetor 2012, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së kishte miratuar propozimin e komisionit për fillimin e këtyre negociatave dhe qëllimin e tij për të propozuar direktivat përkatëse, pas përmbushjes së prioritetëve afatshkurtra nga Kosova të dala nga ky studim, (të cilat kishin të bënin me katër fusha: sundimin e ligjit, administratën publike, mbrojtjen e minoriteteve dhe tregtinë). Menjëherë pas publikimit të këtij studimi, institucionet e Republikës së Kosovës kishin filluar zbatimin e kritereve afatshkurtra, proces që kishte përfunduar brenda disa muajsh.”⁵⁰ Në këtë periudhë kemi fillimin e përgatitjeve për një proces shumë të rëndësishëm për Kosovën, pasi është faza kur do të realizohen vlerësimi dhe planifikimi për një proces shumë të rëndësishëm që është ai i hyrjes në raporte kontraktuese në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Duke i vlerësuar të gjitha këto procese dhe datat kur janë filluar dhe janë përfunduar, kuptojmë se angazhimi i institucioneve të Kosovës për plotësimin e kritereve të përcaktuara nga Bashkimi Evropian janë kryer në kohë reale, duke i hapur rrugë aktiviteteve dhe proceseve të tjera më radhë. Rrjedhimisht këtu shohim se kemi qasje proaktive të institucioneve të Kosovës, duke i vendosur në prioritet të gjitha aktivitetet që i referohen Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

⁴⁹ Plani i veprimit 2009 për implementimin e partneritetit evropian për Kosovën, fq. 8.

⁵⁰ <http://www.mei-ks.net/sq/msa>

Angazhimi dhe aktivitetet konkrete të Kosovës për të realizuar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit nuk kishin të ndalur. Kështu “në prill 2013 komisioni kishte publikuar raportin monitorues për zbatimin e kriterëve afatshkurta të dala nga Studimi i Fizibilitetit, përmes të cilit ishte konfirmuar se Kosova kishte përmbushur të gjitha këto kriterë për nisjen e negociatave për MSA. Bazuar në këtë raport, më 28 qershor 2013, Këshilli i BE-së mori vendimin për nisjen e negociatave për MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Negociatat kishin filluar më 28 tetor 2013 me takimin e parë të kryenegociatorëve.

Pas hapjes së negociatave, me fokus në kapitujt IV, V dhe VI, raundi i dytë i tyre, i mbajtur më 27 nëntor 2013, u fokusua në përmbylljen e këtyre tre kapitujve, me ç’rast gjithashtu u hapën negociatat për kapitujt I, III, VII, VIII, IX dhe X. Raundi i tretë dhe i katërt u zhvilluan në dhjetor 2013, respektivisht në shkurt 2014, kurse raundi i pestë (më 24 mars 2014) u fokusua në kapitullin e fundit të mbetur, kapitullin II, mbi dialogun politik. Pas pesë raundesh të negociatave, takimi përfundimtar i kryenegociatorëve u mbajt më 2 maj 2014 në Prishtinë, me ç’rast miratohet MSA-ja duke u vendosur inicialet e tyre. Me këtë është përmbyllur procesi i negociatave, kurse MSA-ja tani gjendet në procedura të shqyrtimit dhe të miratimit nga shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së. Ky proces pritet të përfundojë kah mesi i vitit 2015, dhe MSA-ja pritet të hyjë në fuqi nga janari 2015.”⁵¹ Aktivitetet e realizuara në këtë kohë janë aktivitete konkrete, me ç’rast është negociuar dhe është diskutuar çdo fushë dhe detaj që do të jetë pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Meqë Kosova kishte qenë mjaft angazhuar për të kryer detyrimet e saj, kishte ardhur koha që të përfundonin negociatat dhe të plotësoheshin kushtet e kërkuara. Kështu “Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian nënshkruan Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit më 27 tetor 2015, në Strasburg. Ajo më pas u miratua nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 30 tetor 2015, përmes vendimit nr. 01/55 për miratimin e projektligjit për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër. Më tej, u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 nëntor 2015, me miratimin e ligjit nr. 05/L-069 për ratifikim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër.”⁵² Është viti 2015 kur Kosova dhe Bashkimi Evropian arritën që të nënshkruajnë Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, që ishte një hap shumë i rëndësishëm për të ardhmen e Kosovës,

⁵¹ <http://www.mei-ks.net/sq/msa>

⁵² <http://www.mei-ks.net/sq/msa>

përmes së cilës shtetit të Kosovës do t'i sigurohet një e ardhme e ndritur në familjen e Bashkimit Evropian. Kjo paraqet raportin e parë kontraktues të Kosovës me Bashkimin Evropian në të cilin parashihen mekanizmat përkatës për reformat që do t'i realizojë Kosova në të gjitha fushat e qeverisjes me qëllim të integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian.

Ajo që është me interes për temën tonë ka të bëjë me faktin se në kuadër të këtij partneriteti të Kosovës me Bashkimin Evropian nëpërmjet Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, përfshihet edhe zhvillimi dhe avancimi i sistemit të arsimit në Kosovë. "Palët bashkëpunojnë me synim të ngritjes së nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe arsimit e aftësimit profesional, ashtu si edhe të politikave për rininë dhe punën me rininë, si mënyrë për të nxitur zhvillimin e aftësive, punësimin, përfshirjen sociale dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë."

Një nga përparësitë në lidhje me sistemin e arsimit të lartë është arritja e standardeve adekuate të cilësisë së institucioneve dhe programeve të saj në përputhje me objektivat e procesit dhe Deklaratës së Bolonjës. Palët bashkëpunojnë gjithashtu për të garantuar që qasja në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në Kosovë të mos i nënshtrohet diskriminimit në bazë të gjinisë, origjinës racore apo etnike, fesë apo besimit, aftësisë së kufizuar, moshës apo orientimit seksual. Bashkëpunimi do të synojë trajtimin e nevojave të studentëve me aftësi të veçanta në Kosovë.

Bashkëpunimi do të synojë gjithashtu zhvillimin e kapaciteteve për hulumtim dhe inovacion, sidomos përmes projekteve të përbashkëta të kërkimit dhe inovacionit që përfshijnë të gjitha palët e interesit, duke siguruar edhe transferimin e ekspertizës. Programet dhe instrumentet përkatëse të BE-së do të kontribuojnë në përmirësimin e strukturave dhe veprimtarive arsimore, trajnimeve, kërkimit dhe inovacionit në Kosovë. Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritete që lidhen me *Acquis*-in e BE-së në këtë fushë."⁵³

Nga sa u tha më lart, del se Kosova vazhdimisht që nga paslufta e këndeja ka pasur orientim të plotë kah vlerat dhe standardet e Bashkimit Evropian, kurse tanimë këtë gjë e ka përcaktuar edhe në aktet e saja më të larta juridike, siç janë Kushtetuta, ligjet, strategjitë dhe marrëveshjet me Bashkimin Evropian. Nga kjo bëhet e njohur qartë se Kosova, përpos

⁵³ Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë dhe Bashkimin Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, neni 107.

orientimit të duhur dhe të saktë drejt vlerave të Bashkimit Evropian, ka hyrë edhe në raporte kontraktuese me BE-në, duke i përcaktuar qartë obligimet që duhet t'i plotësojë për të qenë në rrugë të duhur drejt integritit. Por ky përcaktim i qartë e obligon Kosovën që t'i përmbushë detyrimet e saj, ndër të cilat janë edhe ato që kanë të bëjnë me sistemin arsimor dhe me gjithëpërfshirjen, si dhe me liritë dhe të drejtat e njeriut. Sa i përket këtij partneriteti të Kosovës me Bashkimin Evropian, mund të konstatohet se kjo rrugë e Kosovës është e qartë, megjithëse me plot obligime dhe sfida, pasi parashihet të bëhet reformim i thellë në çdo fushë për të arritur deri tek integrimi i saj në Bashkimin Evropian.

2. Politikat arsimore për gjithëpërfshirje në Kosovë karshi obligimeve të BE-së

Duke qenë se Kosova ka orientim dhe cak të fundit anëtarësimin në familjen e Bashkimit Evropian, ka marrë obligim që të realizojë reforma në çdo fushë vetëm e vetëm që të bëhet sa më parë pjesë e Bashkimit Evropian. Fillimisht e drejta në arsim si e drejtë fundamentale është kategori kushtetuese. “Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.”⁵⁴

Meqë është fushë me shumë rëndësi për vendin, arsimi është përcaktuar si e drejtë edhe në Kushtetutë, ku saktësohet se çdo qytetari të vendit i mundësohet që të ketë shkollim pa pagesë, duke u financuar nga fondet publike. Në Kosovë kjo e drejtë i referohet çdo qytetari pa dallim, pasi në çdo fushë kemi trajtim të barabartë për çdo të drejtë pa asnjë dallim. E drejta për t'u arsimuar është e drejtë që e gëzojnë të gjithë pjesëtarët e komuniteteve në Kosovë, gjë që si e tillë është edhe kategori kushtetuese në Republikën e Kosovës. “Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që në mënyrë individuale ose si komunitet të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet, në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, sipas zgjedhjes së tyre; të marrin arsimim publik parafillor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre, deri në masën e përcaktuar me ligj, ku pragu për themelimin e paraleleve a shkollave të veçanta për këtë qëllim do të jetë më i ulët sesa ai që përcaktohet rëndom për institucionet arsimore; të themelojnë dhe të menaxhojnë institucionet private të arsimit dhe

⁵⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 47.

trajnimin për të cilat mund të jepet ndihma financiare publike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.”⁵⁵

Nga sa u tha më lart lidhur me të drejtën për arsim të komuniteteve, kuptohet se ofrohet një mbështetje shumë e madhe që komuniteteve t’u sigurohet e drejta në arsim, duke respektuar gjuhën, alfabetin dhe karakteristikat e tyre kulturore, elemente që janë të inkuorpuara në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës. Edhe ky fakt është një dëshmi që Republika e Kosovës është shtet i të gjithë atyre që jetojnë në të me të drejta konform edhe karakteristikave që posedojnë. Në këtë drejtim Kushtetuta e Republikës së Kosovës është në linjë edhe me standardet e Bashkimit Evropian edhe sa i përket hartimit të politikave arsimore. Së këndejmi, në çdo hap merren parasysh këto kategori kushtetuese dhe standarde ndërkombëtare kur hartohen politikat arsimore në Republikën e Kosovës.

Kur i referohemi hartimit të politikave për gjithëpërfshirje në fushën e arsimit konform edhe standardeve të Bashkimit Evropian, duhet të kemi parasysh se ky fillimisht është obligim konform Kushtetutës dhe legjislacionit vendës. “Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj.”⁵⁶ Me këtë rast, është me shumë interes të cekët fakti se bazuar në Kushtetutë shteti i Kosovës u jep mundësi të gjithë qytetarëve të vendit, duke respektuar gjithnjë liritë dhe të drejtat e njeriut.

Në kuadër të hartimit të çdo politike sektoriale, si dhe në atë të arsimit, Republika e Kosovës është e përkushtuar që t’i marrë në konsideratë për të inkuorpuar brenda sistemit të saj standardet ndërkombëtare të Bashkimit Evropian. Synimi i shtetit të Kosovës është që ta ketë sektorin e arsimit sipas standardeve të Bashkimit Evropian. Ka një numër të madh standardesh të BE-së që Kosova duhet t’i inkuorporojë në kuadër të hartimit të politikave për fushën e arsimit, si në kurrikulë, tekste, strategji, infrastrukturë dhe gjithëpërfshirje.

Edhe sa i përket gjithëpërfshirjes, Kosova e ka për obligim që në kuadër të hartimit të politikave t’i inkuorporojë standardet e Bashkimit Evropian që kanë të bëjmë me kategori nga radhët e fëmijëve të komuniteteve të ndryshme dhe fëmijë me nevoja të veçanta. Lidhur me politikat për këto kategori është e domosdoshme që gjatë hartimit të tyre të konsultohen e të inkuorporohen standardet më të mira ndërkombëtare me qëllim që këto kategori të jenë të gjithëpërfshira në sistemin arsimor në Kosovë.

⁵⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 59, paragrafët 2, 3 dhe 4.

⁵⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 1, paragrafi 2.

Kur i referohemi ndërtimit të sistemit dhe të drejtave, siç janë ato për arsim, nuk mund të mos trajtohen edhe nga këndvështrimi i lirive dhe të drejtave të njeriut. Në çdo aspekt gjatë hartimit të politikave në fushën e arsimit për gjithëpërfshirje në sistemin arsimor, çdo e drejtë, kufizim apo avancim vlerësohet edhe nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut. Kjo për faktin se liritë dhe të drejtat e njeriut janë të drejta natyrore të njeriut, prandaj duhet të zënë vend në çdo fushë për të cilën hartohen politika apo në çfarëdo dokumenti strategjik. Nga ajo që shohim në Kosovë, politikat arsimore dhe ato të gjithëpërfshirjes janë në harmoni të plotë me standardet e Bashkimit Evropian që sigurojnë cilësi dhe avancim të arsimit e të gjithëpërfshirjes.

3. Harmonizimi i legjislacionit – obligim i shteteve para anëtarësimit në BE, rasti i Republikës së Kosovës

Procesi i përafrimit të legjislacionit të Kosovës me *Acquis Communautaire* ka mundësuar që Kosova të ndërtojë mekanizmat përkatës që ky rrugëtim të jetë përplot sukses, duke arritur të krijojë efekte në proces të integritimit në BE. Përafrimin e legjislacionit Kosova e ka ndarë në faza, siç janë:

Faza përgatitore: Kjo fazë nënkupton përgatitjen fillestare në përafrimin e legjislacionit vendor me *Acquis*-in, e cila përfshin:

- Identifikimin e akteve juridike të BE-së që janë në fuqi (burimet primare, sekondare dhe burimeve të tjera të legjislacionit të BE-së);
- Identifikimin e legjislacionit ekzistues vendor që duhet të miratohet ose të ndryshohet dhe që korrespondon me fushën përkatëse të legjislacionit të BE-së.

Faza analitike: Në këtë fazë bëhet përcaktimi i nivelit të përafrimit që duhet të arrihet, vlerësimi se çka është e nevojshme për arritjen e përafrimit, si dhe afati kohor se kur do të arrihet. Përcaktimi i prioriteteve në fazën analitike bazohet në interesat e Kosovës, duke marrë parasysh:

- Kapacitetin administrativ për përafrim të legjislacionit dhe
- Ndikimin në zhvillimin ekonomik që buron nga përafrimi i legjislacionit.

Po ashtu, këto prioritete bazohen edhe në marrëveshjet ndërkombëtare apo dokumentet strategjike, të tilla si Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit në mes të Kosovës dhe BE-së dhe *Plani i veprimit për zbatimin e saj* apo plane të tjera shtetërore, përkthimi i akteve të

domosdoshme juridike të BE-së në gjuhët zyrtare, si dhe përfshirja e tyre në *Planin kombëtar për integrim*, në përputhje me prioritetet e përcaktuara paraprakisht.

Faza e transpozimit: Nënkupton fazën e hartimit ligjor. Pra, rrjedhimisht, transpozimi duhet të bëhet në të njëjtën kohë kur bëhet hartimi i legjislacionit. Teknikat më të shpeshta të përafrimit ligjor që përdoren në shtetet anëtare të BE-së dhe në shtetet aspiruese për integrim në BE, janë si në vijim:

- Transpozimi ligjor me riformulim;
- Transpozimi fjalë për fjalë (copy-paste);
- Transpozimi me referencë;

Zbatimi: Në këtë fazë duhet të merret parasysh që të bëhet jo vetëm miratimi i ligjeve të reja, amendamenteve të ligjeve ekzistuese në parlament ose akteve nënligjore në nivel ekzekutiv, por të sigurohet edhe aplikimi i tyre i përshtatshëm në praktikë, si dhe menaxhimi i efektit të tyre në infrastrukturën ekzistuese institucionale.

Ekzekutimi: Pas miratimit të akteve juridike, nevojiten masat e domosdoshme të autoriteteve kompetente (p.sh., monitorimi, mbikëqyrja, kontrollet inspektive, dënimet, masat gjyqësore) për të siguruar që ligji po respektohet plotësisht dhe në mënyrën e duhur.

Në përgjithësi, implementimi i duhur i të gjitha këtyre fazave që kontribuojnë në përafrimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së bëhet jo vetëm për të zhvilluar kornizën ligjore të Kosovës në përputhje me kërkesat e saj, por edhe për të siguruar kushte administrative dhe të tjera të nevojshme për zbatimin efektiv të saj.⁵⁷

Republika e Kosovës, në ndarjen e saj të dikastereve të saj, ka të themeluar edhe Ministrinë e Integritimit Evropian. Ky është mekanizëm shumë i rëndësishëm në procesin e integritimit në BE.⁵⁸ Ministria e Integritimit është mekanizmi kryesor sa i përket procesit të integritimit si dhe përafrimit të legjislacionit. Kompetencat e Ministrisë së Integritimit Evropian janë: "bashkërendimi dhe monitorimi i procesit të integritimit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, duke siguruar hartimin e politikave të integritimit, pajtueshmërinë e legjislacionit vendor me atë të Bashkimit Evropian, ndihmat financiare, informimin e publikut dhe ngritjen e kapaciteteve për këtë proces. Bashkërendon, monitoron dhe analizon ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendor me atë të BE-së, si dhe vlerëson

⁵⁷ <http://mei-ks.net/sq/korniza-ligjore-pr-prafrim>

⁵⁸ Rregullore nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, neni 18, parg. 1, nënparagrafi 1.16.

pajtueshmërinë e legjislacionit vendor me atë të BE-së.”⁵⁹ Pra, ky mekanizëm i nivelit të dikasterit qeveritar ka në kompetencë dhe përgjegjësi koordinimin, monitorimin, këshillimin dhe raportimin për procesin e integritit të Kosovës në BE dhe përafrimin e legjislacionit.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar struktura organizative në çdo ministri përmes të cilave do të avancohet procesi i integritit të Kosovës për në BE. "Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (më tutje: Departamenti) themelohet në kuadër të çdo ministrie dhe vepron duke i raportuar sekretarit të përgjithshëm të ministrisë përkatëse.”⁶⁰ Përmes kësaj qeveria ka ndërtuar segmente në çdo ministri, pasi kjo krijon mundësi që të ketë koordinim e bashkërendim që në bazë ku bëhet planifikimi dhe realizimi i detyrave dhe i përgjegjësi qeveritare në fushën e integritit dhe përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së. Detyrat dhe përgjegjësitë e departamenteve janë: "ofrimi i mbështetjes për departamentet ligjore sa i përket përfshirjes së politikave të BE-së në legjislacionin vendor gjatë harmonizimit me *Acquis*-in, si dhe kujdeset që legjislacioni që kërkohet nga PVPE-ja të futet në strategjinë legjislative të qeverisë.”⁶¹ Kjo detyrë është në funksion të avancimit në përafrimin e legjislacionit, pasi kjo mundëson që departamentet të kenë profesionalizmin, përvojën dhe njohuritë se çfarë është e nevojshme për përafrimin e legjislacionit.

Sa i përket ndërtimit të kapaciteteve institucionale që kanë për qëllim përafrimin e legjislacionit gjatë procesit të integritit në BE, Kosova i posedon këto kapacitete si në ministri, ashtu edhe në nivel të departamenteve në kuadër të ministrive. Me këtë kuptohet një qasje pozitive, përkushtim dhe planifikim i duhur i institucioneve të Kosovës për procesin e integritit të Kosovës për në BE. Përmes këtyre kapaciteteve mundësohet koordinimi, planifikimi, realizimi dhe raportimi i saktë i punës dhe i angazhimeve të institucioneve të Kosovës në procesin e integritit në BE.

Përpos kapaciteteve institucionale, Kosova ka ndërtuar edhe kapacitete që kanë të bëjnë me Kornizën Ligjore për Përafrim, të cilat mundësojnë të krijohen kushte dhe standarde që shpien drejt përafrimit të legjislacionit, si njëri ndër kushtet për integrim në BE. Legjislacioni që i referohet përafrimit të legjislacionit, fillon me *Rregulloren e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës* nr. 09/2011⁶², e cila precizon kushte dhe etapa që janë në funksion të përafrimit të legjislacionit me *Acquis Communautaire*. Kjo Rregullore ka të

⁵⁹ Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendim, nr. 6/121, datë 22.4.2010.

⁶⁰ Rregullore nr. 01/2011 për departamentet për integrim evropian dhe koordinim të politikave në kuadër të ministrive, neni 2.

⁶¹ Po aty, neni 4, parag. 1, nënparag. 1.10.

⁶² Rregullore e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 09/2011, neni 7, parg. 1.

parapara edhe konsultimet me publikun. “Para dorëzimit për shqyrtim në qeveri, nga organi propozues ose nga një trup qeveritar, të konceptdokumenteve, memorandumëve shpjeguese apo projektakteve ligjore dhe nënligjore, planeve strategjike të ministrive ose strategjiëve sektoriale, organi që ka përgatitur materialin (“organi propozues”) është kompetent për të siguruar që të gjithë mekanizmat e administratës shtetërore, organet qendrore të administratës shtetërore, organet e pavarura të administratës shtetërore dhe organet e tjera relevante, me të cilat qeveria është e obliguar të konsultohet në pajtim me Kushtetutën apo puna e të cilave mund të ndikohet nga propozimi përkatës (projektligji, akti nënligjor apo politika), të kenë mundësi të komentojnë lidhur me propozimin.” Kjo ka mundësuar që qeveria ta ndërtojë infrastrukturën ligjore përmes së cilës obligohen institucionet që në ato situata kur krijojnë projektligje, projektakte nënligjore, memorandumë shpjeguesë t’u ofrojnë mundësi për të vlerësuar dhe për të komentuar institucioneve të tjera që në një formë apo në një tjetër kanë të bëjnë me politikën e propozuar. Edhe sa i përket përafrimit të legjislacionit, çdo politikë e propozuar nga çdo institucion i nënshtrohet këtij vlerësimi dhe kjo realizohet në “Ministrinë përkatëse për Integritim Evropian për të siguruar që propozimi të jetë në përputhje me prioritetet e integritimit në Bashkimin Evropian (BE) dhe që të jetë në përputhje me kërkesat e BE-së dhe *Acquis Communautaire*.”⁶³ Vlerësimi i politikave, sa i përket përafrimit me *Acquis Communautaire*, bëhet nga dikasteri qeveritar që është Ministria e Integritimit Evropian, e cila për këtë gjë posedon mekanizma të brendshëm. Me këtë bëhet e njohur se çdo politikë qeveritare kalon nëpër filtrin e Ministrisë së Integritimit Evropian, ku vlerësohet përafrimi me *Acquis Communautaire* dhe jepen rekomandime, sugjerime dhe këshilla për avancimin e përafrimit të legjislacionit. Sa i përket *Acquis Communautaire*, një përgjegjësi i bartet edhe organit propozues, i cili “bën pajtueshmërinë fillestare me *Acquis Communautaire*.”⁶⁴

Kjo është një përgjegjësi e organeve propozuese. Me këtë dëshmohet se çështja e përafrimit të legjislacionit është politikë shtetërore dhe është e ndarë në çdo institucion që ka të bëjë me një politikë të re që duhet të përafrohet me *Acquis Communautaire*. Institucioni sponsorizues i një projektligji, para së të procedojë për miratim në Qeveri dhe Kuvend, duhet që atë projektligj ta dërgojë në Ministrinë e Integritimit Evropian dhe të kërkojë që të jepet një opinion lidhur me përputhshmërinë e tij me *Acquis*-in e BE-së. Ky është njëri ndër dokumentet që duhet t’i bashkëngjitet një projektligji, kur të dërgohet për miratim në

⁶³ Rregullore e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 09/2011, neni 7, parg. 1, nënparagrafi 1.2.

⁶⁴ Po aty, neni 39, parag. 1, nënparagrafi 1.3.

qeveri.⁶⁵ Nga kjo shohim se në kuadër të procesit të përafrimit ka një mori mekanizmesh që funksionojnë për të realizuar këtë standard bazik për një orientim të qartë të Kosovës për në BE.

Sa i përket përafrimit të legjislacionit, një barrë e madhe bie edhe mbi organin propozues që "...përgatit deklaratën e përputhshmërisë dhe tabelat e përputhshmërisë me *Acquis*-in e BE-së"⁶⁶. Me këtë organi propozues duhet ta ketë të qartë se gjatë hartimit të legjislacionit përafrimi e legjislacionit duhet të gërshetohet me deklaratën dhe tabelat e përputhshmërisë. "*Tabelat e përputhshmërisë dhe Deklarata e përputhshmërisë janë dokumente pune krahasuese që pasqyrojnë shkallën e përputhshmërisë së një projektakti normativ vendor me *Acquis*-in e BE-së.*"⁶⁷

Këto dy dokumente mundësojnë që të njihet gjendja faktike se në çfarë mase një projektligj apo akt tjetër është përafëruar. Kjo pasi përafrimi kërkon mekanizma që mundësojnë të gjenerojnë rezultate të mëtutjeshme me qëllim që më pas të jetë e mundur të njihemi me përqindjet dhe rezultatet, të cilat janë të rëndësishme në rrugëtimin integruar. Këto veprime të cekura që i referohen deklaratës dhe tabelave janë të përcaktuara në *Udhëzimin administrativ* nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative, si njëri nga mekanizmat e krijuar në fushën e legjislacionit për përafrimin e legjislacionit.

Ndër standardet bazë për integrim në Bashkimin Evropian është harmonizimi i plotë i legjislacionit të shteteve që aspirojnë të integrohen në BE, gjë që kërkohet të bëhet deri në detaje. Raste të tilla kanë pasur të gjitha shtetet që kanë synuar dhe janë integruar në Bashkimin Evropian. Në lidhje me harmonizimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së shtetet kanë qëndrim pozitiv dhe shprehin gatishmëri për t'u ambientuar me sistemin juridik të BE-së, nga i cili lindin të drejta dhe detyrime reciproke për të gjithë shtetasit e BE-së. Harmonizimi i legjislacionit me atë të BE-së mundëson që shtetet të fillojnë t'i plotësojnë standardet e tjera jo të pakta për nga numri që janë të parapara për integrim në BE.

Sa i përket shprehjes së vullnetit për integrim në BE, Kosova qysh pas çlirimit ka ndërmarrë veprime konkrete të parapara për integrim në BE. Veprimi i parë dhe kryesor i ndërmarrë nga institucionet ka qenë harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së. Lidhur me procesin e përafrimit të legjislacionit në Kosovë, bazë ligjore e parë ishte Korniza Kushtetuese e Kosovës, e cila parashihte kompetencën e institucioneve të përkohshme të

⁶⁵ Rregullore nr. 13/2013 për shërbimin ligjor qeveritar, neni 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4.

⁶⁶ Udhëzim administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative, neni 30, paragrafi 1.

⁶⁷ Po aty, neni 30, paragrafi 3.

vetëqeverisjes në Kosovë për përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së. “Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes do të jenë përgjegjëse për harmonizimin e legjislacionit dhe praktikave të tyre me standardet dhe normat evropiane dhe ndërkombëtare brenda të gjitha fushave të përgjegjësisë me qëllim të caktuar për lehtësimin e vendosjes së lidhjeve ekonomike, shoqërore dhe lidhjeve të tjera të popullit të Kosovës me popujt e tjerë evropianë dhe me vetëdije se respektimi i standardeve dhe i normave të tilla do të zërë vend qendror për zhvillimin e marrëdhënieve me komunitetin euroatlantik.”⁶⁸

Në vitin 2001 orientimi i Kosovës drejt vlerave të BE-së ka qenë i shprehur qartë. Fillimi dhe baza për procesin e përafrimit me standardet ndërkombëtare dhe evropiane tashmë ishte vendosur në aktin më të lartë kushtetues të asaj kohe për Kosovën. Përcaktimi i obligimeve për IPVQ-të ishte obligim për planifikim, koordinim dhe fillim të procesit të përafrimit konform kapaciteteve dhe mundësive institucionale.

Është me shumë interes fakti se Kosova, krahas ndërtimit të sistemit juridik të saj, një rendësi e veçantë i ka kushtuar krijimit të mekanizmave institucionale për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së, si një parakusht për proceset e tjera integruese. Përafrimi i legjislacionit ka qenë një sfidë më vete për institucionet e përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës, pasi çdo gjë ishte e re dhe sfiduese, por me një përkushtim është arritur të fillohet ky proces. Lidhur me këtë, fillimisht është krijuar një mekanizëm në kuadër të zyrës së kryeministrit, që njihet si Zyra për Proceset e Integritimit Evropian, e cila ka pasur rol koordinues në mes të institucioneve të Kosovës dhe atyre të BE-së sa u përket proceseve integruese të Kosovës për në BE. Me rëndësi për këtë periudhë kohore është edhe fakti se Kosova ka arritur të shprehë interesimin e saj për procesin e integritimit në BE, si dhe ka arritur të krijojë mekanizmat që do ta udhëheqin procesin e integritimit të përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së.

Sa herë ka ndryshuar statusi politik i Kosovës, janë bërë ndryshime dhe avancime edhe në proceset integruese. Një përcaktim, orientim dhe realizim të qartë sa i përket integritimit euroatlantik e ka bërë edhe në Kushtetutën e vitit 2008, në preambulën e së cilës përcaktohet kështu: "Të bindur që shteti i Kosovës do të jetë anëtar i denjë i familjes së shteteve paqedashëse në botë; Me synimin që shteti i Kosovës të përfshihet në proceset integruese

⁶⁸ Rregullore nr. 2001/9 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, (Gazeta zyrtare, UNMIK, 15 maj 2001). Shih kreun 5.7.

euroatlantike.”⁶⁹ Më aktin më të lartë juridik dhe në preambulën e saj, Kosova e ka bërë të qartë se do të jetë pjesë e vlerave euroatlantike për të cilat do të punojë dhe do të krijojë kushte që të ketë integrim sa më të shpejtë.

Me nxjerrjen e kushtetutës, Kosova i kishte të gjitha atributet e shtetit, prandaj kishte marrë obligime tanimë si shtet që të fillojë rrugëtimin për në procesin euroatlantik. Me shpalljen e pavarësisë dhe aprovimin e kushtetutës, Kosova i kishte krijuar të gjithë mekanizmat e saj shtetërorë që në një formë apo tjetër janë përgjegjëse për procesin e integritit të Kosovës në BE. Duke pasur të gjitha atributet e shtetit, Kosova në raport edhe me BE-në ishte në pozitë tjetër sa i përket krijimit të raporteve kontraktuale dhe bashkëpunuese me qëllim të avancimit të procesit eurointegruar. Ndryshimi i statusit politik e vendosi Kosovën në pozitë më të favorshme në çdo aspekt, duke përfshirë edhe atë integruar dhe orientues sa i përket procesit eurointegruar.

Pas vitit 2008 Kosova kishte filluar që të intensifikojë planifikimet dhe krijimin e mekanizmave për të krijuar raporte partneriteti dhe kontraktuese me BE-në. Sa i përket planifikimit, koordinimit dhe përcaktimit të qartë të kushteve, i gjithë angazhimi në këtë fazë ishte përcaktuar në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, të nënshkruar në vitin 2015.

Me këtë dokument për herë të parë Kosova ka diskutuar me BE-në duke vendosur më pas edhe kushte dhe standarde për t’u përmbushur brenda afateve të caktuara. Plotësimi i tyre do t’ia hapë dyert Kosovës për integrim në BE. Ndër të tjera, është paraparë dhe janë përcaktuar kushtet sa i përket përafrimit të legjislacionit të Kosovës me *Acquis*-in e BE-së, zbatimi i ligjit dhe rregullat e konkurrencës. Lidhur me përafrimin e legjislacionit të Kosovës me *Acquis*-in e BE-së, në marrëveshje është përcaktuar që: "palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues të Kosovës me atë të BE-së dhe të zbatimit të tij efektiv. Kosova do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojnë gradualisht drejt përputhjes me *Acquis*-in e BE-së. Kosova do të sigurohet se ligjet ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm do të zbatohen siç duhet. Ky përafrim do të fillojë në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe do të shtrihet

⁶⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.

gradualisht në tërë elementet e *Acquis*-it të BE-së të cekura në këtë Marrëveshje deri në fund të periudhës tranzitore të përcaktuar në nenin 9.”

Në një fazë të hershme, përafrimi do të përqendrohet në elementet thelbësore të *Acquis*-it të BE-së në fushën e tregut të brendshëm dhe në fushën e lirisë, të sigurisë dhe të drejtësisë, si dhe në fushat e lidhura me tregti. Në fazën e mëtejshme, Kosova duhet të përqendrohet në pjesët e mbetura të *Acquis*-it të BE-së. Përafrimi do të realizohet në bazë të një programi që do të dakordohet ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës. Kosova gjithashtu duhet të përcaktojë, në marrëveshje me Komisionin Evropian, modalitetet për monitorimin e zbatimit të përafrimit të legjislacionit dhe veprimet që duhen ndërmarrë për zbatimin e ligjit, duke përfshirë përpjekjet e Kosovës për të reformuar gjyqësorin e vet, për të zbatuar kornizën e saj të përgjithshme ligjore.”⁷⁰ Ky është dokumenti bazë që karshi kushteve të vendosura Kosovën e obligon të realizojë përafrimin e legjislacionit, si njëri ndër kushtet më të rëndësishme në procesin e integritimit në BE. Lidhur me përafrimin e legjislacionit të fushës së arsimit, kjo do të jetë në fazën e hershme. Në këtë drejtim, duhet të përafrohet legjislacioni dhe të plotësohet njëri ndër kushtet e kësaj marrëveshjeje. Nga kjo kuptojmë se legjislacioni aktual në fuqi i fushës së arsimit duhet të hyjë në fazën e plotësim-ndryshimit. Kështu, fillimisht do të reformohet dhe më pas do të përafrohet me *Acquis*-in e BE-së. Ndërsa legjislacioni që do të hartohet duhet të planifikohet që të përafrohet me *Acquis*-in e BE-së.

⁷⁰ Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, neni 74.

KAPITULLI V

Metodologjia, forma dhe përbërja e hulumtimit

1. Metodologjia e hulumtimit

Metodologjia e këtij punimi është e bazuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë siguruar përmes metodës së studimit të dokumentacionit dhe përdorimit të pyetësorëve. Metoda e studimit të dokumentacionit dhe pyetësorëve është përdorur gjatë procedurës së mbledhjes së të dhënave të mësimdhënësve, nxënësve dhe studentëve. Nëpërmjet metodës së studimit të dokumentacionit është mundësuar analizimi i dokumenteve që i referohen gjithëpërfshirjes, legjislacionit, hartimit të politikave dhe legjislacionit në Republikën e Kosovës.

Përveç nga hulumtimi i dokumentacionit, një pjesë e të dhënave primare janë siguruar edhe përmes pyetësorit, të realizuar me mësimdhënës, me studentë të Fakultetit të Edukimit dhe me nxënës nga të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. Në pyetësorë janë përfshirë 300 pjesëmarrës. Përzgjedhja e tyre është bërë në mënyrë të rastësishme.

Për mbledhjen e të dhënave është përdorur një metodologji e kombinuar, sasiore dhe cilësore, që synon t'u japë përgjigje çështjeve themelore të ngritura në studim. Burimet primare janë gjeneruan përmes intervistave.

Si burime dytësore janë përdorur dokumentet zyrtare në lidhje me arsimin dhe me gjithëpërfshirjen, literaturë akademike dhe revista, botime mbarëkombëtare, studime lidhur

me politikat në fushë të arsimit, si dhe revistat relevante që specififikisht lidhen me temën e punimit.

Studimi është përshkrues, i realizuar si një rast studimor për vlerësimin e modelit të arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me aftësi të veçanta dhe fëmijëve të minoriteteve në disa shkolla të rregullta të komunave të ndryshme të Kosovës. Hulumtimi do të prodhojë një njohuri origjinale empirike mbi temën bazuar në gamën e gjerë të burimeve primare dhe sekondare. Burimet parësore do të gjenerohen përmes intervistave me organet kompetente në arsim (MASHT), intervista me mësimdhënës, me prindër të të dyja kategorive dhe me drejtorë të shkollave të rregullta.

Si burime dytësore do të përdoren dokumentet zyrtare lidhur me arsimin dhe me gjithëpërfshirjen, literaturë akademike dhe revista, botime mbarëkombëtare, studime që lidhen me politikat në arsim, si dhe revista relevante që trajtojnë këtë temë në mënyrë specifike.

2. Metodatat e hulumtimit

Në këtë hulumtim janë përdorur metoda të kombinuara: sasore dhe cilësore. Këto metoda kanë gjetur zbatim në shumë studime dhe kanë rezultuar si të suksesshme në konstatimet sa më reale të gjendjes gjatë studimeve të dukurive të ndryshme. Të dhënat që janë nxjerrë përmes zbatimit të metodës sasore dhe cilësore kanë plotësuar opinionin e mësuesve, studentëve dhe nxënësve që kanë qenë pjesë e studimit sasior.

3. Instrumentet e hulumtimit

Hulumtimi është realizuar me mësimdhënës, nxënës (nga komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian) dhe me studentë të Fakultetit të Edukimit me qëllim të grumbullimit të të dhënave. Për këtë qëllim janë hartuar katër pyetësorë për të tria këto kategori.

a. Pyetësori për mësimdhënës që punojnë me nxënës me nevoja të veçanta. Kjo është bërë me qëllim që të shihet pozita e tyre gjatë punës me këta fëmijë, gatishmëria e tyre për t'u marrë me fëmijë me nevoja të veçanta dhe gatishmëria për t'u avancuar dhe për të fituar njohuri shtesë në mënyrë që të jenë sa më të përgatitur për t'u marrë me këta fëmijë.

b. Pyetësor tjetër është realizuar me studentë të Fakultetit të Edukimit që pritet të jenë mësimdhënës të ardhëm. Studentët janë pyetur për kurrikulat që u ofrojnë programet e

studimit, në mënyrë të vevçantë ato që kanë të bëjnë me fëmijët me nevoja të veçanta, përvojat e tyre me këta fëmijë gjatë kohës së praktikës mësimore, për përgatitjen e tyre profesionale lidhur me punën me këta fëmijë dhe për gatishmërinë e tyre për të punuar me këta fëmijë.

c. Pyetësi tjetër është realizuar me mësimdhënës që punojnë apo që në klasat e tyre kanë nxënës nga komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. Me këta mësimdhënës kemi hulumtuar çështje shumë me rëndësi për nxënës nga komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian për të parë përfshirjen e tyre në shkollë, qasjen e komunitetit shumicë ndaj tyre, qasjen e mësimdhënësve, mbështetjen që u ofrohet dhe format e mbështetjes etj.

d. Pyetësi tjetër, i realizuar me nxënësit nga RAE, është bërë me qëllim që të shohim se sa janë të mirëpritur ata në ambientet e shkollës nga mësimdhënësit dhe nxënësit shumicë, a gjejnë mbështetjen e mjaftueshme për kryerjen e detyrave të shtëpisë, si e kalojnë kohën e lirë, sa përfshihen në aktivitete jashtëkurrikulare që organizon shkolla etj.

4. Popullata e hulumtimit

Hulumtimi është realizuar në Kosovë dhe, rrjedhimisht, janë intervistuar banorë të Kosovës të profesioneve dhe të kategorive të lartpërmendura.

Hulumtimi është realizuar në komuna të ndryshme, duke u përfshirë në mënyrë specifike ato komuna ku janë të koncentruar pjesëtarë të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian.

5. Kampioni

Kampioni i këtij hulumtimi është përzgjedhur në bazë të probabilitetit. Numri i të anketuarve nuk ka qenë edhe shumë i madh, sepse janë realizuar katër pyetësorë dhe në të katër pyetësorët janë trajtuar tematika të ndryshme. Marrë në tërësi, të gjithë janë aktorë të përfshirë në proceset arsimore, andaj si tërësi del numër i mjaftueshëm.

Kampioni i përzgjedhur në pyetësin e realizuar për fëmijët me nevoja të veçanta janë mësimdhënës nga komunat më të mëdha të Kosovës.

Kampioni në pyetësin me studentë janë studentë të Fakultetit të Edukimit në Prishtinë dhe, eventualisht, ndonjë edhe nga fakultetet e tjera të edukimit, si në Gjakovë dhe Prizren, kur anketimi është realizuar në mënyrë elektronike.

Kampioni në pyetësin me nxënës ka përfshirë nxënës të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian dhe është fokusuar në qendrat ku këto pjesëtarë të këtij komuniteti janë më shumë të koncentruar dhe zhvillojnë jetën dhe veprimtaritë e tyre.

Kampioni në pyetësin me mësimdhënës, që në klasat e tyre kanë nxënës nga radhët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, është i vetmi kampion tek i cili përzgjedhja e mësimdhënësve ka qenë e qëllimshme, sepse mësimdhënësi është dashur patjetër të ketë në klasën e tij nxënës nga komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. Realizimi i këtij pyetësi është bërë me më tepër vështirësi sesa realizimi i pyetësorëve të lartcekur.

Pra, siç e shohim, kampioni ka përfshirë nxënës, mësimdhënës dhe studentë. Marrë së bashku, në përgjithësi janë më shumë se 400 respondentë që u janë përgjigjur pyetësorëve të parashtruar.

6. Grumbullimi dhe administrimi i të dhënave

Mbledhja dhe grumbullimi i të dhënave është realizuar gjatë viteve 2018 – 2019. Hulumtimi ka zgjatur rreth tre muaj dhe të dhënat e këtij hulumtimi janë përpunuar me programin Excel. Pyetësorët për mësimdhënës janë administruar nga vetë hulumtuesja, pyetësorët për nxënës nga radhët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian nga tutorët që punojnë në shkollat ku ka fëmijë të këtij komuniteti dhe pyetësorët me studentë janë realizuar në periudhën e mësimi praktik të studentëve nëpër shkollat të rregullta. Për ta pasur më të lehtë realizimin e këtyre pyetësorëve, është shfrytëzua kjo periudhë e mësimi praktik dhe, si rrjedhojë, pyetësorët janë administruar nga mësueset mentore të këtyre studentëve.

Është me rëndësi të ceket se të gjithë pyetësorët e dhënë janë kthyer nga respondentët, përveç disa rasteve të nxënësve të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, sepse disa tutorë, për shkak të orarit të shkurtër mësimor, pyetësorët ua kanë dhënë nxënësve për t'i plotësuar në shtëpi.

7. Konsideratat etike

Hulumtimi është realizuar gjithmonë duke pasur në konsideratë parimet etike dhe profesionale, parime që janë respektuar me përpikëri gjatë gjithë realizimit të hulumtimit. Pjesëmarrësit nuk janë obliguar apo nuk u është bërë presion të jenë me doemos pjesëmarrës të hulumtimit dhe ata këtë e kanë bërë me vullnet të plotë.

I gjithë hulumtimi i realizuar dhe identiteti i të anketuarve ka qenë anonim dhe padyshim që është respektuar në maksimum anonimiteti i tyre.

KAPITULLI VI

Hulumtimi për politikat arsimore të gjithëpërfshirjes në arsimin parauniversitar

1. Një vështrim i shkurtër i përmbajtjes së kapitullit

Kjo është pjesa bosht e temës së hulumtuar që pasqyron të dhënat e hulumtimit të gjeneruara nga anketat e realizuara me respondentët kompetentë, të cilët me anë të përgjigjeve të tyre në pyetësorët e bërë japin njohuritë e tyre për këtë temë. Është e rëndësishme të ceket se përmes këtij hulumtimi kemi arritur të hyjmë në brendi të problemit dhe të nxjerrim atë që është me interes për këtë hulumtim dhe me rëndësi për sistemin arsimor, veçmas lidhur me gjithëpërfshijen në sistemin arsimor të Kosovës.

Në këtë kapitull kemi prezantuar grafikët me të dhënat e tyre që pasqyrojnë përgjigjet e dhëna në pyetësorët që janë si shtojcë e kësaj teme. Këto përgjigje janë refleksion i punës, i vlerësimit dhe i përkushtimit të respondentëve, të cilët janë nxënës nga radhët e komuniteteve joshumicë, studentë të Fakultetit të Edukimit dhe mësimdhënës. Kjo na krijon mundësinë që të kemi të dhëna me shumë rëndësi për hulumtimin që kanë të bëjnë me sistemin arsimor, më saktë me gjithëpërfshirjen në sistemin arsimor të Kosovës, veçmas me nxënësit me nevoja të veçanta dhe me nxënësit nga radhët e komunitetit joshumicë rom, shkali dhe egjiptian. Në këtë kapitull, pjesë e çdo grafiku është analiza e të dhënave të çdo grafikoni nga i cili nxjerrim vlerësimin real për çdo pyetje dhe kjo mundëson që të krijohet

konkluzioni fillimisht për çdo pyetje dhe më pas për tërë hulumtimin, duke dalë me një konstatim të përgjithshëm.

Në këtë kapitull do të elaborohet në detaje qëllimi i hulumtimit, si një element tejet me rëndësi nga i cili në kuptojmë arsyen e realizimit të këtij punimi kërkimor dhe ato se çfarë derivojnë nga ky hulumtim, që është një përpjekje për të ofruar të dhëna të sakta e me interes për organet kompetente dhe përgjegjëse që ato të ndryshohen, të reformohen e të avancohen. Për të pasur saktësi të plotë në këtë hulumtim është me interes dhe me rëndësi të veçantë edhe aspekti procedural i hulumtimit.

2. Qëllimi dhe procedura e hulumtimit

Hulumtimi është realizuar me qëllim të vlerësimit (testimit) të hipotezave të ngritura në këtë punim. Përmes këtij hulumtimi mundësohet që hipotezat e paracaktuara të vlerësohen dhe të vërtetohen ose jo mbi bazën e të dhënave të hulumtuara, gjë që është një element me rëndësi të theksuar në këtë hulumtim. Përmes këtij hulumtimi fillimisht bëhet një vlerësim i gjendjes aktuale të gjithëpërfshirjes në kategoritë e specifikuara dhe të lartcekura, i nivelit të reformimit dhe avancimit të këtij aspekti, në bazë të të cilit shihen edhe efektet e arritura. Nga ky hulumtim mësojmë lidhur me mangësitë që ka ky sistem dhe lidhur me efektet pozitive që ka gjithëpërfshirja. Në kuadër të kësaj teme, pikërisht hulumtimi është pjesa më e rëndësishme e punimit, pasi mundëson që, përpos aspektit teorik shkencor, të vështrohet problemi edhe në bazë të raporteve e analizave të legjislacionit në fuqi përmes hulumtimit direkt të burimeve të të dhënave. E tërë kjo bën të mundshme që tema të trajtohet mirë në aspekt teorik dhe praktik mbi bazën e gjetjeve konkrete.

Është e natyrshme që punimi ta ketë edhe aspektin procedural që është një komponent përmes të cilit mundësohet të realizohet hulumtimi. Kështu, hulumtimi është kryer përmes pyetësorëve, modelet e të cilëve jepen në shtojcë të punimit. Me anë të këtyre pyetësorëve si instrument hulumtimi është realizuar në formë anketimi me respondentë që i takojnë drejtpërsëdrejti fushës së arsimit, studentë, nxënës dhe mësime dhënë. Pyetësorët janë punuar në DOC dhe të njëjtët janë shpërndarë në formë fizike edhe te studentët përmes e-mailit dhe përmes e-mailit janë pranuar edhe përgjigjet. Të gjitha përgjigjet e marra janë fuzionuar dhe janë përpunuar në Excel. Pyetësorët përmbajnë nga 10 – 30 pyetje varësisht nga kategoria e të intervistuarve dhe që përfshijnë të gjitha problematikat e hulumtimit. Përgjigjet e marra

përmes tij nga të anketuarit na kanë mundësuar që të nxjerrim edhe konstatimet lidhur me temën e hulumtuar, si dhe mbi këtë bazë kanë dalë edhe rekomandimet.

3. I rikujtojmë hipotezat e punimit

Në këtë punim trajtohet gjithëpërfshirja në arsimin parauniversitar si kategori mjaft e ndjeshme. Në kuadër të gjithëpërfshirjes e kemi vënë theksin te dy kategori si mjaft të ndjeshme, nxënësit me nevoja të veçanta dhe përfshirjen e nxënësve të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në procesin mësimor. Punimi shtjellon gjithëpërfshirjen në aspektin teorik, pra në aspektin se si e paraqesin ligjet në fuqi dhe realitetin ashtu siç na paraqitet në terren. Krahas këtyre, trajtohet edhe rëndësia e gjithëpërfshirjes për arritjen e standardeve të përcaktuara nga BE-ja si dhe krahasohet legjislacioni i Kosovës me atë të Bashkimit Evropian, sa i përket gjithëpërfshirjes në arsim.

Rezultatet e pritshme nga ky hulumtim do të ofrojnë të dhëna për gjendjen aktuale të gjithëpërfshirjes së këtyre dy kategorive, rëndësinë e përmirësimit të kësaj gjendjeje në bazë të asaj se çka pasqyron realiteti në terren dhe rekomandimet që mund të dalin nga të dhënat e gjeneruara me anë të pyetësorëve të realizuar me kategoritë e lartcekura. Në këtë kontekst, shtrohen edhe pyetjet kërkimore (hipotezat) që janë këto:

Hipoteza 1. Politikat arsimore të gjithëpërfshirjes nuk monitorohen mjaftueshëm nga politikëbërësit, nëse ato janë duke u zbatuar si duhet ose jo.

Hipoteza 2. Politikat arsimore të gjithëpërfshirjes nuk kanë gjetur zbatim të duhur për kategorinë e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian dhe për kategorinë e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Hipoteza 3. Politikat arsimore të gjithëpërfshirjes janë të mbështetura në politikat dhe standardet e BE-së.

4. Efektet e gjithëpërfshirjes në arsimin parauniversitar në Kosovë

Hulumtimi gjeneron të dhëna me rëndësi të madhe, sepse në bazë të tyre na mundësohet që të bëjmë një vlerësim real në lidhje me gjendjen aktuale sa i përket gjithëpërfshirjes në sistemin arsimor parauniversitar dhe legjislacionit përkatës në fuqi lidhur me këtë çështje. Hulumtimi na tregon qartë se cilat janë pikat në të cilat sugjerohet të intervenohet me qëllim të përmirësimit të gjendjes aktuale për ndryshim dhe për reformim dhe, ç'është me rëndësi, këto të dhëna na mundësojnë që t'i identifikojmë efektet që arrihen përmes reformimit të legjislacionit apo monitorimit të aplikimit të drejtë të tij konform standardeve ndërkombëtare. Identifikimi i mangësive në këtë proces mund të jetë një pikë referente me shumë vlerë që mund t'u shërbejë institucioneve përkatëse në të ardhmen.

Për ato institucione apo mekanizma përkatës shtetërorë, në kuadër të punës së tyre do ta kenë të mundur që të dhënat që kanë dalë nga ky hulumtim t'i përdorin. Ky hulumtim na ka dhënë disa efekte, siç janë këto:

- Gjithëpërfshirja si kategori arsimore mjaft specifike ka një rol mjaft të rëndësishëm në përmirësimin e kushteve dhe standardeve të përcaktuara nga BE-ja për një sistem arsimor të kompletuar në Republikën e Kosovës.
- Aspekti normativ përkatës në fuqi mjaft mirë e ka të shtjelluar gjithëpërfshirjen në sistemin arsimor. Kjo e drejtë përcaktohet edhe në Kushtetutë, e cila përcakton dhe promovon të drejta të barabarta për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë pa asnjë dallim. Lidhur me zbatimin e aspektit normativ për gjithëpërfshirjen, kërkohet më tepër monitorim nga mekanizmat përkatës institucionalë për realizimin e drejtë të të drejtave ndaj secilit individ, ashtu siç i ka të garantuara.
- Nga ky hulumtim po ashtu mësojmë se programet që u ofrohen studentëve të Fakultetit të Edukimit, të cilët menjëherë pas përfundimit të studimeve mund të punojnë si mësimdhënës, duhet të pasurohen akoma më tepër dhe të specifikohen sa i përket gjithëpërfshirjes në arsim në mënyrë që studentët, mësimdhënës të ardhshëm, të mos kenë vështirësi në punën e tyre si pasojë e mosinformimit përgjatë studimeve.
- Mësimdhënësit duhen trajnuar në vazhdimësi lidhur me punën me nxënësit me vështirësi të caktuara me qëllim që të jenë në gjendje t'u qasen drejt atyre fëmijëve dhe në këtë proces fëmijët të përfitojnë në shkollë dhe jo të jenë thjesht pjesëmarrës pasivë.
- Drejtoritë komunale të arsimit në mbështetje nga MASHT-i duhet t'i identifikojnë nevojat e mësimdhënësve për trajnime në lidhje me punën me nxënësit me nevoja të veçanta, si dhe duhet të motivohen shkollat për zhvillim profesional me bazë në shkollë.

- Progresi ekonomik, kur vlerësohet në përgjithësi, është pjesë që kryesisht ndërlidhet me çdo sferë të jetës, e një ndikim më se të rëndësishëm e ka edhe sa i përket gjithëpërfshirjes në arsim. Progresi ekonomik i vendit reflekton edhe te ngritja e nivelit të gjithëpërfshirjes në arsim dhe tejkalimin e barrierave ekonomike të familjet që do të reflektonin edhe në gjithëpërfshirjen në arsim për fëmijët e tyre.
- Vlerësimet që i bëhen Republikës së Kosovës, qoftë vendore apo ndërkombëtare, lidhur me sistemin arsimor dhe gjithëpërfshirjen, gjenerojnë vërejtje dhe rekomandime për sistemin arsimor dhe për gjithëpërfshirjen. Sistemi arsimor është fusha në të cilën ka defekte dhe si pasojë e kësaj kemi ngecje edhe në fushat e tjera. Nga ajo që gjeneron hulumtimi, rezulton se gjithëpërfshirja në arsim ka refleksion në respektim dhe zbatim të rendit juridik, zbatim të standardeve të BE-së dhe, para së gjithash, barazi dhe eliminim të çfarëdo diskriminimi.
- Që Republika e Kosovës të kualifikohet si shtet i të gjithë banorëve të saj pa dallime, gjithëpërfshirjen në arsim dhe zhvillimin e saj duhet ta ketë në nivel, ashtu siç e ka të përcaktuar në aspektin normativ dhe kushtetues. Gjithëpërfshirja është elementi i parë që vlerësohet, nëse Republika e Kosovës është shtet që u ofron mundësi të gjithë banorëve të saj.
- Gjithëpërfshirja në arsim ka një lidhshmëri direkte edhe me qasjen në punësim, në të mira shoqërore, në informacione të dobishme për jetën dhe në të ardhmen, që kanë lidhshmëri me mundësinë për gjithëpërfshirje në arsim. Qasja në punësim profesional është e drejtë e çdo qytetari, andaj gjithëpërfshirja në arsim është një mundësi dhe e drejtë që i siguron të ardhme të ndritur çdo qytetari të Republikës së Kosovës.
- Orientimi i Kosovës në çdo sferë të jetës është drejt vlerave universale të botës demokratike e në veçanti drejt vlerave të BE-së, gjë që reflekton në respektim të të drejtave të njeriut dhe mundësi të barabarta për çdo qytetar të saj. Republika e Kosovës në bazë të orientimit të saj duhet ta ketë synim parësor që këto vlera të bëhen obligim i shtetit të Republikës së Kosovës. Kjo me qëllim që vendi të ketë prosperitet në çdo fushë, edhe në atë të arsimit dhe të gjithëpërfshirjes.
- Sistemi arsimor i Republikës së Kosovës, që nga përfundimi i luftës e deri më sot, ka kaluar nëpër disa faza zhvillimore, duke u reformuar sidomos nga ato aspekte zhvillimore që lidhen me zhvillimin ekonomik, me punësimin, me teknologjinë informative dhe me fusha të tjera. Pas shpalljes së pavarësisë (2008), mandati i institucioneve të Kosovës ka qenë për të ndërtuar e për të reformuar sistemin arsimor edhe në aspektin e gjithëpërfshirjes. Pas shpalljes së pavarësisë dhe aprovimit të kushtetutës krijohet një situatë faktike në vend dhe

nga ky moment kemi përgjegjësi të bartur në institucionet e Kosovës sa i përket ndërtimit të çdo fushe, edhe në sistemin arsimor. Me këtë bëhet e ditur se edhe gjithëpërfshirja në arsim do të jetë më e zhvilluar, por ende me obligime konkrete për t'u kualifikuar si shtet që respekton në tërësi të drejtat e njeriut.

5. Analiza e të dhënave nga pyetësorët e realizuar me mësimdhënës

Kur për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla, padyshim se menjëherë pas fëmijëve kemi për bazë personalin mësimor. Për këtë arsye ne kemi realizuar një pyetësor me rreth 100 mësimdhënës nga të cilët pothuajse të gjithë kanë pasur të përfshirë në klasat e tyre edhe fëmijë me nevoja të veçanta. Në vazhdim ju sjellim edhe rezultatet e dala nga ky pyetësor.




Grafiku 1.

Të pyetur nëse mësime dhënësit kanë ndjekur ndonjë trajnim lidhur me qasjen ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta, morëm këto përgjigje: 45% thanë se janë të trajnuar, ndërsa 55% e tyre jo.

Nëse ndalemi dhe i bëjmë një analizë gjithëpërfshirjes në arsim dhe përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta, ku hyjnë shpeshherë edhe fëmijëve me shkallë të lartë të autizmit dhe shkallë të lartë agresiviteti, atëherë përqindja e mësime dhënëse që nuk kanë ndjekur trajnime lidhur me punën me këta fëmijë është mjaft e lartë për të përballuar vështirësitë me ta në klasat e tyre.

Mund të arsyetojmë shpeshherë edhe ankthin e mësime dhënëse, sidomos të ciklit të ulët, kur marrin vesh se në klasën e tyre kanë fëmijë me nevoja të veçanta. Ky ankth lirisht mund të themi se vjen nga pasiguria që ka mësuesi për punën e duhur me këta fëmijë dhe shpeshherë pyetja e tyre është: “A do të di unë të bëj punën e duhur me këtë nxënës?” Konsideroj që ky duhet të jetë një alarm për MASHT-in që harton politika arsimore dhe DKA-të e Kosovës, të cilat duhet ta kenë si një nga prioritet kryesore çështjen e trajnimit të mësime dhënëse. Nëse stafi mësimor nuk është i përgatitur për t’u marrë si duhet me këta fëmijë, atëherë edhe politika e gjithëpërfshirjes mund të rezultojë jo e kënaqshme dhe, nga ana tjetër, e dimë që është një nga standardet që vendi duhet ta plotësojë.

2. A e konsideroni të nevojshme të ndiqni trajnime / seminare të tjera për të marrë njohuri për punën me fëmijët me nevoja të veçanta?



Grafiku 2.

Nga praktika e dimë se, si në çdo sferë të jetës, edhe në arsim gjërat evoluojnë, andaj të qenët në hap me ndryshimet dhe risistë që sjell koha janë elemente mjaft të rëndësishme që e bëjnë një mësimdhënës të jetë i suksesshëm dhe i kërkuar.

“Zhvillimi profesional i mësimdhënësve, nga periudha e pasluftës (1999), ka pësuar zhvillime të shumta si në kuadër të politikave, ashtu edhe në praktikat e realizimit. Në dekadën e fundit ka fituar një dimension të ri, në përpjekje për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm për zhvillimin e mësimdhënësve, në dobi të të gjithë mësimdhënësve, për mirëmbajtjen, përmirësimin dhe avancimin e kompetencave të mësimdhënies, sepse zhvillimi profesional i mësimdhënësve vlerësohet të jetë një ndër faktorët kyç që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve.”⁷¹

Pas luftës së fundit në Kosovë kemi pasur një numër të madh organizatash vendore dhe ndërkombëtare që pikësynim kanë pasur avancimin e mësimdhënësve dhe rifreskimin e njohurive të tyre, duke ofruar trajnime të natyrave të ndryshme. Trajnimet kanë pasur për

⁷¹ Selim Mehmeti, Ema Rraci, Kushtrim Bajrami, Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë, 2009, Prishtinë, fq.9


qëllim përmirësimit të punës së tyre, ofrimin e metodologjive të reja arsimore në mënyrë që mësimitdhënës të kenë më tepër mundësi që punën e tyre ta bëjnë më me lehtësi dhe më atraktive për nxënësit. Pas metodologjive, ata janë trajnuar edhe për përdorim të teknologjisë në punën e tyre, gjë që është mirëpritur nga shumë mësimitdhënës.

Në pyetjen nëse ata dëshirojnë akoma të trajnohen, ata kanë dhënë këto përgjigje: 76% e tyre thonë se janë të gatshëm që të trajnohen edhe më tutje për qasje ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta dhe 24 % e tyre thonë se nuk kanë interesim.

Në mesin e atyre që kanë thënë se nuk kanë interesim për trajnime të kësaj natyre janë kryesisht mësimitdhënës të moshave të shtyra, të cilët shpeshherë kanë refuzuar të jenë pjesë e trajnimeve të çfarëdo natyre që u janë ofruar. Ata e kanë arsyetuar këtë me faktin se gjatë studimeve kanë marrë njohuri të mjaftueshme dhe se nuk kanë nevojë për trajnime shtesë. Shpeshherë gjatë punës me mësimitdhënës kemi hasur edhe mendime të atilla se nëse ndonjëri nga mësimitdhënës ndjek trajnime të kësaj natyre, pra për qasje ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta, atëherë ata do të rrezikohen, sepse drejtoria e shkollës do të dërgojë fëmijë me nevoja të veçanta në klasat e tyre.

Sidoqoftë, mendimet e tyre janë shumë të pajustificueshme dhe drejtoria e shkollës duhet të ketë një plan për trajnimin e të gjithë mësimitdhënësve, sepse padyshim që secili nga ta do të ballafaqohet me nxënës me nevoja të veçanta, kurse trajnimet vetëm do të lehtësojnë punën e tyre.

3. Cili institucion i ka ofruar këto trajnime?



Grafiku 3.

Në grafikonin 3, të paraqitur më lart, shohim se shumicën e këtyre trajnimeve i organizojnë OIQ-të, pra rreth 43% e mësimitdhënësve e pohojnë këtë gjë, 34% DKA-të me iniciimin e MASHT-it dhe 23% e tyre marrin njohuri në formë modulesh edhe nga universiteti, aty ku mbarojnë studimet.

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve në Kosovë është i rregulluar me legjislacion primar dhe sekondar. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) është përgjegjëse që të planifikojë fonde, të akreditojë programe të ndryshme të trajnimeve në bazë të nevojave të mësimitdhënësve dhe të hartojë standarde për të siguruar cilësi dhe për të krijuar mekanizma për zbatimin e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve. Komunitet, gjegjësisht drejtoritë komunale të arsimit (DKA), janë përgjegjëse për të trajnuar mësimitdhënësit në nivel komune, gjithmonë duke u bazuar në nevojat e tyre dhe pastaj për të siguruar buxhetin e nevojshëm për realizimin e atyre trajnimeve. Shkollat si institucioni më i afërt me mësimitdhënësin është përgjegjëse për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve me bazë në shkollë, praktikë që është bërë mjaft e pranishme në shumë shkolla, ku shpeshherë edhe mësimitdhënësit mbajnë trajnime për kolegët e tyre në ndonjë fushë të caktuar.

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë është një komponent i veçantë i Sistemit të Licencimit të Mësimdhënësve, i cili është vendosur si instrument i llogaridhënies e i motivimit dhe si mekanizëm për zhvillim të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve. Funksionaliteti dhe qëndrueshmëria e këtij sistemi është sfiduar në masë të madhe për shkak të moszbatimit të plotë të këtij sistemi. Për më shumë, ky sistem ka ndikim të madh edhe në qëndrueshmërinë e zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë është pjesë integrale e planifikimeve strategjike të MASHT-it, pjesë e dokumenteve të tjera strategjike dhe pjesë e planifikimit zhvillimor në nivel komune e shkolle. Të gjitha masat e ndërmarra për të ndërlidhur planifikimet janë realizuar me qëllim të adresimit në mënyrë të duhur të zhvillimit profesional të mësimdhënësve në nivel qendror, në nivel lokal dhe në nivel shkolle. Megjithatë, ekziston nevoja për të analizuar progresin e arritur me plane strategjike, sfidat dhe mangësitë. Modeli ekzistues i zhvillimit profesional të mësimdhënësve në Kosovë është i bazuar kryesisht në programet e trajnimit që ofrohen nga institucione dhe ofertues të ndryshëm, të cilët përzgjidhen në bazë të kriterëve të përcaktuara nga MASHT-i. Programet e trajnimit për mësimdhënës përbëjnë një përpjekje për të plotësuar nevojat praktike të mësimdhënësve për zhvillim profesional dhe për zbatim të reformës kurrikulare. Ato prezantohen në *Katalogun* që publikohet nga MASHT-i dhe shpeshherë janë pjesë e debateve institucionale për mbulueshmërinë e kërkesave dhe nevojave të mësimdhënësve dhe për nevojat e prioritizimit.⁷²

⁷² Selim Mehmeti, Ema Rraci, Kushtrim Bajrami, Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë, 2009, Prishtinë.

4. Sa mendoni që është e nevojshme përfshirja e mësuesve mbështetës në klasat ku ka të përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta?



Grafiku 4.

Punën me fëmijë me nevoja të veçanta padyshim se e lehtëson shumë bashkëpunimi i mësimeve me mësues udhëtues që punojnë në qendra burimore, mirëpo dalin edhe për punë në terren, gjegjësisht në shkollë. Në pyetjen që u është shtruar mësimeve lidhur me rëndësinë e përfshirjes apo mbështetjes së tyre nga mësuesit udhëtues, mbi 92% e tyre thonë se është mjaft e rëndësishme, 5% pak dhe 3% aspak. Pra shihet qartë se mësimeve kanë nevojë për ndihmën e mësuesve mbështetës.

Mësuesit udhëtues janë profesionistë që ofrojnë mbështetje për mësimeve dhe puna e tyre kryesisht fokusohet jashtë qendrave burimore, mirëpo ata japin kontribut edhe brenda tyre atëherë kur është e nevojshme.

Në Kosovë ekzistojnë këto qendra burimore:

1. “Përparimi” – Prishtinë (Dëmtime intelektuale)
2. “Nëna Terezë” – Mitrovicë (Dëmtime intelektuale)
3. “Lef Nosi” – Prizren (Dëmtime intelektuale)
4. “Xheladin Deda” – Pejë (Dëmtime në shikim)

5. “Nëna Terezë” – Prizren (Dëmtime në dëgjim)

“Mësuesit udhëtues kanë rol shumëdimensional dhe, përveç mbështetjes specifike për nxënës me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në mësim, ata mbulojnë edhe fushat e tjera që lidhen me promovimin e arsimit gjithëpërfshirës, si:

- Identifikimin e nevojave për mbështetje të fëmijët me nevoja të veçanta në shkollë;
- Vlerësimin e nevojave për mbështetje pedagogjike;
- Përkrahin procesin e tranzicionit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore nga qendrat burimore në shkollat e rregullta;
- Këshillimin e mësimeve, shërbimeve pedagogjike dhe drejtorëve;
- Dhënie të këshillave lidhur me pajisjet dhe materialet e nevojshme për nxënësit;
- Hartimin, shkrimin dhe rishikimin e planit individual të arsimit (PIA) në bashkëpunim me mësimeve dhe prindërit;
- Modifikimin e përmbajtjes së kurrikulës, strategjive të mësimeve, materialeve dhe vlerësimi në bazë të nevojave individuale të nxënësve;
- Intervenimin dhe përgatitjen e planeve mësimeve;
- Realizimin e punës individuale me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (sipas nevojës – mësim shtesë në qendrën burimore);
- Mbajnë trajnime për mësimeve të qendrës burimore sipas kërkesave dhe nevojave mësimeve;
- Ndihmojnë mësimeve të qendrës në kuptimin dhe zbatimin e aftësive sipas fushave të aktiviteteve mësimeve;
- Bëjnë monitorimin e përparimit të arritjeve të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;
- Ofrojnë rekomandime dhe sugjerime për të krijuar materiale të duhura didaktike dhe alternative;
- Modifikojnë materialet në sistemin Brail;
- Bëjnë identifikimin e nevojave për mbështetje të stafit mësimeve në shkollë;
- Bashkëpunojnë me DKA-të e OJQ-të;


- Bashkëpunojnë me ekipet në qendrën burimore;
- Bashkëpunojnë me rrjetin e mësuesve udhëtues;
- Krijojnë bazë të të dhënave për procesin e mbështetjes.”⁷³

Në një hulumtim të realizuar nga Instituti Pedagogjik i Kosovës lidhur me rëndësinë e mësuesve udhëtues dhe rëndësinë së tyre, si përfundim del se “mësimdhënësit udhëtues janë në numër shumë të vogël për t’i mbuluar nevojat për mbështetje të të gjithë fëmijëve, 68 të identifikuar. Po ashtu, ata deklarohen se i kanë mundësitë e kufizuara për realizimin e detyrave të tyre në terren si pasojë e mospërmbushjes së obligimeve teknike dhe financiare ndaj nevojave të tyre për udhëtimet në terren. Mungesa e planifikimit të përbashkët bazuar në nevojat dhe llojin e mbështetjes, ka krijuar pakënaqësi te mësimdhënësit përfshirës dhe prindërit e nxënësve të përfshirë. Shumica e tyre deklarohen të pakënaqur me mbështetjen nga mësimdhënësi udhëtues, madje rreth gjysma e të anketuarve shprehen se nuk kanë kurrfarë mbështetje nga mësimdhënësit udhëtues. Ndërsa pjesa tjetër që deklarohen se marrin ndonjë mbështetje kanë cekur kryesisht mbështetjen me materiale mësimore apo edhe hartim të PIA-s. Ndërsa, për detyrat e tjera të caktuara për mësimdhënësit udhëtues, si: koordinim të bashkëpunimit, organizim të trajnimeve, mbështetje në orët mësimore, këshillime, nuk e potencojnë as mësimdhënësit përfshirës, por as prindërit.”⁷⁴

⁷³ Divizioni për Arsim me Nevoja të Veçanta në MASHT (2017), Udhëzues për punën e mësuesit udhëtues, Prishtinë, 2017, fq. 8-9.

⁷⁴ Sahare Reçica, Raport hulumtimi, Mbështetja e qendrave burimore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla të rregullta, IPK, Prishtinë, 2013.

5. A keni në klasë mësues mbështetës dhe, nëse po, sa e konsideroni të domosdoshme prezencën e tyre në klasën tuaj ?



Grafiku 5.

25% e mësimehënësve e konsiderojnë si shumë të nevojshme prezencën e mësuesit mbështetës në klasë, pak dhe deri diku janë 5% dhe 70% e tyre nuk kanë farë mësues mbështetës.

Kur flasim për mënyrën e funksionimit të sistemit të arsimit për fëmijët me nevoja të veçanta në Kosovë, mund të themi se kemi të bëjmë me një sistem arsimor të segreguar që funksionon në dy sisteme. Njëri me anë të qendrave burimore dhe tjetri me klasa të bashkuara brenda shkollave të rregullta në të cilat mësojnë fëmijët me nevoja të veçanta dhe janë në njëfarë forme të izoluar nga fëmijët e tjerë. Sipas një studimi të IPK-së, si konkludim ka dalë se klasat e bashkuara në Kosovë janë shumë segreguese. Kështu, pas këtij raporti dhe analizës në terren, MASHT-i nuk ka hapur më klasa të bashkuara nëpër shkolla. Që nga ajo kohë MASHT-i ka punuar që këto klasa të shuhen fare dhe fëmijët me nevoja të veçanta të përfshihen në klasa të rregullta.

MASHT-i ka bërë përpjekje që klasat që kanë fëmijë të tillë të marrin mbështetje nga mësuesit mbështetës. Mësuesit mbështetës nuk do ta kenë rolin e pedagogut a të psikologut,

duke qëndruar në zyrë dhe duke shërbyer si këshillëdhënës. Por puna e tyre do të jetë brenda një shkolle dhe ata do të lëvizin në klasat ku ka fëmijë me nevoja të veçanta.

Deri më tani kemi të punësuar vetëm 4 mësues mbështetës në tri komuna të ndryshme të Kosovës. Këta mësime dhënë janë të punësuar nga MASHT-i, mirëpo u japin llogari drejtorëve të shkollave.⁷⁵



Grafiku 6.

47% e mësime dhënëve thonë se nuk kanë asnjë lloj mbështetje nga ana e profesionistëve, 24% thonë se kanë deri diku dhe po aq thonë se kanë pak mbështetje, vetëm 4% thonë se kanë shumë mbështetje dhe vetëm 1% thonë se kanë jashtëzakonisht mbështetje.

Sot jemi dëshmitarë se shkollat tona rrallë ose fare kanë pedagogë e disa nga to kanë vetëm psikologë ose fare.

Shpeshherë psikologët janë burimi i vetëm për mbështetjen e këtyre mësime dhënëve. Nga ta mësime dhënësit marrin këshilla lidhur me nxënësit me nevoja të veçanta që kanë në klasat e

⁷⁵ Departamenti i Arsimit Parauniversitar, Njësia e Arsimit Special.

tyre. Edhe pse në të kaluarën, kur tashmë kishte filluar që psikologët të sistemoheshin nëpër shkolla, një gjë e tillë është paragjykuar mjaft shumë, sot kur kemi edhe një ndryshim të mendësisë së shoqërisë, psikologët shihem me një sy pozitiv dhe konsiderohen si mjaft dobiprurës në shkolla dhe në ambiente të tjera të punës.

Një nga detyrat e psikologëve të shkollave është edhe përkrahja e gjithëpërfshirjes dhe, po ashtu, në rast nevojë, rekomandimi i ndonjë programi të veçantë për edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Në Kosovë ka mungesë të psikologëve në shkollë, edhe pse ka shumë sish të diplomuar që bredhin rrugëve dhe janë të papunë apo punojnë diçka krejt jashtë profesionit të tyre. Specialistë të ndryshëm e vlerësojnë si tepër të rëndësishme dhe njëherësh të domosdoshme përfshirjen e psikologëve në shkolla. Në anën tjetër, zyrtarët e MASHT-it thonë se një gjë e tillë është e pamundur për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm.

Lidhur me këtë çështje, në vitin 2019, Alush Istogu, drejtor i Departamentit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, ka thënë se numri i psikologëve të punësuar nëpër shkollat e Kosovës, që është rreth 80 sish, është më se i pamjaftueshëm. Por, ai ka theksuar se punësimi i psikologëve të rinj është i pamundur tash për tash, për shkak të mungesës së buxhetit.⁷⁶

⁷⁶ <https://www.evropaelire.org/a/28018660.html>

7. Nga cilët specialistë do ta vlerësonit më të nevojshme mbështetjen?




Grafiku 7.

Të pyetur se ndihma e cilit nga ekspertët e lartcekur është më e rëndësishme për ta, 81% e mësimdhënësve deklarohen se janë psikologët e zhvillimit, 2% mjekët, 6% punëtorët socialë, 4% logopedët dhe 7% vlerësuan se ndihmë mund t'u japin të tjerë ekspertë që nuk i kemi përmendur fare në pyetësorë.

Arsyeja pse 81 % e mësimdhënësve e vlerësojnë si më me vlerë ndihmën e ofruar nga psikologët është për faktin se për shumicën e tyre mund të jetë ndihma e vetme e ofruar, sepse jo të gjithë kanë pasur mundësi të marrin ndihmë nga ekspertë të tjerë, gjegjësisht specialistë të fushave të caktuara, siç është p.sh. logopedi, sepse rrallë ose fare kemi logopedë apo shërbime të tyre që ofrohen nëpër shkolla. Numri i logopedëve është relativisht i vogël dhe edhe ata që janë kryesisht punojnë nëpër ordianca private dhe shërbimet e tyre janë mjaft të kushtueshme sa që shumë prindër nuk mund t'i përballojnë.


8. Cilin do e konsideronit si motiv apo inkurajim që do të kishit më shumë nevojë për të punuar me FNV?



Grafiku 8.

Ekziston një varg gjërash që një mësuesdhënësi mund ta motivojë në punën e tij. Një motivim i veçantë u duhet mësuesdhënësit që pavarësisht nga mungesa e kushteve, të marrin mbështetje për të punuar me këta fëmijë. Të pyetur se çka do t'i motivonte më shumë në punën e tyre me këta fëmijë në klasë, 72% e tyre thonë se do t'i motivonte prezenca e mësuesve mbështetës në klasë, gjegjësisht e asistentëve për këta fëmijë, 16% e të anketuarve thonë se do t'i motivonte numri më i vogël i nxënësve në klasë, 5% pagesa shtesë, 1% numri i reduktuar i orëve mësimore dhe 6% asnjëra nga këto.

9. Si janë raportet e FNV-ve me nxënësit e tjerë të shkollës?



Grafiku 9.

Pritja dhe krijimi i mirë i atmosferës në klasë nga nxënësit e tjerë për nxënësit me nevoja të veçanta ka një rëndësi mjaft të madhe që ata të ndihen mirë. Nga puna me nxënës jemi dëshmitarë që nxënësit me nevoja të veçanta mirëpreiten shumë nga nxënësit e tjerë dhe, megjithëse janë të vegjël, ata mundohen të ndihmojnë, madje shpeshherë mikpritjen më të madhe ata e gjejnë nga të vegjlit sesa nga vetë mësuesit e asaj klase. 74% e mësuesve deklarohen se raportet e fëmijëve janë të mira, 20% shumë të mira dhe 6% aspak të mira.

Padyshim që në krijimin e mirë të raporteve rol kyç kanë vetë mësuesit. Këtë gjë e pohojnë edhe hulumtime të ndryshme të bëra në mbarë botën, sidomos të bëra në vende që janë ballafaquar shumë më herët se ne me procesin e gjithëpërfshirjes.

Sipas një studimi, mësuesit inkurajohen të ndihmojnë studentët që të zhvillojnë marrëdhënie bashkëpunimi. Dhe hulumtimet që ekzaminojnë qëndrimet e studentëve ndaj bashkëmoshatarëve të tyre me aftësi të kufizuara kanë sugjeruar që kontakti me studentët me aftësi të kufizuara mund të çojë në qëndrime pozitive. Në fakt, Lieberman et al. (2004) vuri në dukje se kontakti pozitiv me studentët me aftësi të kufizuara është mënyra e vetme


efektive për të ndihmuar studentët që të fitojnë një kuptim dhe njohuri për studentët me aftësi të kufizuara. Prandaj, bashkëveprimi i studentëve duket një qëllim i rëndësishëm, kurse aktivitetet e strukturuar janë rekomanduar në lidhje me ndihmën e studentëve që të zhvillojnë aftësi për të bashkëpunuar me sukses me njëri-tjetrin. Një numër i sugjerimeve specifike janë dhënë në literaturë. Salisbury, Galluçi, Palombaro dhe Peck (1995) kanë dhënë rekomandime për promovimin e bashkëveprimeve shoqërore midis studentëve me dhe pa aftësi të kufizuara. Në listën e tyre ishin përfshirë grupe mësimore bashkëpunuese në të cilat, sipas tyre, mund të sigurohen përfitime sociale dhe akademike për studentët me aftësi të kufizuara. Për më tepër, ata sugjeruan që mësuesit të angazhojnë studentët në zgjidhjen e problemeve bashkëpunuese (p.sh., përmes takimeve të rregullta në klasë) në mënyrë që t'u sigurojnë studentëve një zë për shqetësimet që lidhen me studentët me aftësi të kufizuara dhe t'i ndihmojnë ata për të zhvilluar mirëkuptim ose empati.

Përveçqë janë në gjendje të bashkëveprojnë në mënyrë bashkëpunuese me njëri-tjetrin, studentët përfitojnë nga vlerësimi i diversitetit në përgjithësi. Heinrichs (2003) sugjeron që shkollat mund të ndihmojnë studentët të zhvillojnë tolerancën dhe respektimin e dallimeve, duke mësuar empati dhe aftësi të menaxhimit të zemërimit dhe duke promovuar respekt për të tjerët përmes kurrikulës së përgjithshme. Larmia e programeve të edukimit të personazheve në dispozicion mund të përdoret si një themel nga i cili mund të përfshihen diskutime dhe aktivitete specifike për studentët me aftësi të kufizuara.

Këshilltarët e shkollës mund të promovojnë agjendat e ngjashme (d.m.th. diversiteti dhe bashkëpunimi) përmes aktiviteteve të shërbimit të drejtpërdrejtë me studentët. Të dyja aktivitetet udhëzuese në grupe dhe në klasë mund të jenë të dizajnuara për të promovuar respektimin e dallimeve dhe bashkëveprimin midis studentëve me dhe pa aftësi të kufizuara. Për më tepër, këshilltarët e shkollës mund të shërbejnë si koordinatorë të programeve të mësimdhënies me kolegë dhe të bashkëpunojnë me mësuesit në zbatimin e aktiviteteve të bazuara në klasë.⁷⁷

⁷⁷ <https://www.readingrockets.org/article/creating-positive-school-experiences-students-disabilities>

10. A keni njohuri për PIA-n (Planin individual të arsimit)?



Grafiku 10.


PIA (Plani individual i arsimit) është dokument pedagogjik që hartohet për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. PIA hartohet për nxënësit që janë vlerësuar nga një ekip ekspertësh apo nga ekiye ekspertësh brenda shkollave se ai fëmijë vërtet ka nevojë për plan individual të punës.

Plani individual i arsimit hartohet në bashkëpunim në mes të shkollës, prindërve dhe fëmijëve, si dhe mësuesve mbështetës. Ky plan është konfidencial dhe informacionet rreth tij mund të jepen vetëm më pëlqimin e prindit. Ky plan ka për qëllim që të përshtatë kurrikulën me mundësitë intelektuale të nxënësit dhe me anë të tij përcillet në vazhdimësi përparimi i nxënësit.

Të pyetur se sa kanë njohuri mësuesit për PIA-n, ata deklarohen se 89% e tyre kanë njohuri, ndërsa 11% thonë se nuk kanë njohuri për mënyrën sesi planifikohet në bazë të këtij plani.

Lidhur me PIA-n, MASHT-i në vitin 2017 ka hartuar një Udhëzues për hartimin e PIA-s për nxënësit me nevoja të veçanta.


“Një plan individual i arsimit duhet rishikuar së paku dy herë në vit dhe në çdo rast tranzicioni (ku përfshihet ndërrimi i shkollës apo çdo ndryshim tjetër në arsimimin e fëmijës, për shembull: ndërrimi i nivelit, i klasës, i shkollës, i komunës etj.). Procesi i rishikimit kërkon pjesëmarrjen e personelit përkatës, që punon me fëmijën dhe çdo rezultat i vërejtur duhet të raportohet te prindi / kujdestari i fëmijës. Rishikimi i planit individual mund të mos kërkojë rishikimin e qëllimit të tij, por varësisht nga rezultatet e prezantuara mund të rishikohen rezultatet e të nxënës dhe të riformulohen rezultatet e pritshme për pjesën e mbetur të planit. Kush duhet ta plotësojë planin individual të arsimit? Plotësimi i planit individual të arsimit është përgjegjësi e edukatorit / mësuesit, i cili në grupin / klasën e tij ka fëmijën, në bashkëpunim të ngushtë me prindërit. Drejtori duhet të jetë i informuar për procesin. Një kopje të PIA-s duhet ta ketë prindi / kujdestari i fëmijës dhe një kopje të jetë pjesë e dosjes së nxënësit.”⁷⁸



Grafiku 11.

⁷⁸ MASHT, Plani individual i arsimit (PIA) dhe Udhëzuesi për hartimin e planit individual të arsimit për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, 2017.


Të pyetur rreth vështirësisë së hartimit të planit individual arsimor, mësimehmënit deklarohen në këtë mënyrë: 19% thonë se kanë pasur vështirësi, 32% pjesërisht dhe 49% e tyre nuk kanë pasur vështirësi gjatë hartimit të PIA-s.



Grafiku 12.

Përfshirja e prindit në hartimin e planit individual luan një rol mjaft të madh, sepse askush më mirë se ai nuk i njeh aftësitë dhe kapacitetin e fëmijës së tij/saj. Bashkëpunimi me ta është jo vetëm i nevojshëm, por më se i domosdoshëm. Shpeshherë nga praktika mund të hasim prindër që vështirë e pranojnë gjendjen e fëmijës së tij/saj dhe, si pasojë, edhe mund ta neglizhojnë procesin e bashkëpunimit apo thjesht në këtë mënyrë, duke mos bashkëpunuar, ta vështirësojnë atë.

13. A keni ambient të përshtatshëm në shkollë për sigurimin e lëvizjes pa barriera të FNV-ve?



Grafiku 13.

Të pyetur se nëse shkollat kanë ambient fizik për lëvizjen e nxënësve pa ndonjë pengesë, (kjo vlen për nxënësit që kanë vështirësi në lëvizje apo që përdorin karrocë për lëvizje), mësimdhënësit deklarojnë se 60% e tyre kanë vështirësi për shkak të terrenit të papërshtatshëm për lëvizje të lirë dhe pa pengesa, ndërsa 40% deklarojnë se nuk kanë vështirësi.

Një hulumtim i realizuar në komunën e Prizrenit në vitin 2017 nxjerr në pah shumë të meta të sistemit arsimor sa i përket qasshmërisë, gjë që e vështirëson në masë të madhe vijimin e shkollës nga nxënësit me nevoja të veçanta.

Sipas këtij hulumtimi, vështirësitë janë kategorizuar në dy grupe: ato që e pengojnë një nxënës në karrocë nga shtëpia në shkollë dhe pengesat brenda objektit shkollor.

PENGESAT JASHTË OBJEKTIT TË SHKOLLËS

- objektet shkollore në distanca të largëta nga vendbanimet e PAK;
- mungesë e transportit të organizuar për PAK deri në objektet shkollore dhe anasjelltas;
- rrugë të pakaluar nga PAK;

- trotuare me pengesa;
- mungesë e ndriçimit publik;
- oborri i shkollës me pengesë në qasje;
- pllakëzim i dëmtuar dhe i panivelizuar në oborrin e shkollës.


PENGESAT NË OBJEKTIN E SHKOLLËS

- mungesë e pjerrinave;
- mungesë e pllakave taktore;
- mungesë shenjëzimi;
 - mungesë e mbajtësve;
- mungesë e ulëseve për pushim;
- mungesë e pjerrinave për qasje në shkollë;
- mungesë e klasave të qasshme për PAK;
- mungesë e pllakave taktore në shkollë;
- mungesë e ashensorëve;
- mungesë e mobiliarit të përshtatshëm për nevoja të PAK;
- mungesë e tualeteve të qasshme për PAK;
- mungesë e asistencës mjekësore;
- mungesë e kthinave për stafin shtesë profesional (punëtorët socialë, mjeku etj.).⁷⁹

Pra, duhet të punohet shumë që në shkollat e vjetra, të ndërtuara vite më parë, ku mungojnë pjerrinat dhe kushtet elementare për këtë kategori nxënësish, të intervenohet sa më parë në mënyrë që t'u jepet mundësia edhe nxënësve në karrocë, si edhe çdo nxënësi tjetër me këso lloj vështirësish, që të mos mbeten pa shkollim për shkak të kushteve infrastrukturore. Kjo është një përgjegjësi e MASHT-it që duhet ta trajtojë me prioritet.

⁷⁹ Shkolla për të Gjithë, Raport i vizionimit të punëtorisë për objektin shkollor dhe rehabilitues për personat me aftësi të kufizuara, 2017.

14. A ju siguron shkolla materiale didaktike në përputhje me nevojat dhe kërkesat për të punuar me FNV?




Grafiku 14.

Jemi dëshmitarë të asaj se shkollat në Kosovë kanë buxhet të centralizuar dhe, si pasojë e kësaj, shpeshherë ato e kanë të pamundur që të realizojnë qëllimet e tyre specifike. Për shkak të mungesës së buxhetit dhe procedurave të shumta deri në aprovimin e kërkesave për materiale didaktike, shpeshherë mësimitdhënësit duhet vetë të gjejnë mënyra për të siguruar materiale didaktike për nxënësit e tyre.

Njëjtë ndodh edhe me mësimitdhënësit që në klasat e tyre kanë fëmijë me nevoja të veçanta. Ata rrallë ose fare marrin mbështetje nga shkolla apo komuna sa u përket materialeve shtesë, të cilat do ta bënin orën më atraktive për një nxënës më vështirësi në të nxënë si dhe do ta lehtësonin punën e mësimitdhënësit me të.

Të pyetur se sa ndihmohen nga shkolla me materiale didaktike për fëmijët me nevoja të veçanta, 75% e tyre deklarojnë se nuk ndihmohen fare dhe 25% e tyre thonë se ndihmohen.

15. Çfarë do të sugjeronit në drejtim të përshtatshmërisë së mjeteve? (Mund të shënoni më shumë se një alternativë).




Grafiku 15.

Të pyetur rreth llojit të materialeve që ata do të sugjeronin për të pasur në punën e tyre, morëm këto përgjigje: 89% e mësimdhënësve thonë se do të sugjeronin tekste të përshtatura me nevojat e nxënësve me vështirësi në zhvillim, 5% e tyre tekste me alfabet Brail dhe 6% e tyre sugjerojnë që të ketë përkthyes të gjuhës së shenjave.

Në Kosovë fare pak ose hiç ka tekste të standardizuara për fëmijët me nevoja të veçanta. Vitin e fundit me disa klasa është filluar ndryshimi i teksteve shkollore, gjë që mund të konsiderohet si lëvizje pozitive, pasi pritet që brenda tyre të gjejnë veten edhe fëmijët me nevoja të veçanta. Edhe pse punojnë me PIA me nxënës me nevoja të veçanta, mësimdhënësit nuk kanë tekste të përshtatshme, por obligohen të krijojnë vetë materiale për të përmbushur nevojat e tyre dhe për të arritur objektivat e parapara në plan individual.

16. A mendoni se FNV-të duhet të vijnë në mësimin në shkollë të zakonshme?



Grafiku 16.

Të pyetur nëse mësimdhënësit janë të pajtimit që nxënësit me nevoja të veçanta të përfshihen në klasa të rregullta, 72% e tyre përgjigjen se janë kundër kësaj dukurie dhe 28 % pohojnë se janë pro këtij vendimi të MASHT-it.

Ekzistojnë një sërë dokumentesh që e mbështesin dhe sigurojnë një arsim gjithëpërfshirës dhe për këtë çështje nuk është marrë mendimi i mësimdhënëseve, andaj ka rezultuar e madhe përqindja e atyre që thonë se nuk janë të kënaqur me përfshirjen e këtyre fëmijëve në klasa të rregullta. Në vijim po listojmë disa nga dokumentet që sigurojnë arsim gjithëpërfshirës:

- Ligji mbi arsimin parauniversitar (2011);
- Korniza e kurrikulumit të Kosovës (KKK);
- Standardet për edukimin parashkollor;
- Standardet për shkollat mikse për fëmijë;
- Plani strategjik për arsimin e Kosovës 2011 – 2016 (PSAK);
- Plani individual i arsimit (PIA).⁸⁰

⁸⁰ Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, Arsimi gjithëpërfshirës, shkurt 2014, fq. 3.

6. Rezultatet e dala nga pyetësorët e realizuar me studentët e Fakultetit të Edukimit

Universiteti i Prishtinës, gjegjësisht Fakulteti i Edukimit ka për qëllim të aftësojë studentët në fushë të mësimdhënies dhe të bëjë promovimin, organizimin, evaluimin dhe realizimin e kurrikulumit arsimor në mënyrë efektive të nxënësit, prindërit dhe anëtarët e tjerë të shoqërisë. E mira e këtij fakulteti është se ka edhe komponentin e praktikës mësimore qysh nga viti i dytë i studimeve, gjë që u mundëson studentëve të familjarizohen me shkollat, me nxënësit dhe me stafin. Pra, mësimi praktik i prin punësimit të tyre si mësimdhënës.

Studentët e Fakultetit të Edukimit, që përgatiten për të qenë mësimdhënës të ardhshëm, ballafaqohen me probleme e sfida të natyrave të ndryshme, ndër të cilat është edhe ballafaqimi me nxënësit. Shkolla mbetet kontakti i parë ku ata ndeshen me fëmijët me nevoja të veçanta.

Lidhur më atë se sa kanë njohuri për këta fëmijë, sa përgatiten në universitet që nesër të jenë të pavarur në punën e tyre, që të dinë t'u qasen edhe fëmijëve me nevoja të veçanta, do të shohim në përgjigjet në vijim.



Grafiku 17.

Të pyetur se sa kanë informacion apo njohuri për fëmijët me nevoja të veçanta, 74% e tyre janë deklaruar se janë të informuar, 26% e tyre janë pak të informuar dhe nuk ka pasur fare nga ata që kanë qenë të painformuar.


Pra, mund ta shohim se, kush më shumë e kush më pak, studentët kanë informacione për këta fëmijë, gjë që është e rëndësishme për punën e tyre të ardhshme si mësime.



Grafiku 18.

Pasi kemi marrë mendimin e studentëve se a janë të informuar për fëmijët me nevoja të veçanta, jemi ndalur te një pyetje tjetër se nga ku janë informuar ata dhe me këtë rast kemi marrë këto përgjigje: 53% e tyre janë informuar gjatë studimeve, 16% nga mjetet e informimit, 26% gjatë praktikës në shkollë dhe 5% në forma të tjera.


19. Sa mendoni që vijimi i studimeve në universitetin tuaj ofron njohuri të mjaftueshme që nesër ju të jeni një kontribuues aktiv në arsimin gjithëpërfshirës?



Grafiku 19.

Në pyetjen e shtruar se sa mendoni që universiteti ju ofron njohuri të mjaftueshme apo ju aftëson që të jeni nesër mësues efektivë dhe të përgatitur, që në klasat e tua të ketë fëmijë me nevoja të veçanta, vetëm 6% deklarojnë se universiteti u ofron njohuri të bollshme, 68% deklarohen mesatarisht, 16% e tyre pak dhe nuk ka fare nga ata që deklarohen se nuk marrin aspak njohuri.


20. Sa mendoni që do të jetë sfiduese për një nxënës të kësaj kategorie nëse mësimitdhënësi i tij është i papërgatitur për qasje ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta?



Grafiku 20.

Në pyetjen se sa do të jetë sfiduese për një mësimitdhënësinë puna me fëmijë me nevoja të veçanta, nëse ai paraprakisht nuk ka njohuri të mjaftueshme për këtë kategori fëmijësh, 100% e të intervistuarve thonë se do të jetë shumë e vështirë. Nuk pati nga ata që qarkuan opsionet pak ose aspak.


21. Përveç mësimit praktik që keni mbajtur në shkollë, a keni vizituar ndonjë institucion tjetër ku ka të përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta?



Grafiku 21.

Të pyetur nëse studentët kanë pasur mundësi që të vizitojnë institucione ku bëhet punë me këta fëmijë, përjashtuar shkollat gjatë mësimit praktik, 32% e tyre thonë se kanë vizituar edhe institucione të tjera, ndërsa 68% jo. Kjo i bie që për këtë grup studentësh mësimi praktik në shkollë ka qenë kontakti i parë i tyre me fëmijët me nevoja të veçanta në rolin e mësimeve.

22. A mendoni se FNV-të duhet të vijojnë mësimin në shkolla të zakonshme?



Grafiku 22.

Të pyetur se a mendoni që nxënësit me nevoja të veçanta duhet të vazhdojnë mësimin në klasa të rregullta, 68% e tyre shprehen po, kurse 32% e tyre thonë se kjo kategori nuk duhet t'i ndjekë mësimet në klasa të rregullta.

7. Analiza e të dhënave nga pyetësi me nxënës të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian

Pyetësi është realizuar me rreth 100 nxënës të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. Pyetësi është realizuar në qendrat ku janë të përqendruar pjesëtarët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian.


Në vijim përgjigjet në pyetjet e shtuara do t'i paraqesim në formë grafikësh dhe më përqindje për secilën përgjigje të dhënë.

Pyetja 1. Sa është numri i nxënësve në klasën tuaj?

- Mesatarja e nxënësve në klasat ku është realizuar hulumtimi ka dalë të jetë 25 – 30 nxënës brenda një klase.

Pyetja 2. Çfarë janë raportet tuaja me shokët dhe shoqet e klasës?

- a. *Të mira*
- b. *Shumë të mira*
- c. *Aspak të mira*



Grafiku 23.


Pyetja është shtruar me qëllim që të shihet se sa janë të mirëpritur këta nxënës në klasa me shumicë shqiptare dhe se cilat janë raportet e tyre me nxënësit shumicë.

Rreth 67% e nxënësve të intervistuar janë deklaruar se kanë raporte të mira me shokët dhe shoqet e klasës, 33% e tyre kanë raporte shumë të mira dhe asnjë nxënës nuk është deklaruar se ka raporte jo të mira me shokët dhe shoqet e klasës.

Sa u përket raporteve, shihet se kemi raportet të mira mes nxënësish, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike. Mirëpo gjithmonë duhet të synohet që të krijohen mekanizma që nxënësit pa dallim të bashkëpunojnë mes vete dhe të krijojnë raporte të shëndosha, element që do të rriste dëshirën e nxënësve nga komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian për pjesëmarrje të rregullt në shkollë. Të konsideruarit të barabartë ka një rëndësi mjaft të madhe, me qëllim që asnjë nxënës të mos ndihet inferior në situata të caktuara, por të ndihet i barabartë me moshatarët e tij/saj në klasë.

Pyetja 3. Në cilën bankë uleni?

- a. *Në fillim*
- b. *Në mes*
- c. *Në fund*
- d. *Ndërrojmë vendet*



Grafiku 24.


Kjo pyetje është bërë me qëllim që të kuptojmë vendndodhjen e këtyre nxënësve brenda klasës. Nga praktika dimë se këta fëmijë pothuajse gjithmonë i kemi hasur të ulur në bankën e fundit me ndonjë pjesëtar nga radhët e minoriteteve dhe këtë shpeshherë mësuesja e ka bërë se prindërit i kanë kërkuar një gjë të tillë. Pra, prindërit nga radhët e komunitetit shumicë, në rastin tonë shqiptarë, kanë kërkuar që fëmija i tyre të mos ulet në bankë me një fëmijë nga radhët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian.

Përgjigjet e nxënësve janë pak a shumë ato të pritshme. Vetëm 15% e nxënësve të intervistuar janë deklaruar se ulen në fillim të klasës, 32% në mes, 40% në fund dhe 13% e tyre janë deklaruar se i ndërrojnë vendet. Rezultatet e kësaj pyetjeje kanë qenë pak a shumë të pritshme dhe vërtet është për t'u diskutuar e për t'u punuar në drejtim të përmirësimit të atmosferës në klasë. Mësimdhënësi është përgjegjës për mënyrën se si ulen nxënësit në klasë dhe ai duhet të gjejë mënyrën që nxënësit e komunitetit RAE të mos përfundojnë gjithmonë të ulur në bankën e fundit, pa iu dhënë mundësia që t'i provojnë edhe pozicionet e tjera brenda klasës. Këtu duhet të synohet që të rritet përqindja e nxënësve që sipas ndonjë rregulli të caktuar nga mësimdhënësi kujdestar t'i ndërrojnë vendet kohë pas kohe. Një gjë e tillë do të ndikonte shumë më mirë në socializmin e vet nxënësve brenda klasës dhe do të rriste vetëbesimin e nxënësve nga radhët e pakicave. Është vërtet alarmante shifra prej 40% e nxënësve të intervistuar që gjithmonë kanë përfunduar në bankën e fundit. Këtu shihet qartë se mungon qasja e barabartë e vetë mësimdhënësve kujdestarë.

Pyetja 4. A uleni gjithmonë me shokun apo shoqen e njëjtë?

a. *Po*

b. *Jo*




Grafiku 25.

Kjo pyetje është vazhdimësi e pyetjes paraprake me të cilën është synuar të vihet në pah nëse janë të njëjtit nxënës që gjithmonë ulen në bankat e fundit apo në mesin e tyre herë pas here vjen ndonjë nxënës tjetër.

Nga rezultatet e pyetësorit vërejmë se 43% e nxënësve ulen gjithmonë me shokun apo shoqen e njëjtë dhe 57% e tyre ndërrojnë herë pas here vendet. Afërsisht është përqindje e njëjtë e atyre që deklaruan se ulen në bankën e fundit, gjë që i bie se janë po të njëjtit që gjithmonë ulen në bankën e fundit. Ky fenomen duket të jetë shqetësues për faktin se këta nxënës krijojnë raporte të mira vetëm me njëri-tjetrin, sepse mësuesit apo mësimezhënësit kujdestarë nuk e marrin për bazë këtë element mjaft të rëndësishëm. Si pasojë e kësaj, socializmi i fëmijëve nga radhët e minoriteteve dhe atyre shumicë ka mjaft vështirësi dhe shpeshherë është i patejkalueshëm. Përgjegjësia për këtë fenomen bie direkt mbi mësuesin, prindin dhe udhëheqësinë e shkollës, e cila duhet të monitorojë herë pas here klasat me nxënës pakicë dhe të shohë nëse pozicioni i tyre është i duhuri.

Pyetja 5. Sa keni mbështetje apo ndihmë rreth detyrave të shtëpisë?

- a. Shumë
- b. Deri diku
- c. Pak
- d. Aspak



Grafiku 26.


Nga hulumtime të ndryshme të OJQ-ve dhe institucioneve tona, shumë shpesh është dëshmuar se nxënësit e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian shpeshherë vijnë pa detyra të shtëpisë, për shkak se në shtëpi nuk mund ta gjejnë mbështetjen e nevojshme. Pak a shumë secili prej nesh mund ta dimë shkakun e këtij fenomeni që ndodh pikërisht se përgatitja shkollore dhe profesionale e prindërve të tyre lë shumë për të dëshiruar. Përqindje shumë e madhe e prindërve nuk kanë shkollim, gjë që e vështirëson punën e në raste të caktuara pamundëson që një fëmijë të gjejë mbështetje nga prindërit.

Në pyetjen e shtruar se sa gjeni mbështetje për detyrat e shtëpisë, 39% deklarohen se kanë shumë mbështetje, 28% deri diku, 23% pak dhe 10% aspak. Duke e parë këtë problematikë në radhët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, disa OJQ vendore dhe të huaja

që merren me minoritetet në Kosovë kanë hartuar një program për sajimin e disa qendrave ndihmëse brenda shkollave. Këto qendra ofrojnë mbështetje për nxënësit minoritarë në kryerjen e detyrave të shtëpisë. Këto qendra kanë një mësimpldhënës që përkujdeset për t'i përfshirë të gjithë nxënësit nga radhët e minoriteteve ekzistuese brenda një shkolle. Pas mësimit nxënësit shkojnë në qendra, ku edhe kanë një shujtë ditore dhe aty ndihmohen nga mësimpldhënësit tutorë për kryerjen e detyrave të shtëpisë.

Pyetja 6. Sa merrni pjesë në mësimin plotësues ose shtues?

- a. *Shumë*
- b. *Deri diku*
- c. *Pak*
- d. *Aspak*



Grafiku 27.

Kohët e fundit në sistemin arsimor një nga mënyrat e mira të punës që është duke u aplikuar është mësimi plotësues dhe shtues. Kjo formë është menduar që të praktikohet me qëllim që t'u ofrohen mundësi shtesë nxënësve me nevojë për mësimpldhënës a shtues. Mësimpldhënës organizohet me qëllim të përsëritjes dhe të përvetësimit të përmbajtjeve mësimore që janë mësuar në shkollë, por që nxënësit nuk kanë arritur t'i përvetësojnë ato. Mësimpldhënës


plotësues organizohet për nxënësit që gjatë mësimit të rregullt shihet se dukshëm kanë përparuar dhe dëshirohet që akoma të thellohen njohuritë e tyre.

Të pyetur nëse nxënësit e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian janë të përfshirë në ndonjërin nga këto kategori, ata u deklaruan se 53% marrin shumë shpesh pjesë në mësimin plotësues apo shtues, 20% deri diku, 12% e tyre marrin pjesë shumë pak, ndërsa 15% e tyre nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në asnjërin nga to.

Nëse analizojmë faktin se këta fëmijë janë jo shumë të mbështetur nga familjet e tyre për kryerjen e detyrave të shtëpisë, për shkak të shkollimit jo të kënaqshëm të prindërve, atëherë është më se e nevojshme që këto shkolla ta kenë parasysh këtë kategori dhe sa më shumë që të jetë e mundur t'i përfshijnë në mësimin plotësues e pse jo ata që janë më të avancuar edhe në mësimin shtues. Është shqetësuese shifra prej 15% e të intervistuarve që nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në mësim plotësues ose shtues, sepse gjithëpërfshirja në aktivitete të zhvilluara në klasë a shkollë është e drejtë e secilit nxënës.

Pyetja 7. A janë në gjendje prindërit t'ju ndihmojnë rreth detyrave të shtëpisë?

- a. Po
- b. Jo
- c. Nganjëherë



Grafiku 28.

Të pyetur nëse nxënësit ndihmohen nga prindërit kur hasin vështirësi në kryerjen e detyrave të shtëpisë, 27% u deklaruan se ndihmohen nga prindërit, 43% nuk ndihmohen dhe 30% e tyre ndihmohen nganjëherë.

Gjykuar nga niveli i shkollimit të prindërve, mund të supozojmë se ky është faktori kryesor pse fëmijët nga radhët e minoriteteve nuk arrijnë të marrin mbështetjen e mjaftueshme nga prindërit e tyre. Studime të ndryshme shpeshherë na japin mendime edhe krejt të ndryshme nga këto që pohohen në këtë punim. P.sh.:

“Prindërit mendojnë që duke i ndihmuar fëmijët rreth detyrave të shtëpisë, ata do të arrijnë rezultate më të mira. Por studiuesit mendojnë diçka tjetër lidhur me këtë.

Studiuesit e Universitetit të Teksasit në Austin dhe nga Universiteti Duke kryen një vëzhgim për të vlerësuar lidhjen mes përfshirjes prindërore dhe performancës së tyre akademike.

Rezultati ishte se pjesa më e madhe e formës së pjesëmarrjes së matshme të prindërve ka sjellë pak përfitime shkollore për fëmijët, pa marrë parasysh nivelin arsimor të nënës dhe të babait.

Konkluzioni për të cilin The Atlantic i ka dedikuar një artikull të gjatë, është botuar në librin *The broken compass* dhe është firmosur nga profesorët e sociologjisë, Keith Robinson e Angel Harris.


“Kemi mbetur të habitur nga rezultati, duke pasur parasysh se që nga vitet ’70, kultura amerikane është përqendruar shumë në rritjen e përfshirjes së prindërve në shkolla”, ka thënë Keith Robinson në një intervistë.

Por, vendimi i të dhënave ka qenë i qartë: ajo që përfitohet është një marrëdhënie reciproke. Duke u nisur që nga shkolla e mesme, përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë së fëmijëve ka një ndikim negativ në rezultatet e provimeve që ata bëjnë. Në të njëjtën mënyrë, fëmijët e prindërve që takohen shpesh me mësuesit dhe drejtorët, duket se përmirësohen në mënyrë më të ngadaltë në krahasim me fëmijët, prindërit e të cilëve janë më pak të pranishëm në shkollë.”⁸¹

⁸¹ <https://www.spektrum.al/studim-perfshirja-e-prinderve-ne-detyrat-e-shtepise-se-femijeve-ka-ndikim-negativ-ne-rezultatet-e-tyre/>

Pyetja 8. Çfarë bëni në kohën e lirë?

- a. Lexoj
- b. Luaj
- c. Ndhimjo prindërit
- d. Punoj _____ (nëse po, çfarë?)



Grafiku 29.

Të pyetur se si e kalojnë kohën e lirë, 63% e tyre janë deklaruar se kohën e tyre të lirë e shfrytëzojnë duke lexuar, 15% e tyre duke luajtur, 5% duke u ndihmuar prindërve në gjërat për të cilat ata kanë nevojë dhe 17 % e tyre punojnë.

Nëse analizojmë përqindjen e atyre që janë deklaruar se lexojnë në kohën e tyre të lirë, del që nxënësit nuk janë se nuk lexojnë, mirëpo nëse i shohim rezultatet e nxënësve nga shteti ynë, atëherë del se si pasojë e leximit të pamjaftueshëm dhe joadekuat shpeshherë kemi rezultate jo të kënaqshme edhe në teste ndërkombëtare, siç është PISA.

“Një studim i bërë nga USAID-i, Basic Education Program (BEP), me anë të vlerësimit të leximit në klasat e ulëta (EGRA), testoi 800 nxënës nga 40 shkolla në fund të klasës së dytë.

Studimi tregoi se ndërkohë që nxënësit mund të lexonin në mënyrë mekanike, kishte dobësi të theksuara në shkathtësitë e nivelit më të lartë sipas standardeve ndërkombëtare. Në veçanti rrjedhshmëria orale (aftësia për ta lexuar tekstin saktë, me shpejtësi të mirë dhe me të shprehurit e duhur) dhe lexim-kuptimi (të kuptuarit e përmbajtjes) ishin të dobëta. Kjo sugjeron se në Kosovë duhet t'i kushtohet shumë më tepër vëmendje përmirësimit të mësimdhënies së rrjedhshmërisë dhe të kuptuarit.”⁸²

Shqetësues mbetet fakti që fëmijët punojnë dhe si pasojë e angazhimeve të tilla ata mbeten mbrapa me mësimet.


Një studim i organizatës ILO jep këto të dhëna sa i përket punës së fëmijëve: “janë 318 milionë fëmijë ekonomikisht aktiv në botë. Rreth dy të tretat e këtyre fëmijëve (218 milionë) janë të angazhuar në atë që konsiderohet të jetë punë e fëmijëve. Pjesa tjetër merr pjesë në forma të pranueshme të punës. Prej 218 milionë fëmijëve që punojnë, më shumë se 126 milionë janë të angazhuar në punë të rrezikshme. Njëkohësisht puna e fëmijëve ekziston jo vetëm se fëmijët furnizojnë punën e tyre, por gjithashtu për shkak se plantacionet, fermat, fabrikat, bizneset dhe ekonomitë familjare krijojnë kërkesë për punën e tillë. Eliminimi i suksesshëm i punës së fëmijëve nëpër botë kërkon përpjekje për të prekur njëkohësisht këtë pako komplekse të faktorëve për furnizim dhe kërkesë.”⁸³

⁸² <http://kec-ks.org/ëp-content/uploads/2016/06/BEP-Doracaku-i-leximit-Final.pdf>

⁸³ http://ilo.org/ëcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/ëcms_169136.pdf

Pyetja 9. Cili është sukseesi juaj në shkollë?

- a. *I shkëlqyeshëm*
- b. *I mirë*
- c. *I mjaftueshëm*
- d. *I pamjaftueshëm*



Grafiku 30.

Të pyetur për suksesin që ata tregojnë në mësim, nxënësit u shprehën në këtë mënyrë: 15% e tyre kanë sukses të shkëlqyeshëm, 37% sukses të mirë, 36% sukses të mjaftueshëm dhe 12% e tyre sukses të pamjaftueshëm.


- a. Pyetësori i realizuar me mësimdhënës që në klasat e tyre kanë edhe nxënës të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë.

Pyetësori është realizuar me rreth 100 mësimdhënës. Pyetësori është realizuar në qendrat ku janë të përqendruar pjesëtarët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian.

Në vijim përgjigjet në pyetjet e shtuara do t'ua paraqesim në formë grafikonesh dhe me përqindje për secilën përgjigje të dhënë.

10. Sa jeni të kënaqur me vijimin e mësimimit të fëmijëve të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në shkollë?

- a. Pak
- b. Shumë
- c. Aspak



Grafiku 31.

Të pyetur lidhur me vijimin e mësimimit të nxënësve të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në shkollë, del se 48% e mësimdhënësve janë pak të kënaqur, 52% e tyre janë shumë të kënaqur, ndërsa nuk kishte asnjë nga ata që ishte aspak i kënaqur.

Në bazë të disa statistikave të MASHT-it të vitit shkollor 2017-2018, gjejmë këto të dhëna sa i përket vijueshmërisë së nxënësve nga radhët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në shkollë:


- Numri i fëmijëve sipas përkatësisë etnike në arsimin parafillor – janë gjithsej 410 nxënës të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian që ndjekin mësimin në arsimin parafillor;

- Numri i nxënësve në arsimin fillor e të mesëm të ulët, sipas përkatësisë etnike – janë rreth 5690 nxënës të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian që ndjekin arsimin fillor dhe atë të mesëm të ulët.⁸⁴

1. A keni vështirësi që t’i inkorporoni këta fëmijëve në klasën tuaj?

a. Po

b. Jo



Grafiku 32.

Janë shumë faktorë që ndikojnë që fëmijët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian të ndihen shpeshherë inferiorë dhe të anashkaluar në klasat me shumicë shqiptare. Duke u bazuar në këtë element, edhe u është shtruar kjo pyetje mësimdhënësve për të parë se sa ata kanë vështirësi që t’i inkorporojnë në klasat e tyre nxënësit nga radhët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian.

⁸⁴ <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>

48% e të anketuarve del se kanë vështirësi që t'i inkorporojnë këta nxënës në klasat e tyre dhe 52% del se nuk kanë vështirësi. Përqindja e tyre që kanë vështirësi për inkorporimin e këtyre nxënësve në klasat e tyre është vërtet shqetësuese.

Megjithëse në Kosovë të gjithë njerëzit janë të barabartë me ligj, diskriminimi kombëtar e racor vërehet qysh në fëmijërinë e hershme. Në klasat e ulëta të shkollës fillore dallohen nxënësit e një klase, sikurse gishtat e një dore. Në bankat e para ulen zakonisht shqiptarët ose serbët, ndërsa në bankat e fundit ata të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Madje këta të fundit edhe shokët i kanë nga komuniteti i tyre, sepse të tjerët nuk i bëjnë shokë.

Diskriminimi që u bëhet në shkolla po i detyron këta fëmijë ta braktisin mësimin. Fëmijët e këtij komuniteti joshumicë nuk e braktisin shkollën vetëm për shkaqe ekonomike, por edhe pse ndihen të diskriminuar në aspektin racor.


Ky diskriminim, sipas prindërve të këtyre fëmijëve, ndodh edhe në prani të stafit mësimor, si dhe udhëheqësisë së shkollës, e cila në shumë raste ka njohuri lidhur me këtë lloj diskriminimi.

Ky element është mjaft shqetësues dhe meriton vëmendje shumë të madhe të organeve kompetente, duke filluar nga mekanizmat e brendshëm të shkollave, për të vazhduar pastaj me MASHT-in si autoriteti mbikëqyrës i respektimit të ligjeve, të udhëzimeve administrative dhe të rregulloreve që rregullojnë shumë qartë këtë fushë.

2. A keni ndjekur ndonjë trajnim për qasje të barabartë ndaj nxënësve?

a. Po (specifiko) _____

b. Jo



Grafiku 33.

Ndryshimet në arsim, ashtu si dhe në fushat e tjera, janë duke evoluar me shpejtësi të madhe. Për të qenë në hap me trendet bashkëkohore të mësimdhënies, mësimdhënësit duhet të trajnohen dhe të hulumtojnë në vazhdimësi. Në Republikën e Kosovës përgjegjës për këtë çështje është MASHT-i, i cili mund t'ua bartë këtë përgjegjësi disa organizatave arsimore që organizojnë trajnime për çështje të ndryshme arsimore.

“Edukimi i mësimdhënësve për gjithëpërfshirjen sociale të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve momentalisht nuk është pjesë e trajnimit para shërbimit dhe gjatë shërbimit të mësimdhënësve. Megjithatë, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të nga Kosova kanë pilotuar programe të trajnimit që janë në dispozicion për mësimdhënësit në mënyrë që të rritin kompetencat e mësimdhënësve që punojnë me nxënësit romë, ashkalinj dhe egjiptianë.

Programet e trajnimit në vijim që trajtojnë çështjet e përfshirjes sociale janë të listuara në *Katalogun* e programeve të akredituara të trajnimit nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë:

- *Edukimi për drejtësi sociale* (Qendra për Arsim e Kosovës);
- *Edukimi multikulturor dhe multietnik* (Qendra për Arsim e Kosovës);
- *Të drejtat e njeriut dhe mësimdhënia interaktive*;
- *Edukimi për qytetari demokratike dhe edukimi për të drejtat e njeriut* (Këshilli i Evropës);
- *Mësimdhënie për multikulturalizmin* (Këshilli i Evropës);
- *Qasja në arsim cilësor për komunitetin joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian* (Këshilli i Evropës).

Programe të tjera të trajnimit janë kryer për të promovuar zhvillimet metodologjike, siç janë metodat interaktive dhe bashkëpunuese të mësimnxënies dhe përdorimi i metodologjive të reja dhe i medieve të reja për ta bërë mësimnxënien më atraktive. Gjithashtu janë ofruar trajnime për mësimdhënës në multikulturalizëm, projektet dhe ngjarjet ndërkulturore.


Shqyrtimi i këtyre aktiviteteve tregon një nevojë për qasje më sistematike dhe gjithëpërfshirëse që përfshin trajnimin në zhvillimin e tërë shkollës si dhe trajnimin e mësimdhënësve individualë që janë të interesuar për ngritjen e kompetencave të tyre ndërkulturore. Sa i përket trajnimit mbi arsimin përfshirës, duhet të ofrohen trajnime në vazhdimësi për mësimdhënësit, por gjithashtu edhe për palët me interes në shkollë për të bërë vlerësimin e diversitetit kulturor dhe kundër paragjykitimit dhe diskriminimit.”⁸⁵

Të pyetur se sa prej tyre kanë kryer ndonjë trajnim për trajtim të barabartë ndaj të gjithë nxënësve, del se 48% e tyre kanë ndjekur trajnime të kësaj natyre dhe 52 % e tyre jo.

⁸⁵ <https://rm.coe.int/1680695741>

3. Sa keni mbështetje nga shkolla dhe institucionet e tjera në punën tuaj?

- a. *Jashtëzakonisht shumë*
- b. *Shumë*
- c. *Deri diku*
- d. *Pak*
- e. *Aspak*



Grafiku 34.


Të pyetur se sa kanë mbështetje në punën e tyre me nxënës, mësime dhënësit janë përgjigjur në këtë mënyrë: 75% e tyre janë jashtëzakonisht të kënaqur, 15% shumë, 10% deri diku, ndërsa nuk ka të atillë që nuk kanë mbështetje.

Ky është element mjaft i rëndësishëm që është për t'u vlerësuar, sepse mësime dhënësit sigurisht që ndiejnë lehtësi në punën e tyre kur nuk u mungon mbështetja nga menaxhmenti ose nga organizatat e ndryshme që si pikësypnim kanë përfshirjen sa më të madhe të nxënësve minoritarë në arsimin e obliguar.

Kjo mbështetje mund të jetë e tillë që u ofron mësimdhënësve mundësi të mira pune me nxënësit e minoriteteve. Siç e dimë fare mirë, familjet e fëmijëve të këtij komuniteti nuk qëndrojnë aspak mirë në aspektin ekonomik, prandaj edhe fëmijët shpesh janë të detyruar të angazhohen në punë të ndryshme për të siguruar të ardhura për jetë. Kjo i detyron të braktisin shkollën, gjë që është e dëmshme për të ardhmen e këtyre fëmijëve, prandaj çfarëdo ndihme në lidhje me organizimin e fushatave të ndryshme vetëdijesuese për prindërit e tyre, që ata të sensibilizohen lidhur me rëndësinë e shkollimit të fëmijëve të tyre, është e rëndësishme, sepse ndikohet që ata fëmijët të mos angazhohen në punë të tjera joadekuate për moshën e tyre. Në këtë mënyrë, duke i larguar nga kjo përgjegjësi mjaft e mundimshme, fëmijëve u lehtësohet jeta dhe u krijohet kohë e hapësirë e nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të veta si nxënës dhe si fëmijë. Kur nxënësit janë aktivë në shkollë dhe i kryejnë detyrat e obligimet e tyre, kjo përbën lehtësim edhe për mësimdhënësit në punën e tyre me ta.

4. A janë të paragjykuar këta fëmijë nga fëmijët shumicë në klasë?

- a. *Po*
- b. *Jo*
- c. *Nganjëherë*



Grafiku 35.

Ne jemi vetë dëshmitarë se njerëzit nga komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian janë të paragjykuar. Si rrjedhojë, ku më shumë e ku më pak, edhe nxënësit e këtyre komuniteteve janë të paragjykuar në shkollë. Qëndrimet e mësimeve lidhur me paragjykimet e nxënësve nga radhët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian dalin kështu: 13% e tyre thonë se këta fëmijë janë të paragjykuar, 56% deklarohen se nuk janë të paragjykuar dhe 31% e tyre thonë se paragjykojnë nganjëherë.

Pavarësisht nga deklaratimet e mësimeve, ne e dimë fare mirë se gjendja nuk është edhe aq e mirë sa paraqitet nga vetë ata. Në një prononcim për një gazetë, Veton Berisha, kryetar i Partisë Liberale të Egjiptianëve, deklaroi se në shkollë nuk ka metoda pedagogjike të mirëfillta për të integruar fëmijët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian.


Berisha thotë se prindërit janë të interesuar që fëmijët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të shpërndahen në klasa në mënyrë që të mos izoloohen brenda vetes. Megjithëse nuk dëshiron që të përgjithësohen të gjithë mësuesit në këtë shkelje, ai thotë se mësuesve nuk u pengojnë as rastet kur një nxënës rom, ashkali ose egjiptian ulet qoftë edhe vetëm në bankë, pasi, sipas tij, të tjerët nuk duan të ulen me të. “Këtu nuk ka një metodë të vetë mësuesit të pozicionuar për të ngritur rezultatin. Është evidente se rezultati i tyre është më i dobët, pra dallon prej të tjerëve. Aty brenda klasave nuk di çka ndodh, por janë këto elemente që të bëjnë të mos ndihesh mirë. Mirë është të ketë një lloj sensibilizimi të opinionit në mënyrë që të mos ndodhin raste të shpeshta”, thotë Berisha.⁸⁶

Pra, ka raste kur nxënësit ulen vetëm në bankë ose edhe në rreshtin e fundit të bankave në klasë dhe kjo jo rrallë nuk u krijon fare përshtypje mësuesve në klasë për të ndërmarrë hapa që çojnë në eliminimin e këtyre problemeve. Përveçse lë pasoja në zhvillimin e nxënësve të këtij komuniteti, kjo krijon edhe një atmosferë të papërshtatshme për punë në klasë, afekton nxënësit në raportet mes tyre dhe nxit ndasi mes nxënësish të komuniteteve të ndryshme. E gjithë kjo shkon në kundërshtim me vetë qëllimin dhe misionin e shkollës dhe me vetë infrastrukturën ligjore e pedagogjike të hartuar në Republikën e Kosovës. Në këtë mes, mësuesi luan rol kyç dhe mban përgjegjësi si një nga hallkat më të rëndësishme në procesin mësimor. Prandaj me të drejtë stafi mësimor kritikohet kur nuk u prin nxënësve në rrugën e përbashkët të bashkëjetesës.

⁸⁶ <https://www.albinfo.ch/diskriminim-nga-klasa-e-pare-nxenesve-u-ndalohet-te-ulen-ne-bankat-e-para/>

5. Sa janë të rregullt prindërit e këtyre fëmijëve në takimet e organizuara të klasës?

- a. *Pak*
- b. *Shumë*
- c. *Aspak*




Grafiku 36.

Siç e dimë, në periudha të caktuara dhe sa herë është e nevojshme, në shkollë organizohen mbledhje dhe takime me prindër, të cilat kanë një rëndësi të veçantë në procesin mësimor. Lidhur me pjesëmarrjen e prindërve të nxënësve nga radhët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në këto mbledhje, mësimdhënësit dhanë këto përgjigje: 15% e tyre thonë se ata marrin pjesë pak në këto takime, 82% shumë dhe 3% aspak.

Sot OJQ të ndryshme merren pikërisht me çështjen e sensibilizimit të prindërve për rëndësinë që ka shkolla dhe rëndësinë që kanë ata si komunitet i prindërve për pjesëmarrjen në aktivitetet e shkollës.

6. Sa vijnë të përgatitur këta nxënës me detyrat e shtëpisë?

- a. *Pak*
- b. *Shumë*
- c. *Aspak*



Grafiku 37.

Në pyetjen se sa vijnë nxënësit e përgatitur me detyrat e shtëpisë, mësimdhënësit japin këto përgjigje: 45% e tyre përgjigjen se vijnë pak, 21% shumë dhe 34% aspak. Rezultatet e dala flasin për një shifër jo të vogël të nxënësve që vijnë të papërgatitur në shkollë. Nëse i analizojmë shkaqet, mund të vijmë në përfundim se ata nuk gjejnë mbështetjen adekuate nga ana e prindërve në realizimin e detyrave të shtëpisë, edhe si pasojë e mosshkollimit të tyre, apo mund të aludojmë edhe në punët që ata bëjnë për t'u dalë në ndihmë familjarëve dhe si pasojë e kësaj ata nuk kohë për të kryer obligimet e tyre shkollore.

Nëse ndalemi te grafikonët e lartparaqitur, që sjellin rezultatet e anketimit të realizuar me nxënës, vërejmë se ata deklarohen se marrin mbështetjen e mjaftueshme nga ana e


prindërve, mirëpo gjithmonë duhet të kemi parasysh se ata janë fëmijë, prandaj dhe shpeshherë ata mund të shprehen ndryshe nga realiteti që jetojnë.

Konsideroj se brenda institucioneve shkollore duhet të krijohen mekanizma të veçantë për t'u dalë në ndihmë këtyre fëmijëve.

7. A mendoni se këta nxënës kanë mbështetje të mjaftueshme në shtëpi?

a. *Po*

b. *Jo*



Grafiku 38.

60% e të anketuarve thonë se këta nxënës gjejnë mbështetjen e mjaftueshme nga prindërit e tyre, ndërsa 15 % thonë se jo. Lidhur me këtë problematikë që është mjaft e evidente në Kosovë operojnë një sërë organizatash, të cilat ndër të tjera merren edhe me çështjen e gjetjes dhe ofrimit të ndihmës në kryerjen e detyrave të shtëpisë.


Në komunën e Prizrenit, ku numri i nxënësve nga komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian është mjaft i madh, kryetari kësaj komune ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me drejtorin ekzekutiv të organizatës “Nevo Koncepti”, për fazën e dytë të projektit të “Risocializimi i të rikthyerve romë, ashkalinj dhe egjiptianë nga Evropa Perëndimore në komunën e Prizrenit”. Ky projekt ka për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së pjesëtarëve të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. Në kuadër të këtij projekti, Komuna e Prizrenit, nëpërmjet Drejtorisë së Arsimit, Zyrës komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale do të ofrojë mbështetje për aktivitete të ndryshme, si: integrimi shkollor i të kthyerve dhe nxënësve në nevojë të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, mbështetja e tyre me materiale shkollore, mbështetja për asistimin në detyrat e shtëpisë dhe mësimin plotësues, që do të zhvillohet në katër shkolla fillore të Prizrenit, asistencë në sigurimin e dokumenteve të nevojshme për qasje në shërbime publike dhe asistencë për punësimin e pjesëtarëve të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. Ky projekt financohet nga qeveria gjermane dhe do të implementohet deri fund të muajit gusht të vitit 2022.⁸⁷

Siç shihet, pra, njëra nga çështjet me të cilën merret kjo organizatë është edhe ajo e detyrave të shtëpisë. Pra, lirisht mund të konkludojmë se vërtet kjo është një problematikë që vërehet te nxënësit e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. Si kjo organizatë ka edhe shumë të tjera që realisht ndikojnë në zbutjen e kësaj situatë të krijuar në radhët e nxënësve të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian.

⁸⁷ <https://lajme365.com/nenshkruhet-memorandum-bashkepunimi-per-pemiresimin-e-pozites-se-komunitetit-rae-ne-prizren/>

8. A ndihmohen këta nxënës nga nxënësit e tjerë të klasës?

- a. *Shumë*
- b. *Disi*
- c. *Pak*
- d. *Aspak*



Grafiku 39.


Në pyetjen për aspektin social në mes të nxënësve të komunitetit shumicë dhe komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, ne morëm këto përgjigje: 2% thonë se ndihmohen shumë, 15% deri diku, 53% pak dhe 30% aspak. Pra, nga përgjigjet e marra, shihet qartë se në mes të nxënësve të komunitetit shumicë edhe nxënësve të komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian qëndron një boshllëk që pengon ndërveprimin e kënaqshëm të tyre.

Ne si shoqëri duhet të ndalemi pikërisht në këtë pikë, sepse shpeshherë raportet jo të mira mes bashkëmoshatarëve dërgojnë në pakënaqësi të mëdha të nxënësit nga radhët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. Si pasojë e kësaj, ata shpeshherë edhe e braktisin shkollën. Fillimisht, të rriturit e kësaj shoqërie duhet të kenë qasjen e duhur ndaj

komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë në mënyrë që të jenë shembull për fëmijët e tyre. Në këtë mënyrë ata ndikojnë që edhe fëmijët e tyre të përmirësojnë qasjen ndaj bashkëmoshatarëve të tyre.

9. A marrin pjesë këta nxënës në aktivitetet kulturore e sportive që organizon shkolla?

- a. *Po*
- b. *Jo*
- c. *Rrallë*



Grafiku 40.

Përgjigjet e mësimehënësve ishin këto: 60% thonë se marrin pjesë, 15% jo dhe 25% rrallë. Nëse ndalemi dhe analizojmë, pjesëmarrja më e madhe e nxënësve nga këto tri komunitete (rom, ashkali dhe egjiptian) në aktivitetet jashtëkurrikulare do të ndihmonte që nxënësit të socializoheshin edhe më tepër mes vete, bile aktivitetet sportive shpeshherë kanë si qëllim primar çështjen e socializmit dhe të bashkëveprimit mes fëmijëve. Në gara dhe aktivitete

sportive mes shkollash e nxënësish rrallë mund të shohim që ekipet e shkollave përfaqësohen nga këta nxënës, gjë që mund të rritë pakënaqësinë e tyre edhe për të ardhur në shkollë. Një gjë e tillë është kryekëput përgjegjësi e mësimdhënësve tanë që duhet të ndikojnë sa më shumë që këta nxënës të përfshihen në aktivitetet jashtëkurrikulare në mënyrë që kjo të jetë një shtysë për ta dhe kështu ata të shohin se vërtet janë të dëshiruar dhe të mirëpritur në shkollë.

ANALIZA SWOT

Gjithëpërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim

<i>Pikat e forta</i>	<i>Dobësitë</i>
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës si dhe legjislacioni në fuqi sigurojnë arsim për të gjithë pa dallim. - Prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta janë më këmbëngulës në kërkimin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve të tyre. - Nxënësit me nevoja të veçanta janë të mirëpritur nga shokët dhe shoqet e klasës në shkollën ku ndjekin mësimet. - Ekziston plani individual që hartohet përkitazi me specifikat e nxënësit. - Ekzistojnë persona profesionistë që kanë për detyrë t'u ndihmojnë mësimdhënësve në hartimin e planit individual. - Numër i konsiderueshëm mësimdhënësish ka ndjekur trajnime për qasje ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta. - Një numër i madh i organizatave vendore dhe jovendore ofrojnë trajnime për mësimdhënësit lidhur me fëmijët me nevoja të veçanta. - Shkollat kanë përparuar në përmirësimin dhe përshtatjen e	- Megjithëse Kushtetuta dhe ligjet në fuqi mbështesin dhe njëherësh sigurojnë arsim gjithëpërfshirës pa dallim, një gjë e tillë nuk respektohet sa duhet. - Me gjithë lëvizjet pozitive të prindërve në mbështetje të fëmijëve të tyre me nevoja të veçanta, akoma ka të atillë që me çdo kusht mundohen ta mbajnë të fshehtë gjendjen e fëmijës së tij, qoftë edhe me sakrifikim të shkollimit. - Nga praktika shohim shpesh prindër që nuk lejojnë fëmijët e tyre të shoqërohen apo të ulen në të njëjtën bankë me nxënës që ka vështirësi apo nevojë të veçantë. - Jo të gjitha shkollat respektojnë ekzistencën e këtij plani dhe e praktikojnë me nxënësit e tyre, madje ka edhe nga ata që hartojnë plane të tilla vetëm sa për formalitet, pasi një gjë e tillë u kërkohet nga DKA-të apo MASHT-i, mirëpo ai plan mbetet vetëm në letër dhe nuk kihet për bazë gjatë realizimit të plan-programit me nxënësit me nevoja të veçanta në klasë. - Megjithëse ekzistojnë profesionistë të thirrur për t'u dalë në ndihmë

infrastrukturës për nxënësit me nevoja të veçanta.	mësimdhënësve në hartimin e planit individual, ata shpeshherë nuk u përgjigjen këtyre thirrjeve, duke u arsyetuar me faktin se janë pak në numër dhe se nuk arrijë t'u përgjigjen të gjitha kërkesave. - Megjithëse ka numër të konsiderueshëm mësimdhënësish që janë të trajnuar lidhur me qasjen ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta, akoma mbetet i madh numri i atyre që nuk janë të trajnuar fare, ndonëse punojnë me nxënës me nevoja të veçanta. - Megjithëse ekziston një numër i madh organizatash që ofrojnë trajnime, janë shkollat ato që paraqesin kërkesat për t'i trajnuar mësimdhënësit e tyre të patrajtuar. MASHT-i dhe DKA-të kanë obligim që t'i identifikojnë nevojat e kësaj natyre dhe të krijojnë mekanizma për trajnimin e të gjithë mësimdhënësve për qasje ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta, aq me shumë kur dihet se numri i tyre në shkolla të rregullta po rritet dita-ditës. - Megjithëse nëpër shkollat e ndërtuara pas luftës ka kushte deri diku të mira për fëmijë me nevoja të veçanta, akoma mbeten shkolla të cilave u mungojnë edhe pjerrinat, edhe tualetet për qasje të fëmijëve me karrocë.
---	--

<i>Mundësitë</i>	<i>Rreziqet</i>
- MASHT-i duhet të krijojë mekanizma për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi. - Organizimi i kampanjave vetëdijesuese për prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta, për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve me nevoja të veçanta për përfshirjen e tyre në jetën shoqërore. - Organizimi i takimeve me prindërit (apo edhe përfshirja e tyre në mbajtjen e ndonjë ore mësimore), të cilët shfaqin pakënaqësi për prezencën e fëmijëve me nevoja të veçanta në klasat e fëmijëve të tyre. - Drejtorët e shkollave të kërkojnë raport mujor nga mësimdhënësi kujdestar për realizimin e planit individual dhe njëherësh ky raport pastaj të dërgohet në DKA. - MASHT-i duhet të rritë tumrin e ekipeve profesionale në mënyrë që t'u dilet në ndihmë mësimdhënësve lidhur me hartimin e planit individual. - DKA-të mund të kërkojnë nga shkollat që të formojnë ekipe për trajnimin e mësimdhënësve me bazë në shkollë nga vetë kolegët e tyre me qëllim të shtrirjes sa më të madhe të ndonjë trajnimi. - MASHT-i duhet të dijë numrin e mësimdhënësve të patrajnuar dhe të shpallë interesim te OJQ-të e ndryshme për ofrimin e trajnimeve të natyrave të	- Mekanizmat e formuar mund të mos kryejnë detyrën për të cilën janë thirrur dhe si pasojë ligjet mbeten vetëm ligje dhe aplikimi i tyre në praktikë lë për të dëshiruar. - Prindërit refuzojnë t'i përgjigjen pjesëmarrjes në kampanjat vetëdijesuese. - Prindërit mund të refuzojnë të jenë pjesë aktive brenda klasës. - Shpeshherë zinxhiri DKA, shkolla dhe mësimdhënësi shkëputet dhe si pasojë nuk arrihet qëllimi i caktuar, njëjtë mund të ndodhë edhe me këtë çështje. - MASHT-i mund të ketë prioritete të tjera dhe njëkohësisht mund të mos ketë buxhet të ndarë për punësimin e punëtorëve të tjerë. - Është praktikë që mësimdhënësit të mos u përgjigjen trajnimeve që organizohen nga kolegët e tyre brenda shkollave ku punojnë. - MASHT-i mund të ketë prioritete të tjera për realizim të trajnimeve të tjera dhe këto trajnime mund të mos jenë synim i MASHT-it. - MASHT mund të mos ketë ndarë buxhet për intervenime të tilla infrastrukturore e njëkohësisht bizneset e komunitetit mund të mos u përgjigjen pozitivisht kërkesave të shkollave për ndihmë të kësaj natyre.

tilla. - MASHT-i mund të identifikojë shkollat që kanë nevojë për intervenim në përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe po ashtu edhe shkollat mund të kërkojnë donatorë me bazë në komunitete që t'i mbështesin në përmirësimin e kushteve infrastrukturore.	
--	--

ANALIZA SWOT

Gjithëpërfshirja e fëmijëve nga komuniteti joshumicë rom, ashkali, egjiptian në arsim

<i>Pikat e forta</i>	<i>Dobësitë</i>
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe legjislacioni në fuqi sigurojnë arsim për të gjithë pa dallim. - Për pakicat në Kosovë, respektivisht për përfshirjen e tyre në arsimin e rregullt në vazhdimësi janë ofruar fonde nga vende të ndryshme ndërkombëtare dhe vazhdojnë të ndahen. - Ekziston një numër i konsiderueshëm OJQ-sh që në forma të ndryshme mbështesin mësimin plotësues të nxënësve nga komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. - Pas luftës e këtej kemi shifra shpresëdhënëse të përfshirjes së fëmijëve nga radhët e minoriteteve në shkollimin e obliguar. - Në mekanizmat institucionalë të arsimit, aty ku vendoset për minoritetet, ka të përfshirë anëtarë nga këto pakica. - MASHT-i ndan një numër të caktuar bursash për nxënësit minoritarë që duan të vazhdojnë shkollimin më tej. - Në regjistrimin e studentëve ekziston një kuotë e caktuar e rezervuar për nxënësit nga radhët e komuniteteve joshumicë.	- Megjithëse Kushtetuta dhe ligjet në fuqi mbështesin dhe njëherësh sigurojnë arsim gjithëpërfshirës pa dallim, një gjë e tillë nuk respektohet sa duhet dhe shifrat në terren lënë shumë për të dëshiruar. - Shpeshherë fondet e dedikuara për pakicat keqpërdoren dhe nuk arrijnë të shfrytëzohen për atë që janë dedikuar. - Jo shumë nxënës nga radhët e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian marrin pjesë në mësimin plotësues të organizuar nga OJQ-të. - Edhe pse nga paslufta e tutje kemi përmirësim të numrit të nxënësve që ndjekin shkollimin e obliguar, akoma është i madh numri i nxënësve që për shkaqe të ndryshme socio-ekonomike nuk ndjekin arsimin e obliguar. - Edhe pse anëtarët e komuniteteve joshumicë, të përfshirë në komisione dhe pozita, kanë të drejtë ta ngritin zërin për komunitetin që përfaqësojnë, zëri dhe vullneti i tyre nuk merren parasysh për shkaqe të ndryshme.

	- Megjithëse MASHT-i ndan bursa për nxënësit e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian, shpeshherë nuk ka nxënës të interesuar për të vazhduar shkollimin pas shkollimit të mesëm të ulët. - Ka të dhëna që edhe ata studentë që regjistrohen në universitete i braktisin studimet dhe nuk e shfrytëzojnë mundësinë e dhënë në bazë të kuotës së paraparë për ta.
<i>Mundësitë</i>	<i>Rreziqet</i>
- MASHT-i duhet të krijojë mekanizma për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi. - Të krijohen mekanizma për mbikëqyrjen e këtyre fondeve, duke rritur kështu përgjegjësinë dhe llogaridhënien. - OJQ-të duhet të ofrojnë programe atraktive që dallojnë nga mësimdhënia e rregullt në mënyrë që të tërheqin vëmendjen e nxënësve dhe të rrisin interesimin e nxënësve për pjesëmarrje në ato aktivitete që si qëllim bazë kanë ofrimin e ndihmës për nxënësit e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian. - Të organizohen kampanja vetëdijesuese për prindër dhe nxënës lidhur me rëndësinë e shkollimit dhe të ndihmohen familjet e nxënësve që detyrohen që edhe fëmijët e tyre t'i angazhojnë në aktivitete të ndryshme fitimprurëse me qëllim të	- Mekanizmat e formuar mund të mos kryejnë detyrën për të cilën janë thirrur dhe si pasojë ligjet mbeten vetëm ligje dhe aplikimi i tyre në praktikë lë për të dëshiruar. - Si pasojë e mosfunksionimit të drejtë të këtyre mekanizmave mbikëqyrës, shtetet që ofrojnë këto fonde mund të tërhiqen. - Megjithëse OJQ-të mund të ofrojnë programe mjaft atraktive për këta fëmijë, mund të mos kenë persona të trajnuar për realizimin e programeve në fjalë dhe si pasojë e një trajtimi joadekuat të tyre nxënësit mund të humbasin interesimin për ndjekjen e këtyre orëve plotësuese. - Prindërit mund të mos u përgjigjen këtyre kampanjave e po ashtu këta fëmijë mund të injorohen dhe të ofendohen nga bashkëmoshatarët e tyre, gjë që rrit pakënaqësinë e tyre për shkollë dhe njëherësh kjo mund të jetë nxitëse për

sigurimit të ekzistencës, sepse me gjithë lëvizjet pozitive për ngritjen e numrit të nxënësve të këtij komunisti në shkolla, mbetet akoma i madh numri i atyre që janë jashtë bankave shkollore. - Anëtarët që mendojnë se zëri dhe kërkesat e tyre nuk përfillen, sa herë të aludohet që ajo që kërkohet është e arsyeshme dhe e bazuar, duhet të shfaqin pakënaqësinë e tyre në organet gjegjëse si mospërfillje në ushtrimin e detyrës zyrtare. - MASHT-i duhet të vendosë sanksione për ata që përfitojnë bursa dhe nuk i shfrytëzojnë ato, sepse në këtë mënyrë e rrisin ndërgjegjësimin e atyre që marrin këtë mbështetje. - Edhe pse ka një kuotë të caktuar për nxënësit minoritarë që dëshirojnë të vazhdojnë studimet, ajo shpesh as shfrytëzohet.	mosndjekjen e shkollimit të obliguar. - Si pasojë e mospërfilljes, ata edhe mund të nxiten që të largohen nga këto komisione. - MASHT-i mund të ndërpresë dhënien e këtyre bursave. - Duke parë që kjo kuotë nuk shfrytëzohet, me kalimin e kohës ekziston rreziku që të hiqet fare, duke qenë se konsiderohet si favorizim i minoriteteve.
--	---

Përfundime

Kujtojmë që në fillim të temës kemi ngritur tri hipoteza të cilat nga hulumtimi i realizuar në teren dhe ai i literaturës, jemi munduar të pohojmë apo mohojmë vërtetësinë e tyre.

Nga hulumtimi i bërë kemi ardhur në përfundim se :

Hipoteza 1. Politikat arsimore të gjithëpërfshirjes nuk monitorohen mjaftueshëm nga politikëbërësit, nëse ato janë duke u zbatuar si duhet ose jo, është vërtetuar hipoteza për faktin se nga të dhënat e hulumtuara në teren konkretisht nga mësimdhënësit kemi marrë përgjigje se pak ose fare ka mekanizma të cilët monitorojnë punën e tyre më kategorinë e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe ata nga radhët e komuniteteve jo shumicë rom, ashkali dhe egjiptian.

Hipoteza 2. Politikat arsimore të gjithëpërfshirjes nuk kanë gjetur zbatim të duhur për kategorinë e komunitetit jo shumicë rom, ashkali dhe egjiptian dhe për kategorinë e fëmijëve me nevoja të veçanta. Kjo hipotezë është vërtetuar dhe njëherit kemi konstatuar se legjislacioni në fuqi është mjaftë mbështetës për këto dy kategori mirëpo faktet nga terreni tregojnë se akoma mbetet shumë punë për të bërë në mënyrë që atë që parasheh ligji të gjënë zbatim edhe në praktikë.

Hipoteza 3. Politikat arsimore të gjithëpërfshirjes janë të mbështetura në politikat dhe standardet e BE-së. Hulumtimet kanë treguar se politikat dhe legjislacioni për gjithë përfshirje janë të harmonizuara dhe të mbështetura në direktivat e BE-së

1. Numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve që punojnë me fëmijë me nevoja të veçanta janë të patrajnuar dhe shpeshherë ky është problem kyç që atyre u sjell vështirësi në punën me këta fëmijë.
2. Mësimdhënësit kanë nevojë shumë të madhe për mësues mbështetës apo asistentë për këta fëmijë. MASHT-i duhet të mendojë ndonjë strategji se si të bëjë zgjidhje për këtë çështje.
3. Përkrahja profesionale e profesionistëve të caktuar mungon për këta fëmijë dhe si pasojë rëndohet mjaft shumë puna e mësimdhënësve.

4. Pjesa e konsiderueshme e mësimeve kanë njohuri të shumë nga ta edhe kanë qenë pjesëmarrës në hartimin e PIA-s.
5. Prindërit e fëmijëve me nevojë të veçanta akoma vazhdojnë të mos jenë shumë bashkëpunues, edhe pse shihet se ka lëvizje pozitive.
6. Numër i konsiderueshëm i shkollave kanë problem me ambientin fizik për pranimin e fëmijëve me problem në lëvizje (fëmijë që lëvizin me karrocë).
7. Studentët nuk janë të gatshëm të punojnë me fëmijët me nevojë të veçanta dhe e konsiderojnë mjaft sfiduese këtë çështje, prandaj kurrikulat në Fakultetin e Edukimit duhet të reformohen në mënyrë që studentët (mësimeve të ardhshme) të kenë kompetencën e duhur edhe për kategorinë e fëmijëve me nevojë të veçanta.
8. Nxënësit e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian shpeshherë ndihen të injoruar në shkollat ku ndjekin mësimin, andaj shkollat duhet të hartojnë programe të veçanta bashkëpunimi në mes të nxënësve në mënyrë që të rritet bashkëpunimi dhe toleranca mes fëmijëve.
9. Nxënësit e komunitetit joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian nuk kanë mbështetjen e mjaftueshme nga ana e prindërve për kryerjen e detyrave të shtëpisë si pasojë e shkollimit të pamjaftueshëm të prindërve.
10. Numri i fëmijëve që ndjekin mësimin nga komuniteti joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian lë për të dëshiruar. Prandaj MASHT-i duhet të organizojë fushatë vetëdijesuese me prindërit e këtyre fëmijëve lidhur me rëndësinë e shkollimit të fëmijëve të tyre.
11. MASHT-i ka nxjerrë ligje të udhëzimeve administrative të bollshme për gjithëpërfshirjen, mirëpo i mbetet të krijojë mekanizma për zbatimin e atyre ligjeve dhe udhëzimeve administrative.
12. MASHT-i ndihmon komunitetet joshumicë me anë të ndarjes së bursave në shkollimin e nxënësve.

13. Prindërit e nxënësve joshumicë akoma nuk bëjnë sa duhet për shkollimin e fëmijëve të tyre dhe sigurimin e një të ardhme më cilësore.
14. Në komisionet ku merren vendime për komunitetin joshumicë ka të përfshirë edhe anëtarë nga radhët e këtyre komuniteteve.
15. Një numër i konsiderueshëm shtetesh përmes OJQ-ve të ndryshme ofrojnë fonde të shumta për të ndihmuar arsimimin e fëmijëve nga radhët e komuniteteve joshumicë.

Rekomandime

1. MASHT-i bashkë me DKA-të duhet të krijojë mekanizma brenda shkollave për të trajnuar mësime të mësimdhënësve që ata pastaj të bëjnë trajnimet me bazë në shkollë.
2. Një marrëveshje në mes të Fakultetit të Edukimit dhe MASHT-it, që studentët e vitit të fundit të kryejnë punën e asistentit të mësuesit, do të ishte një zgjidhje mjaft e mençur. Me këtë formë bashkëpunimi do të përfitonin të dyja palët, sepse MASHT-i nuk do të ngarkonte buxhetin, ndërsa studentët do të përfitonin shumë nga përvoja të tilla.
3. Rekomandohet që të krijohet një ekip specialistësh të fushave të caktuara, si psikologë, pedagogë, logopedë etj., (meqë MASHT-i e konsideron të pamundur përfshirjen e tyre në të gjitha shkollat), që të japin shërbimet e nevojshme duke shkuar nga një shkollë në tjetrën në mënyrë që t'u dalin në ndihmë fëmijëve dhe mësime të mësimdhënësve që kanë nevojë.
4. Rekomandoj im për drejtorët e shkollave dhe zyrtarët e MASHT-i nga departamenti për fëmijë me nevojë të veçanta është që të monitorohet realizimi i objektivave që përshihen në PIA me nxënësit të caktuar, si dhe MASHT-i të dërgojë psikologë e mësuese mbështetëse (aty ku mungojnë) me qëllim që të mbështeten mësime të mësimdhënësve në hartimin e PIA-s.
5. Konsideroj se duhet të organizohen fushata vetëdijësuese për këta prindër në mënyrë që ata ta kuptojnë se fëmijët e tyre e kanë mbështetjen institucionale dhe ligjore, mirëpo edhe roli i tyre në këtë proces është mjaft i rëndësishëm.
6. MASHT-i duhet të bëjë hulumtime lidhur me nevojat e komunitetit të fëmijëve në lagje e fshatra dhe të përshtatë ambientin fizik të shkollave me specifikat e nxënësve.
7. Shkolla dhe vetë mësime të mësimdhënësve duhet të bëjnë përpjekje që nxënësve që kanë nevojë t'i përfshijnë sa më shumë në mësimin plotësues.
8. MASHT-i duhet të krijojë mekanizma për të mbikëqyrur procesin e ndarjes së bursave me qëllim që shfrytëzimi i atyre mjeteve të ndara të jetë i drejtë dhe të përmbushë qëllimin.

9. MASHT-i duhet të hartojë strategji për mbajtjen e kampanjave vetëdijesuese për të gjitha familjet që kanë fëmijë në mënyrë që të sensibilizojnë prindërit për rëndësinë e shkollimit.
10. MASHT-i dhe institucionet e tjera përgjegjëse duhet t'u sigurojnë komoditet këtyre anëtarëve që zëri i tyre të dëgjohej dhe të ndikojë në vendimmarrje.
11. Shteti duhet të krijojë komisione të ndryshme me qëllim që mjetet e ndara të destinohen në mënyrë të drejtë.

Conclusions

We recall that at the beginning of the topic we have raised three hypotheses which from the research conducted in the field and that of the literature, we have tried to confirm or deny their veracity.

From the research we have come to the conclusion that:

Hypothesis 1. Inclusive educational policies are not sufficiently monitored by policymakers, whether they are being implemented properly or not, the hypothesis has been confirmed that from the data researched in the field specifically by teachers we have received answers that little or no mechanisms exist. who monitor their work with the category of children with special needs and those from non-majority Roma, Ashkali and Egyptian communities.

Hypothesis 2. Inclusive educational policies have not found proper application for the non-majority Roma, Ashkali and Egyptian community category and for the category of children with special needs. This hypothesis has been confirmed and at the same time we have found that the legislation in force is very supportive for these two categories, but the facts from the field show that there is still much work to be done so that what the law provides can be implemented in practice.

Hypothesis 3. Inclusive education policies are based on EU policies and standards. Research has shown that policies and legislation for all inclusion are harmonized and based on EU directives.

1. A significant number of teachers who work with children with special needs are untrained and often this is a key problem that brings them difficulties in working with these children.

2. Teachers are in dire need of supportive teachers or assistants for these children. MEST should think of a strategy on how to solve this issue.
3. The professional support of certain professionals is lacking for these children and as a result the work of teachers is very difficult.
4. A significant number of teachers have knowledge and many of them have been participants in the drafting of the PIA.
5. Parents of children with special needs still do not cooperate very well, although it is seen that there is a positive movement.
6. A significant number of schools have a problem with the physical environment for admitting children with mobility problems (children who move in a wheelchair).
7. Students are not ready to work with children with special needs and consider this issue quite challenging, therefore curricula at the Faculty of Education should be reformed so that students (future teachers) have the appropriate competence for the category of children with special needs.
8. Roma, Ashkali and Egyptian non-majority students often feel ignored in schools where they attend classes, so schools need to design special cooperation programs among students in order to increase cooperation and tolerance among children.
9. Non-Roma, Ashkali and Egyptian non-majority students do not have sufficient parental support to perform homework due to insufficient parental education.
10. The number of children attending classes from the non-majority Roma, Ashkali and Egyptian communities leaves much to be desired. Therefore, MEST should organize awareness campaigns with the parents of these children regarding the importance of educating their children.

11. MEST has issued numerous administrative laws and guidelines for inclusion, but it remains to establish mechanisms for the implementation of those administrative laws and guidelines.

12. MEST helps non-majority communities by allocating scholarships to student education.

13. Parents of non-majority students still do not do enough to educate their children and ensure a better future.

14. The commissions where decisions are made for the non-majority community also include members from the ranks of these communities.

15. A significant number of countries through various NGOs provide numerous funds to help educate children from non-majority communities.

Recommendations

1. MEST together with MEDs should create mechanisms within schools to train teachers so that they can then carry out school-based training.
2. An agreement between the Faculty of Education and the MEST that last year students complete the work of a teacher's assistant would be a very wise solution. With this form of cooperation, both parties would benefit, because the MEST would not burden the budget, while students would benefit greatly from such experiences.
3. It is recommended to create a team of specialists in certain fields, such as psychologists, pedagogues, speech therapists, etc. (since MEST considers it impossible to include them in all schools), to provide the necessary services by going from one school to another in order to help children and teachers in need.
4. My recommendation for school principals and MEST officials from the department for children with special needs is to monitor the achievement of objectives included in the PIA with certain students, and MEST to send psychologists and support teachers (where they are missing) in order to support teachers in drafting the PIA.
5. I consider that awareness campaigns should be organized for these parents so that they understand that their children have institutional and legal support, but also their role in this process is very important.
6. MEST should conduct research on the needs of the community of children in neighborhoods and villages and adapt the physical environment of schools to the specifics of students.

7. The school and the teachers themselves should make an effort to involve the students who need it as much as possible in the supplementary education.
8. MEST should establish mechanisms to oversee the process of allocating scholarships in order for the use of those allocated funds to be fair and fulfill the purpose.
9. MEST should develop strategies for holding awareness campaigns for all families with children in order to raise awareness among parents about the importance of schooling.
10. MEST and other responsible institutions should provide comfort to these members so that their voice is heard and influences decision-making.
11. The state should set up various commissions in order to properly allocate the allocated funds.

Literatura

1. Selim Mehmeti, Ema Rraci, Kushtrim Bajrami, Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë, 2009, Prishtinë.
2. Sahare Recica, IPK, Raport hulumtimi, Mbështetja e qendrave burimore për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore të përfshirë në shkolla të rregullta, Prishtinë, 2013.
3. Dukagjin Pupovci, Halim Hyseni, Nikoleta Salihaj, Arsimi ne Kosove, 2001.
4. Linda Grapci-Kotori, Raport mbi gjendjen e të diplomuarve në programin Avancimi i Kualifikimit të Mësimdhënësve (raport i papublikuar), 29. 3. 2017.
5. Colin J. Marsh, Koncepte themelore për ta kuptuar kurrikulumin, (botim i katërt në shqip), Qendra për Arsim Demokratik, Tiranë, 2009.
6. H. Hyseni, N. Mita, J. Salihaj & D. Pupovci, Qeverisja dhe udhëheqja në arsim – Si të bëheni udhëheqës i suksesshëm (Udhëzues), Qendra për Arsim e Kosovës, 2003.
7. Natyra Agani-Destani, Linda Hoxha, Kaltrina Kelmendi, Hulumtim mbi arsimin gjithëpërfshirës në dhjetë shkolla fillore të Kosovës, nëntor 2015.
8. Luljeta Aliu, Analizë e sistemit arsimor në Kosovë, Prishtinë, 2019.
9. Jusuf Thaqi, Petrit Tahiri, Raport hulumtimi, Gjendja e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në Kosovë, nëntor 2016.

Dokumentacion nga institucionet

10. FSDEK, Edukimi special në Kosovë. GME, 2003.
11. MASHT, Qeveria e Republikës së Kosovës, Njësia për arsim special (2009 – 2010).
12. MASHT, Qeveria e Republikës së Kosovës – EMIS (2010). Statistikat e arsimit në Kosovë (2009 – 2010).
13. MASHT, Qeveria e Republikës së Kosovës, Plan strategjik për organizimin e arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë (2010 – 2015), Prishtinë, mars 2010.

14. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, nëntor 1989.
15. Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë (2007 – 2017).
16. Strategjia e sigurimit të cilësisë për arsimin parauniversitar në Kosovë (2016 – 2020).
17. MASHT, Qeveria e Republikës së Kosovës, Plani strategjik i arsimit të Kosovës (2017 – 2021).
18. Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim, Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë, Prishtinë, prill 2019.
19. Departamenti i Arsimit Parauniversitar, Njësia e Arsimit Special.
20. Shkolla për të Gjithë, Raport i vizionimit të punëtorisë për objektin shkollor dhe rehabilitues për personat me aftësi të kufizuara, 2017.
21. MASHT, Qeveria e Republikës së Kosovës, Arsimi gjithëpërfshirës, shkurt 2014.
22. Katalogu i programeve të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, 2017.
23. Divizioni për Zhvillim Profesional të Mësimdhënësve në Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, Raport përmbledhës për trajnimin e mësimdhënësve për zbatimin e KKK-së, mars – korrik 2017.
24. University of Wollongong Research Online, Inclusion of students with disabilities in neë times: responding to the challenge, 2008 (shfletuar në dhjetor 2019).
25. MASHT, Qeveria e Republikës së Kosovës, Plani strategjik i arsimit në Kosovë (2017 – 2021).
26. MASHT, Qeveria e Republikës së Kosovës, Statistikat e arsimit në Kosovë, 2016 – 2017.
27. OSBE, Pasqyrë e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, janar 2020.
28. Zyra për çështje të komuniteteve, (shfletuar në dhjetor 2019).
29. OSBE, Pasqyrë e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, janar 2020.
30. Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës, 2009 – 2015.
31. MASHT, Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, Komponenti i edukimit, 2007- 2017.
32. MASHT, Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, Komponenti i edukimit, 2007 – 2017.
33. Plani i veprimit 2009 për implementimin e partneritetit evropian për Kosovën.

34. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njëërën anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike.

Legjislacioni

35. Ligji nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në Kosovë.
36. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.
37. Ligji nr. 02/l-52 mbi edukimin parashkollor.
38. Ligji nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës.
39. Korniza Kushtetuese e Vetëqeverisjes së Përkohshme.
40. Rregullore nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive.
41. Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendim nr. 6/121, datë 22.04.2010.
42. Rregullore nr. 01/2011 për departamentet për integrim evropian dhe koordinim të politikave në kuadër të ministrive.
43. Rregullore e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 09/2011.
44. Rregullore nr. 13/2013 për shërbimin ligjor qeveritar.
45. Udhëzim administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative.
46. Rregullore nr. 2001/9 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, (Gazeta zyrtare, UNMIK, 15 maj 2001).
47. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njëërën anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër.
48. Divizioni për Arsim me Nevoja të Veçanta në MASHT (2017), Udhëzues për punën e mësuesit udhëtues, Prishtinë, 2017.
49. Plan individual i arsimit (PIA) dhe Udhëzuesi për hartimin e planit individual të arsimit për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, 2017.

Ueb-faqet

50. <https://www.spektrum.al/studim-perfshirja-e-prinderve-ne-detyrat-e-shtepise-se-femijeve-ka-ndikim-negativ-ne-rezultatet-e-tyre/>
51. <http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/06/BEP-Doracaku-i-leximit-Final.pdf>
52. http://ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/ċcms_169136.pdf
53. <http://ask.rks-gov.net/media/4145/stat-e-arsimit-2017-2018-shqip.pdf>
54. <https://rm.coe.int/1680695741>
55. <http://mei-ks.net/sq/korniza-ligjore-pr-prafrim>
56. <https://www.gjiganti.com/kosova/info/minoritetet.html>
57. <http://www.mei-ks.net/sq/msa>
58. <http://www.mei-ks.net/sq/msa>
59. <http://www.mei-ks.net/sq/msa>
60. <https://www.evropaelire.org/a/28018660.html>
61. <https://www.readingrockets.org/article/creating-positive-school-experiences-students-disabilities>
62. <https://www.albinfo.ch/diskriminim-nga-klasa-e-pare-nxenesve-u-ndalohet-te-ulen-ne-bankat-e-para/>
63. <https://lajme365.com/nenshkruhet-memorandum-bashkepunimi-per-pemiresimin-e-pozites-se-komunitetit-rae-ne-prizren/>
64. <https://kallxo.com/rrefim/mesime-ne-rezistence-sistemi-paralel-arsimit-ne-kosove-ne-vitet-90/>
65. <https://edukimi.uni-pr.edu/getattachment/Ballina/Katalogu.pdf.aspx>

SHTOJCAT

Pyetësor për student

I/e nderuar student/e,

Ky pyetësor është pjesë e një hulumtimi që jemi duke e zhvilluar rreth përgatitjes së mësimeve të ardhshme lidhur me qasjen ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta.

Të gjithë jemi dëshmitarë që gjithëpërfshirja është një nga synimet bazë të MASHT-it dhe njëherësh një nga obligimet që Kosova si shtet i ri duhet ta përmbushë karshi kërkesave të BE-së. Shpeshherë përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta është sfiduese jo vetëm për vetë nxënësit, por edhe për prindërit e mësimeve të ardhshme që shpeshherë e konsiderojnë veten pamjaftueshëm të përgatitur për t'u marrë me këta fëmijë.

Nga ju si mësime të ardhshme neve na duhet mendimi se sa fakulteti juaj po ju përgatit për t'u ballafaquar me këtë kategori. Të gjeturat nga ky hulumtim në të ardhmen do të jenë një pikë ndihmese për MASHT-in gjatë hartimit të politikave për fëmijët me nevoja të veçanta.

Ju lutem, përgjigjuni me korrektësi ndaj çdo pyetjeje në mënyrë që të dhënat që do të grumbullojmë të paraqesin gjendjen reale.

Parimi i kufidencialitetit: Ju sigurojmë se informacionet nga ky studim do të trajtohen si informacion kufidencial dhe do të jenë vetëm në dispozicion të studiuesit që do të përpunojë të dhënat e këtij studimi.

*Ky hulumtim hartohet nga **Maliqe Mulolli Jahmurataj**, kandidate e PhD-së në Universitetin e Evropës Juglindore. Emaili për kontakt dhe pyetje eventuale: maliqem@gmail.com.*

Mosha juaj:

- a. 18 – 23
- b. 24 – 30
- c. 31 – 40
- d. 41 – 45
- e. 45 e më shumë

Gjinia: ☐ Femër

☐ Mashkull

Në cilin fakultet vijoni studimet: a. Publik b. Privat

Viti i studimeve (qarko): a. Viti I b. Viti II c. Viti III d. Viti IV

Programi i studimeve _____.

1. Si e perceptoni ju termin “fëmijë me nevoja të veçanta”?

2. Sa jeni i informuar për fëmijët me nevoja të veçanta?

- a. Shumë
- b. Pak
- c. Aspak

3. Nga kush keni marrë informacione për fëmijët me nevoja të veçanta?

- a. Gjatë studimeve
- b. Nga mjetet e informimit
- c. Gjatë praktikës në shkollë
- d. Të tjera _____

4. Sa mendoni që vijimi i studimeve në universitetin tuaj ofron njohuri të mjaftueshme që nesër ju të jeni kontribuues aktivë në arsimin gjithëpërfshirës?

- a. Shumë
- b. Mesatarisht
- c. Pak
- d. Aspak

5. Përmendni disa nga lëndët që kanë të bëjnë me nxënësit me nevoja të veçanta që keni ndjekur gjatë studimeve:

- a. _____
- b. _____
- c. _____

6. A mendoni se ligjëruesit e këtyre lëndëve kanë mjaftueshëm përgatitje dhe njohuri lidhur me gjithëpërfshirjen?

- a. Po
- b. Jo

Koment: _____

7. Sa mendoni që do të jetë sfiduese për një nxënës të kësaj kategorie nëse mësimdhënësi i tij është i papërgatitur për qasje ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta?

- a. Shumë
- b. Pak
- c. Aspak

8. Përveç mësimi praktik që keni mbajtur në shkollë, a keni vizituar ndonjë institucion tjetër ku ka të përfshirë fëmijë me nevoja të veçanta?

- a. Po
- b. Jo

(Nëse po, shkruani ku: _____)

9. A mendoni se FNV-të duhet të vijojnë mësimin në shkollë të zakonshme?

- a. Po
- b. Jo

10. Më shumë do të preferoni të punoni si mësimdhënëse e rregullt apo vetëm si mësimdhënëse mbështetëse për t'u marrë me ndonjë fëmijë me nevojë të veçantë?
Arsyeto:

11. Nëse në të ardhmen keni ndonjë FNV në klasën tuaj dhe prindi i tij nuk deklarohet për nevojat e fëmijës së tij, çfarë mendoni, cilët do të ishin hapat dhe mënyra e qasjes me atë fëmijë nga ana juaj si mësimdhënëse?

12. Sa mendoni që do të jetë e vështirë puna me fëmijët me nevoja të veçanta për ju në të ardhmen?

- a. Shumë
- b. Pak
- c. Aspak

Pyetësor për nxënës

Gjinia: Mashkull ☐ Femër ☐

Mosha juaj: _____ Klasa _____

Shkolla ku vijoni mësimet është zonë: ☐ Rurale ☐ Urbane

Etnia:

- a. Rom
- b. Ashkali
- c. Egjiptian
- d. Tjetër

1. Sa është numri i nxënësve në klasën tuaj?

Numri i nxënësve _____

13. Çfarë janë raportet tuaja me shokët dhe shoqet e klasës?

- d. Të mira
- e. Shumë të mira
- f. Aspak të mira

14. Në cilën bankë uleni?

- a. Në fillim
- b. Në mes
- c. Në fund

d. Ndërrojmë vendet

15. A uleni gjithmonë me shokun apo shogën e njëjtë?

c. Po

d. Jo

16. Sa merrni pjesë në mësim plotësues ose shtues?

a) Jashtëzakonisht shumë

b) Shumë

c) Deri diku

d) Pak

e) Aspak

17. Sa keni mbështetje apo ndihmë rreth detyrave të shtëpisë?

a.Shumë

b.Deri diku

c.Pak

d.Aspak

18. A janë në gjendje prindërit t'ju ndihmojnë rreth detyrave të shtëpisë?

d. Po

e. Jo

f. Nganjëherë

19. Çfarë bëni në kohën e lirë?

a. Lexoj

b. Luaj

c. Ndihmoj prindërit

d. Punoj _____ (nëse po, çfarë?)

20. Cili është sukseesi juaj në shkollë?

a. I shkëlqyeshëm

b. I mirë

c. I mjaftueshëm

d. I pamjaftueshëm

21. Çka do të donit të ndryshonit në shkollën apo klasën tuaj?

**Pyetësor me mësimdhënës që në klasat e tyre kanë nxënës të komunitetit
joshumicë rom, ashkali dhe egjiptian**

1. Sa jeni të kënaqur me vijimin mësimi të fëmijëve të këtij komuniteti në shkollë?

a. Pak b. Shumë c. Aspak

2. A keni vështirësi që t'i inkorporoni këta fëmijë në klasën tuaj?

a. Po
b. Jo

3. A keni ndjekur ndonjë trajnim për qasjen e barabartë ndaj nxënësve?

a. Po (specifiko) _____
b. Jo

4. Sa keni mbështetje nga shkolla dhe institucionet e tjera në punën tuaj?

a. Jashtëzakonisht shumë
b. Shumë
c. Deri diku
d. Pak
e. Aspak

5. A janë të paragjykuar këta fëmijë nga fëmijët shumicë në klasë?

a. Po
b. Jo

- c. Nganjëherë
6. Sa janë të rregullt prindërit e këtyre fëmijëve në takimet e organizuara të klasës?
- a. Pak
 - b. Shumë
 - c. Aspak
7. Sa vijnë të përgatitur këta nxënës me detyrat e shtëpisë?
- a. Pak
 - b. Shumë
 - c. Aspak
8. A mendoni se kanë mbështetje të mjaftueshme në shtëpi?
- a. Po
 - b. Jo
9. A ndihmohen këta nxënës nga nxënësit e tjerë të klasës?
- a. Shumë
 - b. Disi
 - c. Pak
 - d. Aspak
10. A marrin pjesë këta nxënës në aktivitetet kulturore e sportive që organizon shkolla?
- a. Po
 - b. Jo
 - c. Rrallë

Pyetësor për mësindhënës

1. Si e perceptoni ju termin “fëmijë me nevoja të veçanta”?
2. Gjatë punës suaj me nxënës a ju ka ndodhur të keni në klasë fëmijë me nevoja të veçanta dhe, nëse po, cilat kanë qenë vështirësitë tuaja gjatë punës me ta?
3. Sa është numri i nxënësve në klasat ku ju jepni mësim? (Specifikoni numrin e përgjithshëm dhe të atyre me nevoja të veçanta).
4. A keni ndjekur ndonjë trajnim për qasje ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta?
 - a. Po
 - b. Jo
5. A e konsideroni të nevojshme të merrni pjesë në trajnime / seminare të tjera për të marrë njohuri për punën me fëmijët me nevoja të veçanta?
 - a. Po
 - b. Jo
6. Sa është afërsisht numri i trajnimeve që organizohen çdo vit shkollor lidhur me gjithëpërfshirjen? _____
7. Cili institucion i ka ofruar këto trajnime?
 - a. OJQ
 - b. DKA
 - c. Universiteti

8. Sa mendoni që është e nevojshme përfshirja e mësuesve mbështetës në klasat ku ka fëmijë me nevoja të veçanta?
- a. Shumë
 - b. Pak
 - c. Aspak
9. A keni në klasë mësues mbështetës dhe, nëse po, sa e konsideroni të domosdoshme prezencën e tyre në klasën tuaj?
- a. Shumë
 - b. Pak
 - c. Aspak
 - d. Deri diku
 - e. Nuk kam
10. Sa e keni mbështetjen e specialistëve / profesionistëve të fushës së aftësive të veçanta në punën tuaj?
- a. Jashtëzakonisht shumë
 - b. Shumë
 - c. Pak
 - d. Aspak
11. Nga cilët specialistë do ta vlerësonit më të nevojshme mbështetjen?
- a. Psikologë zhvillimi
 - b. Mjekë
 - c. Punëtorë socialë
 - d. Logopedë
 - e. Të tjerë
12. Cilin do ta konsideronit si motiv apo inkurajim për të punuar me FNV?
- a. Pagesë shtesë
 - b. Mësues mbështetës në klasë
 - c. Orë mësimore të reduktuara
 - d. Numër i reduktuar i nxënësve në klasë
 - e. Asnjërin nga to

13. Përafërsisht sa kohë u kushtoni nxënësve me nevoja të veçanta dhe a ju pengon kjo për t'u marrë me nxënësit e tjerë?
14. Si janë raportet e FNV-ve me nxënësit e tjerë të shkollës?
- a. Të mira
 - b. Aspak të mira
 - c. Shumë të mira
15. A ndihmohen nxënësit me nevoja të veçanta nga nxënësit e tjerë të klasës?
- a. Shumë
 - b. Pak
 - c. Aspak
16. A keni njohuri për PIA-n (Planin individual të arsimit)?
- a. Po
 - b. Jo
17. Sa bashkëpunoni me prindërit për zbatimin e programit të hartuar për nevojat specifike të fëmijës së tij/saj?
- a. Shumë
 - b. Pak
 - c. Deri diku
 - d. Aspak
18. A keni ambient të përshtatshëm në shkollë për sigurimin e lëvizjes pa barriera të FNV-ve?
- a. Po
 - b. Jo
19. A ju siguron shkolla materiale didaktike në përputhje me nevojat dhe kërkesat për të punuar me FNV?
- a. Po
 - b. Jo

20. Çfarë do të sugjeronit në drejtim të përshtatshmërisë së mjeteve? (Mund të shënoni më shumë se një alternativë).

21. A mendoni se FNV-të duhet të vijojnë mësimin në shkolla të zakonshme?

a. Po

b. Jo